



SIGMA

Mbështetje për përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, financuar kryesisht nga BE

MARRËDHËNIET MIDIS INSTITUCIONEVE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE

DOKUMENTI i SIGMA-s NR. 33, 2002

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit - është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Europian (BE), krijuar në vitin 1992. Iniciativa mbështet përpjekjet për reformimin e administratës publike në 15 vende në tranzicion - dhjetë vende candidate dhe pesë vende të Ballkanit Perëndimor - dhe financohet kryesisht nga Komuniteti Europian.

OECD - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - është një organizatë ndërqeveritare e 30 demokracive me ekonomi tregu të përparuar. Qendra i kanalizon këshillat dhe ndihmën e Organizatës në një numër të madh çështjesh ekonomike për reformimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik. Komuniteti Europian jep grante financimi për të mbështetur vendet e tij partnere në Europën Qendrore dhe Lindore deri në fazën kur ato të jenë të gatshme të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkimin Europian.

SIGMA punon në kuadër të Drejtorisë për Qeverisjen Publike dhe Zhvillimin Territorial të OECD-së (GOV). GOV u ofron politikëbërësve informacione dhe ekspertizë në lidhje me menaxhimin publik dhe lehtëson kontaktet dhe shkëmbimin e përvojave midis menaxherëve të sektorit publik të shteteve anëtare të OECD-së. SIGMA u ofron vendeve përfituese akses në një rrjet të administratorëve publikë me përvojë, informacione krahasuese dhe njohuri teknike që shfrytëzojnë rrjetet dhe rezultatet e GOV.

Roli i parë i SIGMA-s është të ndihmojë reformat dhe për ta bërë këtë ajo përhap një sërë metodash të ndihmës teknike. SIGMA punon në bashkëpunim me vendet përfituese me qëllimin që të:

Vlerësojë nevojat për reforma dhe të identifikojë përparësitë bazuar në të dhëna bazë dhe në një metodologji të pranuar në bashkëpunim me shërbimet e përshtatshme të cilat pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe *acquis communautaire*.

- Ndihmojë vendimmarrësit dhe administratat të ndërtojnë organizata dhe procedura që plotësojnë standardet europiane dhe praktikën e mirë dhe që nxisin stafin e sektorit publik të zbatojë vlerat demokratike, etike dhe të respektojë shtetin ligjor.
- Ofrojë ndihmë për vendet përfituese dhe të kontribuojë në koordinimin e aktiviteteve të donatorëve duke ndihmuar për hartimin e projekteve dhe duke dhënë ndihmë plotësuese përfshirë këtu vendosjen e lidhjeve, përkufizimin e termave të referencës, pjesëmarrjen në komisione vlerësimi si dhe duke dhënë mendimet e veta ose këndvështrime krahasuese shtesë.

SIGMA ka investuar në mjetet e komunikimit për punën e vet, kryesisht në formën e publikimeve dhe të një faqeje interneti me njohuri krahasuese për nxitjen e logjikës së komunitetit profesional dhe shpërndarjen e ideve të mira. Megjithatë, që prej vitit 2000, ky është mbajtur në nivel minimal. Që prej marsit të vitit 2002, SIGMA ka hartuar një Buletin të Grupeve të Punës të Kryetarëve të Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (IKLSH-të) të vendeve candidate për BE, dhe të Shqipërisë, Kroacisë dhe Gjykatës Europiane të Audituesve. Ky buletin del katër herë në vit. Edhe buletini, edhe të gjitha publikimet e tjera mund të shkarkohen falas nga adresa e internetit e SIGMA-s.

Në të gjithë punën e saj, SIGMA i jep përparësi të madhe lehtësimit të bashkëpunimit midis qeverive. Kjo praktikë përfshin ofrimin e mbështetjes logjistike për krijimin e rrjeteve të nëpunësve të administratës publike në Europën Qendrore dhe Lindore, si edhe midis këtyre nëpunësve dhe homologëve të tyre në demokraci të tjera.

Vendet candidate: Në shtator 2002, Komisioni Europian dhe OECD ranë dakord në termat e referencës për një zgjatje të mëtejshme të Programit të SIGMA-s deri në fund të vitit 2004. Një ekip ekspertësh i SIGMA-s po vazhdon të punojë me dhjetë vendet candidate për anëtare në Bashkimin Europian (Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia). Aktivitetet janë përqendruar në përgatitjen e administratave të vendeve candidate për hyrje në BE dhe përfshijnë kontrollin financiar, auditimin e jashtëm, reformën në shërbimin civil dhe reformën administrative, me një theks në garantimin e një menaxhimi të mirë të fondeve të BE-së për periudhën para pranimit dhe synojnë plotësimin e Programit të Binjakëzimit të BE-së. Përveç kësaj, për Bullgarinë dhe Rumaninë fokusi është më i gjerë për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të këtyre dy vendeve.

Ballkani Perëndimor: Në vitin 2001, Komuniteti European ra dakord me termat e referencës për Programin SIGMA që ky të ngrinte një ekip të dytë me ekspertë për të punuar deri në fund të vitit 2003 me pesë vende të Ballkanit Perëndimor - Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe Republikën Federale të Jugosllavisë. Theks i veçantë i është dhënë reformës së shërbimit civil dhe asaj administrative, forcimit të kapaciteteve të politikave, menaxhimit të shpenzimeve publike, kontrollit financiar/auditimit të jashtëm, prokurimit publik dhe koncesioneve. Përveç kësaj, Komisioni i ka kërkuar SIGMA-s të punojë edhe për administratën e taksave dhe tregtinë ndërkombëtare. Këto aktivitete janë kryer në bashkëpunim me Qendrën e Taksave dhe Drejtorinë për Tregtinë të OECD-së.

Kontrata për Ballkanin Perëndimor është bërë sidomos për t'u mundësuar këtyre vendeve të përfitojnë nga përvoja e vendeve kandidate përmes rrjeteve të punonjësve të administratës publike në Europën Qendrore e Lindore, të krijuar nga SIGMA gjatë dekadës së fundit.

Turqia: SIGMA po i jep tani ndihmë Ministrisë turke të Financave për menaxhimin e financimeve publike dhe kontrollin e brendshëm financiar publik si dhe zhvillimin e sistemit të prokurimeve publike, në kuadrin e granteve të veçanta të Komisionit European.

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

Të drejtat e autorit: OECD

Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Relations Between Supreme Audit Institutions and Parliamentary Committees.*

OECD autorizon përdorimin e këtij materiali lirisht, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike rights@oecd.org.

PARATHËNIE

Dokumenti SIGMA-s është nxjerrë nga një raport mbi marrëdhëniet midis Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Komisioneve Parlamentare, përgatitur për rrjetin e Kryetarëve të Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të vendeve të Europës Qendrore e Lindore (EQL), Qipros, Maltës dhe Gjykatës Europiane të Audituesve, si pjesë e përpjekjeve të tyre për t'i përgatitur vendet candidate për anëtarësimin eventual në Bashkimin Europian. Ky dokument është shkruar kryesisht për t'u përdorur nga këto organizata, por SIGMA beson se ky paraqet një interes më të gjerë. Kontribuuesit kryesorë të këtij dokumenti ishin Dhoma e Kontrollit të Lartë në Poloni, dhe Zyra e Auditimit të Shtetit e Maltës, përfaqësuar përkatësisht nga Jacek Mazur dhe Brian Vella; mbështetur nga Jan Pieter Lingen dhe Chris Kok nga Gjykata Europiane e Audituesve; nga eksperti i SIGMA-s Harry Havens; nga ishpunonjësi i SIGMA-s Bo Sandberg; dhe nga punonjësi i SIGMA-s Nick Treen. Pjesëmarrës në punën e oficerëve ndërlidhës ishin Institucionet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, Kroacisë, Qipros, Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Rumanisë, Republikës Sllovaqe dhe Sllovenisë të cilat të gjitha ofruan të dhëna të vlefshme që do të përbënin bazën e raportit. Përveç kësaj, raporti përfshiu materialin e përgatitur nga Institucionet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Kanadasë, Danimarkës, Irlandës, Izraelit, Holandës, Norvegjisë, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar, nga Gjykata Europiane e Audituesve dhe SIGMA.

SIGMA po e publikon këtë dokument me besimin se informacioni që ky përmban duhet të jetë i një interesi të gjerë për personat e përfshirë në të ose për të interesuarit për këto marrëdhënie të rëndësishme. Puna e Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (IKLSH) dhe marrëdhëniet e tyre me parlamentin janë faktorë kyç në një zinxhir të fortë llogaridhënieje dhe efektiviteti të qeverisjes në sektorin publik.

SIGMA falënderon kontribuuesit e shumtë dhe institucionet pjesëmarrëse për përpjekjen që u krye për grumbullimin e të dhënave që mbështesin raportin fillestar, për analizën e tij, për arritjen e përfundimeve të dobishme dhe përgatitjen e raportit si edhe për lejen e dhënë që rezultatet të bëheshin të disponueshme për një publik më të gjerë.

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Komunitetit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të janë të SIGMA-s dhe për këtë arsye nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë mendimin zyrtar të Komunitetit Europian ose të OECD-së.

Për informacion të mëtejshëm, lutemi kontaktoni Bob Bonwitt, Drejtorin e Programit SIGMA, ose Nick Treen, Administratorin Kryesor të Kontrollit Financiar dhe të Auditimit, në adresën e mëposhtme:

Ky dokument dhe dokumente të tjera të SIGMA-s mund të gjenden në adresën e internetit të SIGMA-s: www.sigmaweb.org

PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
KAPITULLI 1: HYRJE	8
KAPITULLI 2: SITUATA NË VENDET KANDIDATE/ANËTARE	11
KAPITULLI 3: PRAKTIKA TË MIRA TË IDENTIFIKUARA	22
ANEKSI 1: DOKUMENT I SHKURTËR I SIGMA-s PËR MARRËDHËNIET MIDIS INSTITUCIONEVE TË KONTROLLIT TË LARTE DHE PARLAMENTEVE	28
ANEKSI 2: MARRËDHËNIET NDËRMJET GJYKATËS EUROPIANE TË AUDITORËVE DHE KOMISIONEVE TË PARLAMENTIT EUROPIAN.....	36
ANEKSI 3: MARRËDHËNIET MIDIS KOMISIONEVE PARLAMENTARE DHE ZYRËS SË AUDITUESIT TË PRGJITHSHËM NË KANADA.....	40
ANEKSI 4: MARRËDHËNIET E IKLSH-së DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË DANIMARKË	44
ANEKSI 5: MARRËDHËNIET MIDIS IKLSH-së DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË IRLANDË.....	47
ANEKSI 6: BASHKËVEPRIMI MIDIS AUDITUESIT TË SHTETIT DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE (IZRAEL)	50
ANEKSI 7: MARRËDHËNIET MIDIS GJYKATËS SË AUDITIMIT DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË HOLANDË	54
ANEKSI 8: MARRËDHËNIET E ZYRËS SË AUDITUESIT TË PËRGJITHSHËM TË NORVEGJISË DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE	58
ANEKSI 9: MARRËDHËNIET E GJYKATËS SË LLOGARIVE TË PORTUGALISË DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE	61
ANEKSI 10: MBRETËRIA E BASHKUAR: KOMISIONI I LLOGARIVE PUBLIKE	62
ANEKSI 11: DOKUMENT I SHKURTËR I SIGMA-s PËR PERSONAT E KONTAKTIT TË GRUPIT TË PUNËS PËR MARRËDHËNIET MIDIS INSTITUCIONEVE TË KONTROLLIT TË LARTË DHE PARLAMENTIT (ME FOKUS TË VEÇANTË NË RASTET NGA SHBA DHE AUSTRALIA)	64

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Konteksti

Raporti¹ nga i cili buron dokumenti i SIGMA-s u përgatit nga IKLSH-të e Maltës dhe Polonisë, në bashkëpunim me Institucionet e Kontrollit të Lartë (IKLSH) të vendeve të Europës Qendrore e Lindore, të Qipros, Maltës dhe me Gjykatën Europiane të Audituesve dhe me mbështetjen e SIGMA-s. Ai është produkt i aktiviteteve të përbashkëta të kryera brenda rrjetit të kryetarëve të këtyre IKLSH-ve. Objektivi ishte të shqyrtonte marrëdhëniet ndërmjet IKLSH-ve pjesëmarrëse dhe parlamenteve përkatëse, veçanërisht Komisioneve të Auditimit të këtyre parlamenteve, dhe të propozonte rrugë për përmirësimin e këtyre marrëdhënieve në të mirë të të dyja palëve.

Informacioni për situatën aktuale u grumbullua përmes pyetësorëve me IKLSH-të pjesëmarrëse. Përgjigjet treguan një larmi të madhe (shih Kapitullin 2). Të dhëna u grumbulluan gjithashtu edhe për vende të tjera (shih Aneksat 1-11) me qëllim që të identifikoheshin praktikatat e mira që mund të jenë të dobishme për t'u zbatuar (shih Kapitullin 3).

Kryetarët e këtyre IKLSH-ve vendosën (gjatë mbledhjes së tyre vjetore të mbajtur në vitin 2001 në Limassol, Qipro) t'i publikojnë gjerësisht rezultatet e kësaj pune dhe SIGMA e ka përgatitur këtë dokument në mbështetje të këtij qëllimi.

Praktikat e mira

Raporti përmban dy grupe praktikash të mira të njohura, të cilat trajtohen në kapitullin 3, duke u mbështetur në analizën e informacionit të grumbulluar. Grupi i parë i praktikave është i drejtuar ndaj IKLSH-ve dhe synon të rrisë efektivitetin e përgjithshëm të tyre si dhe të sigurojë që ato janë plotësisht të përgatitura të punojnë me parlamentin dhe komisionet e tij. Këto përfshijnë si më poshtë:

- Hartimin dhe miratimin e politikave dhe standardeve të përshtatshme të auditimit dhe garantimin që ato të gjejnë zbatim.
- Shkrimin e raporteve të auditimit në një mënyrë të qartë, koncize, të drejtë dhe faktike, duke shmangur deklaratimet politike.
- Miratimin dhe zbatimin e standardeve të përshtatshme etike.
- Dhënien e mendimeve të përshtatshme për shqetësimet parlamentare për përcaktimin e përparësive të auditimit.
- Të qenit përzgjedhës në përcaktimin se cilat raporte auditimi duhet të dorëzohen në parlament duke dërguar atje vetëm ato raporte që meritojnë qartësisht vëmendjen e parlamentit dhe të cilat përfshijnë një deklaram të qartë se pse raporti është dërguar në parlament.
- Shqyrtimin e ngritjes së një njësie të veçantë ose të caktimit të një personi për të bashkërenduar kontaktet e IKLSH-ve me parlamentin për të lehtësuar komunikimet dhe për të ndihmuar në sigurimin e ndërjegjësisimit të IKLSH-ve për nevojat dhe interesat parlamentare.
- Ndjekjen në mënyrë aktive dhe metodike të gjetjeve të auditimeve të mëparshme dhe informimin e parlamentit për çdo prioritet për mosveprim për probleme të rëndësishme.
- Shmangien e komenteve të drejtpërdrejta për politikatat e qeverisë, por pranimin se zbulimi i problemeve të zbatimit mund të ngrëjë pyetje për politikatat që qëndrojnë pas tyre.

Grupi i dytë i propozimeve ka të bëjë me veprimet që parlamenti mund të ndërmarrë për të shtuar marrëdhëniet e tij të punës me IKLSH-në dhe mbikëqyrjen e tij mbi aktivitetet e qeverisë. Duke diskutuar këto çështje me anëtarët e parlamentit, IKLSH-të paralajmërohen të shmangin me çdo mënyrë çdo element që duket sikur udhëzon parlamentin se si të kryejë përgjegjësitë e tij kushtetuese. Këto sugjerime janë:

¹ Versioni i plotë i raportit gjendet në www.nik.gov.pl.

- Të garantohet në legjislacionin për auditimin shtetëror se IKLSH-ja është e pavarur si nga qeveria ashtu edhe nga parlamenti.
- Të emërohet Kryetarit i IKLSH-së në një mënyrë të tillë që garanton besim dhe mbështetje të gjerë të parlamentit.
- Të caktohet një komision parlamentar që të mbikëqyrë financat e IKLSH-së (pa ndërhyrjen e qeverisë) dhe të analizojë, por jo drejtpërdrejt, performancën e tij. Parlamenti duhet të garantojë se vetë IKLSH-ja auditohet në mënyrë të pavarur e me të njëjtat standarde me të cilat ajo auditon të tjerët.
- Të përcaktohen qartë llojet e raporteve të auditimit që duhet të paraqiten në parlament, por të jenë përzgjedhës dhe kjo detyrë t'i lihet në dorë IKLSH-së, sa herë të jetë e mundur.
- Të informohet IKLSH-ja për interesat parlamentare, përfshirë këtu edhe çështjet e sugjeruara për auditim, por vendimet përfundimtare mbi përparësitë në auditim t'i lihen në dorë të IKLSH-së.
- Të kërkohet që të gjitha raportet e auditimit të bëhen publike brenda një periudhe të arsyeshme kohe, nëse ato nuk janë të klasifikuara për arsye specifike.
- Të hartohen rregulla për mënyrën e veprimit të komisioneve parlamentare (KP) (shih listën praktike të SIGMA-s tek Aneksi 1, Shtojca B) dhe t'ju ofrohet atyre mbështetje me stafin e duhur sepse komisionet parlamentare kanë një rol të rëndësishëm në përdorimin e punës së IKLSH-së dhe në mbikëqyrjen e qeverisë.
- Të garantohet që komisioni përkatës parlamentar njihet në kohën e duhur me raportet e auditimit të IKLSH-së.
- Mbledhjet e komisionit parlamentar mund të jenë mjete të rëndësishme për të tërhequr vëmendjen për problemet që dalin në raportet e auditimit të IKLSH-së. Mbledhjet e komisionit parlamentar duhet të jenë të hapura për publikun dhe median (nëse kjo nuk kufizohet për arsye të veçanta) dhe duhet të ndiqen nga zyrtarë nga IKLSH-ja dhe nga të audituarit, me qëllim që të rritet efektiviteti i tyre. Anëtarët e komisionit parlamentar duhet të përgatiten për mbledhje të tilla duke përgatitur pyetje që duhet t'i bëjnë dhe duke marrë informacion shtesë, nëse e vlerësojnë të nevojshme.
- Në përfundim të mbledhjeve të komisionit parlamentar, komisioni parlamentar mund ta konsiderojë të përshtatshme të fillojë veprimet e tij në përgjigje të një raporti auditimi të IKLSH-së. Veprime të tilla duhet, nëse është e mundur, të pasqyrojnë mirëkuptimin unanimit të anëtarëve të komisionit parlamentar, meqë kështu rritet efektiviteti i tyre. Nga IKLSH-ë duhet të merret ndihma teknike, nëse kjo vlerësohet si e dobishme. Qeverisë duhet t'i kërkohet të reagojë ndaj raporteve dhe veprimeve të tjera të kryera nga KP-ë dhe IKLSH-ë, ndërsa KP-ë dhe IKLSH-ë duhet të ndjekin veprimet e qeverisë.

Këto rekomandime për IKLSH-të dhe propozimet për parlamentet dalin si pasojë e pranimin të faktit se idealisht, ekziston një marrëdhënie reciproke midis IKLSH-së dhe parlamentit tek i cili ky raporton. Këto dy institucione të rëndësishme, por të ndara, kanë role mbështetëse reciproke për sigurimin e qeverisjes efektive. Parlamenti mund t'i kryejë funksionet e tij jetësore të mbikëqyrjes më efektivisht kur përdor dhe mund të mbështetet në punën auditive të IKLSH-së. Po ashtu, një IKLSH-ë mund të jetë shumë më tepër efektive kur parlamenti dhe komisionet e tij mundësojnë një forum për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimit të kryer nga IKLSH-ë dhe një aleat të mundshëm duke i inkurajuar ose nxitur fuqishëm të tjerët që të ndërmarrin veprimet e përshtatshme korrigjuese.

KAPITULLI 1: HYRJJE

1. Kryetarët e Institucioneve të Kontrollit të Lartë (IKLSH) të vendeve të Europës Qendrore e Lindore, Qipros dhe Maltës dhe të Gjykatës Europiane të Audituesve, në mbledhjen e tyre në Sofje në 7 dhe 8 dhjetor 2000, i kërkuan Dhomës së Kontrollit të Lartë të Polonisë dhe Zyrës së Auditimit të Shtetit të Maltës (Brian Vella i Maltës dhe Jecek Mazur i Polonisë u caktuan si bashkëraportues) të përgatisnin një raport mbi marrëdhëniet midis Institucioneve të Kontrollit të Lartë dhe komisioneve parlamentare. Raporti do të paraqitej në mbledhjen tjetër të Kryetarëve që do të zhvillohej në Qipro në nëntor të vitit 2001.

Rëndësia e marrëdhënieve midis IKLSH-së dhe Parlamentit/Komisioneve Parlamentare (KP)

2. Përgjegjshmëria, transparenca dhe vlera e parasë në përdorimin e fondeve publike, janë elemente themelore të qeverisë demokratike. Qeveria ekzekutive pritët të japë llogari për administrimin e parave të taksapaguesve përpara përfaqësuesve të zgjedhur në parlament si edhe përpara publikut në përgjithësi. IKLSH-të mund të japin një ndihmesë shumë të madhe në procesin e administrimit duke ofruar analizë, informacione, siguri dhe këshilla të pavarura për bilancin që paraqet ekzekutivi, si edhe për realizimin e programeve, projekteve, iniciativave dhe aktiviteteve të tjera të qeverisë.

3. IKLSH-të në vendet demokratike në të gjithë botën përpiqen të garantojnë se ato raportojnë lirisht dhe në mënyrë të pavarur dhe se gjetjeve të auditimit dhe rekomandimeve të tyre iu kushtohet vëmendje e duhur dhe veprohet mbi bazën e tyre. Idealisht, IKLSH-të dhe parlamentet janë të dy elementë të një sistemi të ekuilibruar të llogaridhënies së qeverisë. Qeveria është përgjegjëse për mënyrën se si e ekzekuton buxhetin e miratuar nga parlamenti.

4. Si pjesë të detyrës së tij të kontrollit dhe të shqyrtimit, parlamenti analizon ekzekutimin e buxhetit të shtetit dhe, ose zyrtarisht (si në rastin e procedurës së pezullimit) ose jozyrtarisht (të nënkuptuar) ai jep një mendim politik për mënyrën sesi qeveria ka ekzekutuar buxhetin. IKLSH-ja jep kontributin e vet në këtë rol të parlamentit duke ofruar rezultatet e auditimeve të veta.

5. Një objektiv qendror i këtij sistemi llogaridhënieje, në të cilin IKLSH-ë duhet të luajë një rol vendimtar si një organizatë profesionale dhe e pavarur, është të garantojë se fondet publike janë shpenzuar në një mënyrë të rregullt dhe eficiente dhe se mungesat e mundshme janë rregulluar në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive. Vëmendja politike e parlamentit ndihmon që mbi qeverinë të ushtrohet presioni përkatës, nëse është e nevojshme, dhe kontribuon për krijimin e një mjedisi të favorshëm për të ndjekur rekomandimet e vëzhgimeve të audituesve.

6. Marrëdhëniet midis IKLSH-ve dhe parlamenteve janë të ndryshme në vende të ndryshme të botës. IKLSH mund të jetë pjesë përbërëse ose e pushtetit legjislativ, ose e atij ekzekutiv ose i pavarur nga të dy. Larmia e madhe pasqyron faktorët ose ndikimet e shumta historike, kulturore, politike ose faktorë të tjerë. Në fakt, të gjitha IKLSH-të, pavarësisht nga struktura organizative dhe vendosja zyrtare në strukturën shtetërore, pranojnë rëndësinë e garantimit të pavarësisë së tyre, ndërsa në të njëjtën kohë sigurojnë se ato mund të marrin vëmendjen e përshtatshme nga parlamenti për rezultatet e auditimit si një hap themelor për të ndër marrë veprime korigjuese për problemet e zbuluara gjatë procesit të auditimit.

7. Pjesa 16 (1) e *Deklaratës së Limës me Udhëzime mbi Rregullat e Auditimit* thekson se:

Institucioni i Kontrollit të Lartë duhet të ketë kompetencë dhe t'i kërkohet nga kushtetuta të raportojë gjetjet e tij çdo vit dhe në mënyrë të pavarur para parlamentit ose para çdo organi tjetër përgjegjës publik; ky raport duhet të botohet. Kjo gjë garanton shpërndarjen dhe diskutimin e gjerë të raportit dhe rrit mundësinë për zbatimin e gjetjeve të Institucionit të Kontrollit të Lartë.

8. Ky koncept është zhvilluar më tej në Pjesët 56 deri 63 të *Standardeve INTOSAI (INTOIKLSH) të Auditimit*, të cilat merren me marrëdhëniet ndërmjet IKLSH-së dhe Parlamentit/komisioneve parlamentare.

9. Rekomandimi pesë i raportit: *Rekomandime në lidhje me Funksionimin e Institucioneve të Kontrollit të Lartë (IKLSH-ve) në Kontekstin e Integritetit European* (miratuar në Mbledhjen e Kryetarëve në Pragë në tetor 1999), parashikon se:

Institucionet e Kontrollit të Lartë duhet të jenë në gjendje të raportojnë lirisht dhe pa kufizime për rezultatet e punës së tyre. Raportet mund të dorëzohen në parlament dhe të bëhen publike.

10. Rëndësia e marrëdhënieve midis IKLSH-së dhe parlamentit/komisioneve parlamentare theksohet gjithashtu në teorinë e auditimit të qeverisë.

11. Komisionet Parlamentare që kanë kontakte me IKLSH-të janë ngritur në shumë vende. Qëllimi i tyre kryesor për sa i përket IKLSH-ve është të shqyrtojnë me hollësi raportet e auditimit duke marrë në konsideratë vëzhgimet, gjetjet dhe rekomandimet e IKLSH-së dhe duke paraqitur në parlament komentet dhe rekomandimet e veta për aktivitetet e qeverisë të shqyrtuara nga IKLSH-ë. Komisionet Parlamentare janë parë shpesh si mjete për përmirësimin e llogaridhënies publike dhe forcimit të rolit të IKLSH-ve.

Ky raport është mbështetur në konceptet e përshkruara më sipër.

Fusha e veprimit dhe objektivat e raportit

12. Raporti merret me 14 vende kandidate/pjesëmarrëse të cilat aktualisht janë përfshirë në procesin e pranimit në BE. Ato marrin pjesë në mbledhjet e Kryetarëve të IKLSH-ve dhe të oficerëve ndërlidhës dhe në mbledhjet e grupit të punës që organizohen rregullisht për IKLSH-të e këtyre vendeve. Vendet e përfshira janë Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia.

13. Objektivi i këtij raporti është të:

- ofrojë një panoramë mbi gjendjen që ekziston midis IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare që i përdorin dhe i diskutojnë rregullisht raportet e auditimit të IKLSH-së, dhe/ose çështje të tjera që lidhen me IKLSH-të. Fushat e zgjedhura për studim janë si më poshtë:
 - dhënia e rekomandimeve për praktikën më të mirë në marrëdhëniet midis IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare.
 - prezantimi i rasteve studimore të marrëdhënieve ndërmjet IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare nga një numër vendesh të BE-së dhe vende të tjera me sisteme të përparuar të IKLSH-ve/KP-ve, përfshirë dokumentet e SIGMA-s mbi këtë temë. Këto janë menduar të shërbejnë si një pikë referimi për vendet që duan të analizojnë sistemin e tyre të marrëdhënieve midis IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare.

Metodologjia

14. Për të grumbulluar të dhëna mbi situatën aktuale, të gjitha Institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit pjesëmarrëse në studim iu dërgua një pyetësor së bashku me një letër e cila shpjegonte kontekstin dhe objektivat e studimit. Të gjitha IKLSH-të e plotësuan siç duhej pyetësorin dhe dorëzuan përgjigjet e tij. Një përmbledhje e këtyre përgjigjeve gjendet në Kapitullin 2.

15. Gjykatës Europiane të Audituesve dhe IKLSH-ve të vendeve që mendohej se kanë një traditë të një institucioni të fortë dhe marrëdhënie të mira pune me parlamentin dhe komisionet e tij, iu kërkua të dorëzonin një raport të shkurtër për marrëdhëniet midis IKLSH-së dhe komisioneve parlamentare në vendin e tyre për t'u përdorur si raste studimore në këtë raport. Pothuajse të gjitha këto IKLSH-ë dhanë përgjigje. SIGMA kontribuoi në këtë studim përmes ndihmesës së punës së saj me IKLSH-të e vendeve me traditë të përparuar në marrëdhëniet e mira midis IKLSH-së dhe KP-së. Kontributet e marra nga IKLSH-të dhe SIGMA gjenden në anekset e këtij dokumenti.

16. Studimi, përfshirë edhe rekomandimet dhe sugjerimet e praktikave të mira që gjenden në Kapitullin 3, mbështetet shumë në kontributet e SIGMA-s, në një analizë të pyetësorëve të plotësuar dhe në dokumentet e secilit vend pjesëmarrës. Po ashtu, ka referenca edhe tek dokumentet INTOSAI (INTOIKLSH) dhe EUROSAI (EUROIKLSH) dhe tek dokumente të tjera.

Falënderime

17. Bashkëraportuesit nga IKLSH-të e Maltës dhe e Polonisë falënderuan të gjitha IKLSH-të e vendeve kandidate/anëtare për dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit si edhe për mendimet e tyre të dobishme në këtë

studim. Ata falënderuan gjithashtu edhe IKLSH-të e Kanadasë, Danimarkës, Irlandës, Izraelit, Holandës, Norvegjisë, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar, dhe Gjykatën Europiane të Audituesve për kontributet e tyre. Nga SIGMA u dhanë kontribute me shkrim, mbështetje dhe këshilla. Këto ishin veçanërisht përmbledhja ekzekutive dhe kapitulli mbi praktikën e mira, dokumentet për marrëdhëniet e IKLSH-së me KP-në në Australi dhe në SHBA, si edhe dokumente për vende të tjera bashkë me këshilla të përgjithshme të një eksperti dhe rekomandime të hollësishme për këtë temë.

18. Falënderime të veçanta shkojnë për: Jan Pieter Lingen dhe Chris Kok nga GJEA; SIGMA-n, në veçanti për Nick Treen, Esther Bright, Bo Sandberg dhe Harry Havens; dhe Iain Johnston që përfaqëson Grupin e Punës të Komitetit të Kontaktit të BE-së për Bashkëpunimin me Vendet Kandidate. Mbështetja, këshilla dhe ndihma e tyre është vlerësuar lart. Bashkëraportuesit falënderojnë gjithashtu edhe të gjithë kolegët nga IKLSH-të e Maltës dhe të Polonisë, të cilët ndihmuan për këtë dokument dhe, veçanërisht Elżbieta Sikorska dhe Włodzimierz Krzynówek.

KAPITULLI 2: SITUATA NË VENDET KANDIDATE/ANËTARE

19. Ky kapitull përmbledh shkëmbimin aktual të përvojave të raportuara nga IKLSH-të e vendeve kandidate për në BE dhe të vendeve të tjera anëtare në BE për marrëdhëniet e tyre me parlamentin.

Roli i parlamentit dhe i komisioneve parlamentare në marrëdhëniet me IKLSH-në

Marrëdhëniet midis IKLSH-së dhe parlamentit në përgjithësi

20. Në gjithë botën, mënyra se si rregullohet marrëdhënia e IKLSH-së me parlamentin mund të marrë forma të ndryshme. Kjo ka lidhje me statusin e përgjithshëm të IKLSH-së:

- Disa IKLSH-ë zyrtarisht janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, por volumi i punës së tyre i drejtohet parlamentit.
- Një numër i madh IKLSH-së janë konsideruar si të pavarura edhe nga parlamenti edhe nga qeveria. Ky është ndoshta modeli më i zakonshëm, të paktën në Europë. Një model i tillë nuk e përjashton faktin se puna e kryer, disa herë e një rëndësie të madhe, i drejtohet parlamentit.
- Të tjera IKLSH-ë janë qartazi pjesë e legjislativit. Disa prej tyre u krijuan fillimisht brenda sferës ekzekutive, por më vonë u transferuan tek pushteti legjislativ.

21. Marrëdhëniet ndërmjet IKLSH-së dhe parlamentit në vende të ndryshme janë bërë shumë më të forta gjatë dy apo tre dekadave të fundit. Më parë, marrëdhënie të tilla ndodhnin rrallë. Ato kishin të bënin me një raport vjetor dhe ndoshta ndonjëherë raporte auditimi të hollësishme. Megjithatë, në vitet e fundit, këto marrëdhënie janë bërë më të gjera dhe ndonjëherë edhe të përditshme. Ky ndryshim ka çuar në zgjerimin e njohurive të deputetëve për çështje që kanë të bëjnë me auditimin. Po ashtu, ai ka ndihmuar parlamentin për të kryer funksionin e vet mbikëqyrës mbi ekzekutivin në mënyrë më efikase dhe efektive.

22. Në shumicën e vendeve kandidate/anëtare në BE, IKLSH-të kanë marrëdhënie të ngushta me parlamentet përkatëse. Marrëdhëniet mund të kenë të bëjnë me emërimin/shkarkimin e kreut të IKLSH-së, me analizën e raporteve të auditimit, me analizën e projektligjeve (veçanërisht në fushat e kontrollit financiar), me analizën e programit dhe të aktiviteteve të auditimit vjetor të IKLSH-së, me kërkesat për auditime në fusha të caktuara, me miratimin e buxhetit të IKLSH-së, me analizën e projektligjeve që lidhen me veprimtarinë e IKLSH-së, etj. Marrëdhëniet mund të jenë të drejtpërdrejta me parlamentin ose me komisionet parlamentare.

Komisionet parlamentare që kanë kontakte të rregullta me IKLSH-të

23. Marrëdhëniet aktuale midis IKLSH-ve dhe parlamenteve kanë të bëjnë kryesisht me analizën e programeve dhe të aktiviteteve vjetore të auditimit dhe me analizën e aktiviteteve që pasojnë gjetjet e auditimit. Këto funksione realizohen kryesisht nga komisionet parlamentare.

24. IKLSH-të e vendeve kandidate/anëtare bashkëpunojnë me komisionet² e mëposhtme parlamentare:

- Komisionet përgjegjëse për sektorë të ndryshëm të administratës dhe ekonomisë, pra komisionet që kanë përgjegjësi për një fushë të caktuar, si për shembull, komisionet e ekonomisë, të transportit, të bujqësisë, dhe të kujdesit shëndetësor (këto quhen komisione degësh). Funksioni kryesor i këtyre komisioneve parlamentare është të shqyrtojnë dhe të përgatisin çështjet që janë aktualisht objekt i debatit parlamentar dhe të japin mendime për çështje që u janë dërguar atyre nga parlamenti ose kryetari i parlamentit. Brenda caqeve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe statutet, komisionet punojnë gjithashtu edhe si organe të shqyrtimit parlamentar në fusha specifike të aktiviteteve të qeverisë.
- Komisionet përgjegjëse, vetëm ose kryesisht për çështjet e lidhura me auditimin e shtetit (quhen komisione auditimi), mund të ndahen në dy tipe:
 - Komisionet e Financave Publike, përgjegjëse kryesisht për hetimin e të gjitha çështjeve që lidhen me financat publike, të parashikuara në kushtetutë ose të referuara nga parlamenti, nga një ministër ose nga kryetari i IKLSH-së (Qipro, Maltë).

² Në rastet e parlamenteve me dy dhoma, fjala është për atë dhomë e cila ka të drejtën të mbikëqyrë qeverinë.

- Komisionet shtetërore të Auditimit të cilat analizojnë në emër të parlamentit veprimtarinë e Institucionit të Kontrollit të Lartë. Këto komisione japin mendime për programet dhe aktivitetet vjetore të auditimit, vlerësojnë realizimet e IKLSH-ve mbi baza ditore, analizojnë disa nga raportet e auditimit dhe përpiqen të koordinojnë marrëdhëniet e IKLSH-së me komisionet e tjera parlamentare. Disa herë këto janë përgjegjëse për analizën e funksionimit të të gjitha organeve të tjera kontrollit dhe të inspektimit, si edhe për bashkëpunimin e këtyre organeve me IKLSH-në (Komisioni Shtetëror i Auditimit në Hungari, Komisioni i Kontrollit të Shtetit në Poloni). Një zgjidhje pjesërisht e ngjashme është krijimi i nënkomisioneve të përhershme të auditimit brenda një komisioni të buxhetit me qëllim zgjidhjen e çështjeve që lidhen me sistemin e auditimit, veçanërisht me aktivitetet dhe statusin e IKLSH-së (Republika Çeke).
- Komisionet përgjegjëse posaçërisht e kryesisht për çështjet e buxhetit të IKLSH-ve: miratimi i buxhetit të IKLSH-ve, emërimi i audituesve të jashtëm për auditimin e IKLSH-së dhe analiza e bilanceve të audituara (Komisioni për Zyrën Kombëtare të Auditimit në Maltë; një komision i ngjashëm në Rumani).

25. IKLSH-të mbajnë marrëdhënie të rregullta me një ose më shumë komisione parlamentare. Mund të dallohen modelet e mëposhtme:

- Bashkëpunimi me komisione të degëve të ndryshme (Kroaci, Estoni, Letoni, Lituani, Rumani).
- Bashkëpunimi me komisione të sektorëve të ndryshëm dhe me Komisionin shtetëror të Auditimit (Hungari, Poloni).
- Bashkëpunimi me një ose kryesisht me një komision sektori - veçanërisht me një komision që merret me çështjet e financave publike (Shqipëri, Bullgari, Republika Sllovaqe, Slloveni).
- Bashkëpunimi kryesisht me një komision të financave publike (Qipro, Maltë) ose me një nënkomision të përhershëm auditimi brenda komisionit të buxhetit (Republika Çeke).

Përbërja dhe mënyra e veprimit e Komisioneve Parlamentare që kanë kontakte të rregullta me IKLSH-në

Përbërja e komisioneve parlamentare dhe përfaqësimi i partive politike

26. Komisionet parlamentare që kanë kontakte të rregullta me IKLSH-në janë formuar sipas parimeve të përgjithshme, të ngjashme me ato që përdoren edhe për ngritjen e komisioneve të tjera të përhershme. Ato përbëhen vetëm nga deputetë të parlamentit. Persona të tjerë mund të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit parlamentar nëse ftohen ose nëse kjo kërkohet nga komisioni. Zakonisht, deputetët që nuk janë anëtarë të komisionit mund të marrin pjesë lirish në mbledhjen e një KP-je por nuk kanë të drejtë të votojnë.

27. Numri i anëtarëve të komisionit mund të fiksohet (në urdhrat e përhershëm ose në një rezolutë të veçantë) ose të vendoset me një rezolutë në momentin kur ata zgjidhen. Në praktikë, numri i anëtarëve të komisionit parlamentar në komisione të ndryshme në vende të ndryshme kandidate/anëtare varion midis 7 dhe 40 deputetë, përfshirë edhe një kryetar dhe një ose më shumë nënkryetarë.

28. Përbërja e komisionit parlamentar buron nga procedurat e konsultimeve të kryera midis grupeve parlamentare dhe bazohet në parimin e përfaqësimit proporcional. Emërimi në postin e kryetarit dhe të nënkryetarit është zakonisht një çështje e marrëveshjes politike. Në praktikë, grupet parlamentare janë përgjegjëse edhe për emërimin e anëtarëve të tjerë të KP-ve, megjithëse kjo duhet të miratohet nëpërmjet një rezolute parlamentare. Për pasojë, përbërja e komisioneve shpesh pasqyron strukturën politike të parlamentit që bën që shumica e anëtarëve të komisionit shpesh të përfaqësojë partinë ose koalicionin politik që është në pushtet.

29. Roli i parlamentit dhe i komisioneve të tij parlamentare ka në shumicën e rasteve natyrë politike. Megjithatë, ekzistojnë funksione të cilat nuk janë të tilla, ose nuk duhet të jenë të tilla, pra të një natyre politike, si në rastin kur KP-të diskutojnë çështjet që lidhen me IKLSH-të. Faktorët e mëposhtëm ndihmojnë që të garantohet depolitizimi i mbledhjeve të IKLSH-së: a) organizimi i punës së KP-së në përputhje me Urdhrat e Përhershëm të parlamentit; b) pjesëmarrja në mbledhjet e KP-së e punonjësve përgjegjës për çështjet në diskutim dhe e ekspertëve të tjerë; c) pjesëmarrja në KP-të e anëtarëve nga të gjitha partitë politike dhe e drejta e të gjithë anëtarëve për t'u dëgjuar; d) betimi i çdo deputeti që garanton besnikërinë dhe respektin për kushtetutën dhe gjithë legjislacionin; e) në disa vende, deputetët përpiqen të shmangin

politizimin e vendeve të KP-së kur diskutohen çështje që lidhen me IKLSH-në; f) në rastin e komisioneve që janë përgjegjës për çështjet e auditimit të shtetit, tërësisht ose kryesisht, posti i kryetarit disa herë mbahet nga një përfaqësues i partive të opozitës (Republika Çeke, Malta, Polonia) ose një përfaqësues i opozitës mban postin e nënkryetarit.

Shpeshësia e mbledhjeve të komisioneve parlamentare për të diskutuar çështje që lidhen me IKLSH-në

30. Në shumicën e vendeve nuk ekziston traditë e mbledhjeve të shpeshta dhe periodike midis IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare. Mbledhje të tilla kryhen në ato parlamente ku ekzistojnë komisione që merren tërësisht ose kryesisht me çështjet e auditimit të shtetit (Qipro, Hungari, Maltë), ose ku ekziston një traditë e analizës së raporteve të auditimit nga shumica e komisioneve parlamentare (Poloni). Numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare që mbledhen për të diskutuar për çështjet që lidhen me IKLSH-në varion nga një në tre në Shqipëri, Bullgari, Letoni dhe Lituani; disa mbledhje në Kroaci, Republikën Çeke, Estoni, Rumani, Republikën Sllovaqe dhe Slloveni; rreth 20 mbledhje në Hungari dhe Maltë; deri afërsisht në 75 mbledhje në Qipro dhe 70-100 në Poloni. Është e rrallë që të gjitha mbledhjet t'i kushtohen vetëm çështjeve që lidhen me IKLSH-në - në më të shumtën e rasteve ato përbëjnë vetëm një pikë të rendit të ditës. Zgjatja e mbledhjes varet kryesisht nga sasia dhe rëndësia e tematikës që diskutohet.

31. Zakonisht në asnjë parlament nuk ekziston një procedurë e veçantë për mënyrën e trajtimit të çështjeve që lidhen me IKLSH-në. Raportet e auditimit shqyrtohen sipas procedurave të ngjashme që zbatohen edhe për dokumente të tjera që paraqiten nga qeveria ose autoritete të tjera shtetërore. Zakonisht, dispozitat ligjore nuk kërkojnë që raporte të tilla të shqyrtohen nga parlamenti, përveç rasteve kur ato kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit. Në rrethana të tilla, vetëm disa nga raportet e auditimit shqyrtohen në mbledhjet e komisioneve parlamentare.

Rastet kur vendimet e komisioneve parlamentare konsiderohen të vlefshme

32. Zakonisht, mbledhjet e komisionit parlamentar janë të vlefshme nëse shumica e anëtarëve të tij janë prezent (Shqipëri, Kroaci, Qipro, Hungari, Lituani, Maltë, Republika Sllovaqe), por disa herë prezenca e vetëm 1/3 së anëtarëve të komisionit përbën kuorumin (Republika Çeke, Estoni, Poloni). Për vendimet që duhet të merren nga komisioni parlamentar, kërkohet shumica e votave të anëtarëve prezent (Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Estoni, Hungari, Lituani, Maltë, Poloni, Rumani, Slloveni). Në një rast (Letoni), kërkohet shumicë e cilësuar e anëtarëve prezent të komisionit. Në një rast tjetër (Republika Sllovaqe), kërkohet shumica absolute e të gjithë anëtarëve të komisionit që vendimi të kalojë, pra jo thjesht shumica e anëtarëve prezent në mbledhje.

Kërkesa ose ftesa e kreut të IKLSH-së për të ndjekur mbledhjet e komisionit parlamentar që kanë lidhje me Institucionin e KLSH-së

33. Kryetarët dhe përfaqësues të tjerë të Institucioneve të Kontrollit të Lartë zakonisht i ndjekin të gjitha mbledhjet e komisioneve parlamentare që analizojnë dokumentet e paraqitura nga IKLSH-të (veçanërisht kur shqyrtohen raportet e auditimit). Në shumicën e vendeve zakonisht është Kryetari i IKLSH-së ai që ndjek personalisht mbledhjet e KP-së që trajton çështjet e IKLSH-së, megjithëse ai/ajo mund të dërgojë një zëvendës ose një përfaqësues tjetër të ndjekë punimet në vend të tij. Rangu i përfaqësuesit të IKLSH-së është zakonisht i një niveli të lartë dhe varet nga natyra e çështjes (rëndësia ose ndjeshmëria e çështjes ose e auditimit që diskutohet).

34. Çështja e së drejtës ose e detyrës për të ndjekur mbledhjet rrallë përcaktohet qartë dhe kështu që varet nga praktika e përditshme. Shumë shpesh komisioni parlamentar fton Kryetarin e IKLSH-së të marrë pjesë në mbledhje. Mendohet se ai/ajo ose një përfaqësues, mund ta ndjekë një mbledhje të tillë i shoqëruar nga nëpunës të tjerë të IKLSH-së nëse e konsideron të arsyeshme. Në kushte të tilla, duke marrë në konsideratë aspektin ligjor, pjesëmarrja e kryetarit të IKLSH-së ose e përfaqësuesit të tij/saj nuk është e detyrueshme. Megjithatë, kryetari i IKLSH-së ose përfaqësuesi i tij/saj përgjithësisht pritet t'i ndjekë mbledhjet të tilla dhe është në interesin e vetë IKLSH-së që ajo të përfaqësohet. Vetëm në disa vende ndjekja e mbledhjeve që lidhen me IKLSH-në është e detyrueshme (Shqipëri, Lituani, Poloni), ose kjo ndjekje bëhet e detyrueshme nëse kërkohet nga KP-ë (Republika Çeke).

35. Në praktikë, siç u përmend edhe më sipër, në shumë nga vendet kandidate/anëtare komisionet parlamentare nuk i shqyrtojnë dokumentet e paraqitura nga IKLSH-të rregullisht. Prandaj përfaqësuesit e IKLSH-ve nuk marrin pjesë shpesh në mbledhjet e komisionit. Mbledhjet e KP-së që kanë lidhje me

Institucionin e Kontrollit të Lartë në disa vende kufizohen vetëm me analizën e raportit vjetor për aktivitetet e auditimit dhe me raportin për realizimin e buxhetit të shtetit. Në pjesën më të madhe të rasteve, mbledhjet kryhen në parlamente ku ekzistojnë komisione që merren vetëm ose kryesisht me çështjet e auditimit të shtetit (Qipro, Hungari, Maltë), ose kur ekziston një traditë e formuar e analizës së raporteve të auditimit nga shumica e KP-ve (Poloni). Situata në Poloni është e ndryshme sepse IKLSH, Dhoma e Kontrollit të Lartë (DHKL) njoftohet për të gjitha mbledhjet e komisionit parlamentar. Prandaj, është çështja që diskutohet në një mbledhje ajo që përcakton nëse një person ka të drejtë ose detyrë ta ndjekë atë: Kryetari i një DHKL-je (ose një përfaqësues i autorizuar i DHKL-së) është i detyruar të marrë pjesë në mbledhjet që lidhen me DHKL-në. Ndërsa për çështje të tjera, DHKL merr një ftesë për mbledhje (në praktikë, përfaqësuesit e DHKL-së marrin pjesë në rreth 60-70% të të gjitha mbledhjeve të KP-së).

Persona të tjerë që zakonisht ndjekin mbledhjet e komisioneve parlamentare që trajtojnë çështje të lidhura me IKLSH-në

36. Në të gjitha vendet kandidate/anëtare, përfaqësues të nivelit të lartë nga ministratë përkatëse, përfshirë edhe Ministrinë e Financave, ndjekin pothuajse të gjitha mbledhjet e KP-së që trajtojnë çështje të lidhura me IKLSH-në. Zakonisht, me kërkesën e KP-së, ministrat dhe krerët e zyrave dhe të institucioneve të tjera të shtetit janë të detyruar të dorëzojnë raporte dhe të ofrojnë informacion. Ata janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve parlamentare që do të shqyrtojnë çështje të fushës së veprimit të tyre. Në praktikë, në pjesën më të madhe të rasteve, ata përfaqësohen nga zëvendësit e tyre. Në përputhje me ligjin e përgjithshëm, KP ka të drejtë të kërkojë informacion me gojë ose me shkrim në lidhje me detyrat e tyre dhe ekziston edhe një kërkesë që personat që ndjekin mbledhjet e KP-së të jenë të besueshëm dhe të mos refuzojnë ose të fshehin ndonjë informacion të cilin KP-ë e konsideron të dobishëm për çështjet që shqyrton. Ministrave dhe krerëve të organeve të tjera shtetërore u kërkohet të diskutojnë raportet e auditimit dhe t'u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të KP-së (ata mund të marrin me vete edhe ekspertë ose të përfaqësohen nga zëvendësit e tyre ose përfaqësues të autorizuar). Prezenca e këtyre zyrtarëve qeveritarë (me t'u ftuar) është e detyrueshme megjithëse mospjesëmarrja në mbledhje nuk "ndëshkohet" (media mund të tërheqë vëmendjen e publikut për mungesën e tyre dhe disa herë zyrtarë të tillë mund të vihen para përgjegjësisë politike në Parlament). Në rastin e Maltës, nuk është e zakonshme që ministri të ndjekë mbledhjet e KP-së; mbledhje të tilla kërkohet t'i ndjekë zakonisht Sekretari i Përhershëm (kreu i ministrisë) ose kreu i një organizate tjetër publike përderisa ai/ajo do të jetë personi kryesor përgjegjës për çështjet e auditimit.

37. Përveç kësaj, komisioni parlamentar mund të ftojë edhe persona të tjerë, të tillë si përfaqësues të organizatave profesionale, shoqërore ose edhe politike për të siguruar informacionet ose shpjegimet që kërkohen. KP-ë ka gjithashtu të drejtë të ftojë ekspertë, ose mbi një bazë të përhershme ose të përkohshme, të cilët mund të shërbejnë si këshilltarë. Ekspertët joqeveritarë që ftohen, pritet të ndjekin mbledhjet e KP-së.

Stafi mbështetës i komisioneve parlamentare

38. Çdo KP-ë ka zakonisht një person (rrallë dy ose tre) të ngarkuar me detyra administrative (çështje të organizimit, të koordinimit, dhe administrative). Kur një komision ka nevojë për ekspertizë profesionale ekzistojnë tri zgjidhje tipike: në disa vende, anëtarët e stafit mbështetës kryejnë edhe detyra administrative edhe detyra këshillimi (Shqipëri, Qipro, Estoni). Në disa vende të tjera, komisionet ose kanë këshilltarët e tyre (Bullgari, Hungari, Letoni, Lituani), ose mund të kërkojnë këshilla nga personeli shumë i specializuar i sekretariatit të parlamentit (Shqipëri, Kroaci, Poloni). Përveç kësaj, komisionet parlamentare mund të punësojnë ekspertë të jashtëm.

Ndjekja e mbledhjeve të komisionit parlamentar nga media dhe publiku i gjerë

39. Nga pikëpamja formale, në parlamentet e vendeve kandidate/anëtare, ekzistojnë dy situata në lidhje me ndjekjen e mbledhjeve nga persona të medias dhe publiku i gjerë:

- Mbledhjet e KP-së janë publike dhe prandaj ato mund të ndiqen nga media dhe publiku, përveçse në raste shumë të rralla kur mbledhjet mund të konsiderohen të mbyllura për arsye shumë specifike (Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Hungari, Letoni, Maltë, Rumani, Republika Sllovaqe dhe Slloveni).
- Mbledhjet e KP-së nuk janë publike, por personat e medias dhe palë të tjera të interesuara mund të marrin lirisht leje për t'i ndjekur ato (Shqipëri, Estoni, Lituani, Poloni).

40. Në praktikë, njerëzit e medias dhe publiku i gjerë zakonisht mund të ndjekin mbledhjet e KP-së pavarësisht nga fakti nëse ato janë publike apo jo. Një shërbim përkatës parlamentar përpiket të krijojë kushtet e duhura për të bërë të mundur një pjesëmarrje të tillë, për shembull, publiku i gjerë informohet për datën e mbledhjes dhe rendin e saj të ditës.

41. Në realitet, kjo mundësi nuk jepet shpesh. Në shumicën e vendeve, media dhe publiku i ndjekin rrallë mbledhje të tilla (media është gjithmonë prezente në Qipro dhe Maltë dhe shumë shpesh në Poloni). Në disa vende, shërbimi parlamentar bën një përpjekje të informojë publikun për ecurinë e këtyre mbledhjeve, kryesisht nëpërmjet publikimit të një buletini që përshkruan në detaje çdo mbledhje të tillë (Letoni, Lituani, Poloni).

Mbulimi nga media e mbledhjeve të komisioneve parlamentare për çështje që lidhen me IKLSH-në

42. Mbulimi nga media ka të bëjë me raportet televizive dhe radiofonike, me artikujt në gazeta, revista e internet. Përmasat e mbulimit mediatic të mbledhjeve të KP-së për çështje të IKLSH-së varet nga rëndësia e çështjeve për publikun e gjerë. Gazetarët marrin pjesë rrallë në mbledhje të tilla dhe artikujt e tyre janë të shkurtër. Mbledhjet që merren me çështje që kanë interes material për publikun mbulohen nga më afër dhe pjesëmarrësit e këtyre mbledhjeve disa herë edhe intervistohen. Informacioni kryesor transmetohet rregullisht nga agjencitë e lajmeve. Vetëm në disa vende të veçanta përmasat e mbulimit mediatic të mbledhjeve që kanë të bëjnë me IKLSH-në janë konsideruar të përshtatshme (Qipro, Slloveni).

Roli i komisionit parlamentar në produktet/rezultatet e IKLSH-së

Numri i raporteve të auditimit të IKLSH-së të dërguara në parlament dhe të shqyrtuara nga komisionet parlamentare

43. Produktet përfundimtare të IKLSH-së janë raportet e auditimit të cilat përfshijnë gjetjet e auditimeve materiale dhe rekomandimet përkatëse të mundshme, nëse ka të tilla. Raportet e auditimit bëhen për deklarimet në tërësi ose të veçanta financiare të qeverisë, deklarimet financiare të organizatave, të kompanive shtetërore ose të enteve të tjera publike, për raportet mbi vlerën e parasë, për raportet e hetimeve, këshillimeve për projektligjet dhe për raporte a dokumente të tjera mbi çështje që mbulohen nga termat e referencës të një IKLSH-je. Tipi më i zakonshëm i raporteve të përgatitura nga IKLSH-të janë raportet financiare/të përputhshmërisë dhe raportet e performancës së vlerës së parave. Auditimeve të performancës së vlerës së parave u janë dhënë përparësi nga shumica e IKLSH-ve gjatë viteve të fundit. Po ashtu, IKLSH-të japin llogari për aktivitetet e tyre në raportet e tyre vjetore.

44. Disa IKLSH-ë nxjerrin një raport individual për çdo gjetje materiale të auditimit. IKLSH-ë të tjera nxjerrin një raport auditimi për disa gjetje të auditimit. Krahasime nuk janë bërë dhe nuk mund të bëhen midis një IKLSH-je dhe një tjetre përderisa numri i çështjeve të raportuara në një raport auditimi mund të jetë shumë i ndryshëm nga një IKLSH-ë në një tjetër, ose edhe midis një raporti dhe një tjetri brenda të njëjtës IKLSH-ë. Për më tepër, vëllimi i punës varet gjithashtu edhe nga madhësia e vetë IKLSH-së në fjalë. Numri i punonjësve në IKLSH-ë të ndryshme (përfshirë zyrat rajonale) varion ndjeshëm nga nën 100 (për shembull, Qipro, Estoni, Maltë) deri në disa qindra (për shembull, Republika Çeke, Hungaria) ose edhe më shumë (Polonia, Rumania). Numri i punonjësve të IKLSH-së varet shumë nga madhësia e vendit dhe nga fusha e veprimtimit të kompetencave të përcaktuara ligjore dhe kushtetuese të IKLSH-së.

45. Zakonisht, sipas ligjit ose kushtetutës, IKLSH-të janë të detyruara të dorëzojnë raportet kryesore të auditimit në parlament, në veçanti raportin vjetor mbi aktivitetet e tyre, një raport të auditimit mbi përdorimin e buxhetit të shtetit dhe raportet mbi auditimet e kërkuara nga parlamenti (kur ka të tilla). Në disa raste, dorëzohet edhe një mendim për financat publike, një raport mbi përdorimin dhe ruajtjen e asetëve shtetërore dhe një raport mbi borxhin publik. Në Republikën Çeke, IKLSH-ë është e detyruar të dorëzojë në parlament të gjitha raportet e saj të auditimit.

46. Komisionet parlamentare nuk i shqyrtojnë të gjitha raportet e auditimit të IKLSH-së që mbërrijnë në parlament. Kryesisht këto komisione shqyrtojnë rregullisht ato raporte auditimi shqyrtimi i të cilave nga parlamenti është i detyruar. Për më tepër, komisionet parlamentare analizojnë rregullisht raportet e auditimit të porositura (kur është rasti) ose të sugjeruara nga ata vetë.

47. Në shumicën e vendeve, komisionet parlamentare nuk analizojnë më shumë se gjysmën e raporteve të auditimit që kanë marrë. Më poshtë paraqiten llojet e rasteve të tilla:

- Komisionet parlamentare marrin çdo vit një numër të madh raportesh auditimi (për shembull 40,60 ose 200) dhe analizojnë tërësisht shumicën e tyre gjatë disa mbledhjeve përgjatë vitit (Qipro, Hungari dhe Poloni). Po ashtu, në Maltë, Raporti Vjetor i Auditimit (i përbërë prej disa pjesësh, që lidhen kryesisht me auditimin e Raportit Financiar të Qeverisë dhe Auditimet individuale Financiare) dhe raportet e veçanta për vlerën e parasë dhe ato investigative analizohen në rreth 20 mbledhje. Në vitin 2001, u miratuan procedura të reja sipas të cilave KP-ë dhe IKLSH-ë vendosën së bashku që përveç raporteve të tjera individuale, të analizoheshin nga KP-ë vetëm një numër i çështjeve që dilnin në Raportin Vjetor.
- Komisionet parlamentare marrin një numër të madh raportesh auditimi (për shembull, 20, 40 ose 100) dhe analizojnë vetëm pak prej tyre (Republika Çeke, Estoni, Letoni dhe Republika Sllovaqe).
- Në disa prej vendeve, një shumicë e ndjeshme e gjetjeve të auditimit përfshihet në raportin vjetor dhe /ose një raport auditimi mbi realizimin e buxhetit të shtetit. Këto analizohen nga komisionet parlamentare gjatë një, dy ose tre mbledhjeve (Shqipëri, Bullgari, Rumani).
- Ndonjëherë, komisionet parlamentare në disa mbledhje të tyre analizojnë një numër të madh raportesh të auditimit (për shembull, 70, 120 ose 900), shumica e të cilave kanë një karakter të hollësishëm (për shembull, në lidhje me auditimin e deklarimeve financiare dhe transaksionet financiare të pushtetit vendor dhe të njësisive të qeverisjes vendore. Në të tilla raste, vetëm pak prej tyre shqyrtohen në thellësi (Kroaci, Lituani, Slloveni).

Shqyrtimi i raporteve të auditimit të IKLSH-së nga komisionet parlamentare dhe i raporteve të KP-së që kanë lidhje me IKLSH-në

48. Qëllimi i shqyrtimit të raporteve të auditimit nga komisionet parlamentare është të shihen vëzhgimet, gjetjet dhe rekomandimet e IKLSH-së dhe/ose të bëhen të njohura pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre për të ndihmuar parlamentin dhe organizatën e audituar të marrë vendimet dhe veprimet përkatëse. Në këtë mënyrë ushtrohet presion ndaj qeverisë dhe njësisë së audituar për të marrë masat e nevojshme dhe në kohën e duhur për të korrigjuar dobësitë. Përmes një sistemi të tillë shqyrtimi, rritet edhe përgjegjshmëria e të audituarve.

49. Në të gjitha vendet kandidate/anëtare, komisionet parlamentare marrin në shqyrtim, vlerësojnë dhe analizojnë raportet e auditimit (ose të paktën i vënë ato në dukje pa diskutim). Praktikisht në të gjitha rastet procedura është e njëjtë me atë të dokumenteve të tjera që shqyrtohen dhe diskutohen gjatë mbledhjeve. Si rregull, raportet e auditimit dërgohen përpara mbledhjes me qëllim që anëtarët e KP-së të mund të njihen me raportin e auditimit në fjalë. Ndonjëherë, komisionet parlamentare kërkojnë informacion dhe dokumentacion shtesë përpara mbledhjes.

50. Pas analizës së raporteve të auditimit, disa komisione parlamentare përgatisin raportet e tyre që përmbajnë pikëpamjet, komentet dhe rekomandimet e tyre për parlamentin (Kroaci, Rumani dhe, disa herë edhe Qipro), ose formulojnë një projektrezolutë për parlamentin (Letoni). Në këto raste, komisionet parlamentare duhet të raportojnë gjithashtu për mendimet e pakicës së anëtarëve të KP nëse kjo pakicë këmbëngul në këtë gjë. Në Hungari, komisionet parlamentare marrin një vendim zyrtar për miratimin ose refuzimin e raportit të IKLSH-së dhe ky vendim i dërgohet parlamentit. Komisione parlamentare të tjera analizojnë raportet e auditimit por nuk marrin ndonjë vendim zyrtar dhe nuk hartojnë rezolutë, meqë vendime të tilla duhet të kërkohen në seancat dëgjimore në komision (Shqipëri, Bullgari, Estoni, Lituani, Maltë dhe Slloveni). Në rastin e Maltës, mbahen procesverbalet e mbledhjeve të KLLP-së dhe një kopje e tyre i shpërndahet IKLSH-së dhe pjesë të procesverbaleve i jepen të audituarve. Komisione të tjera parlamentare i marrin raportet e auditimit të plota, por zyrtarisht nuk i diskutojnë ato (Republika Sllovaqe). Në Republikën Çeke, raportet e IKLSH-së i diskuton në fakt nënkomisioni i komisionit të buxhetit dhe pastaj ai propozon një projektrezolutë. Komisioni zakonisht vepron mbi bazën e sugjerimeve të nënkomisionit dhe dorëzon projektrezolutën në parlament. Në raste të tjera, vendimet merren vetëm për raportin e aktiviteteve vjetore, por jo për raportet e auditimit (Bullgari, Slloveni).

51. Në Poloni, komisioni parlamentar përkatës mund ta marrë parasysh raportin e auditimit përmes një rezolute, por në praktikë kjo ndodh rrallë (zakonisht nënkuptohet, siç formulohet kjo në procesverbalin e mbledhjes). Përveç kësaj, në varësi të përmbajtjes dhe të përfundimeve të raportit të auditimit, komisioni parlamentar mund të miratojë:

- Një *desideratum* (një kërkesë) me propozimet e KP-së. *Kërkesa* mund t'i drejtohet Këshillit të Ministrave, ministrive të veçanta ose organeve të tjera qendrore të shtetit. Marrësi i *kërkesës* është i detyruar të japë përgjigje për kërkesën dhe t'i njoftojë me shkrim mendimin e tij kryetarit të parlamentit brenda 30 ditëve.
- Një “mendim” me pikëpamjet e KP-së për çështjen në fjalë. Mendimi mund t'i dërgohet të njëjtave organe si edhe *kërkesa*. Përgjigjja nuk është e detyrueshme, por KP-ja mund të kërkojë një dokument ku të shprehet qëndrimi mbi çështjen e ngritur në mendimin e shprehur (edhe kjo brenda 30 ditëve).

52. *Kërkesa* dhe *mendimet* e miratuara nga KP-të shpesh jepen pas shqyrtimit të raporteve të auditimit dhe ato ndonjëherë përmbajnë një referencë të drejtpërdrejtë të raportit të auditimit të DHKL-së. Si rezultat, përgjigjet ndaj *kërkesës* dhe mendimeve si edhe raportet e organeve shtetërore mbi performancën e kryer analizohen në mbledhjet e KP-së. Nëse nuk merret një përgjigje në kohën e duhur ose nëse përgjigjja konsiderohet e pakënaqshme, KP-ë mund ta ridërgojë *kërkesën* ose mendimin, t'i dërgojë një mocion Kryetarit të Parlamentit për refuzimin e përgjigjes si të pakënaqshme ose të dorëzojë një projektrezolutë të parlamentit.

Veprimet pasuese të KP-së dhe të IKLSH-së ndaj raporteve të auditimit

53. Në shumicën e vendeve kandidate/anëtare, kryhen disa forma veprimesh pasuese nga IKLSH-ë ose KP-ë, ose nga të dyja (Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Hungari, Maltë, Poloni, Rumani, Republika Sllovaqe dhe Slloveni). IKLSH-ë dhe komisione parlamentare të tjera si rregull nuk ndërmarrin veprime pasuese për raportet e IKLSH-së.

54. Format e veprimeve pasuese janë të ndryshme dhe lloji, përmasa dhe shkalla janë të ndryshme nga një vend në tjetrin:

- Audituesit janë të detyruar të kontrollojnë përparimin e kryer në punët e të audituarit që nga auditimi i mëparshëm (në shumë vende kjo detyrë është përfshirë në metodat e auditimit të IKLSH-së dhe në procedurat e planifikimit).
- Nëse një çështje e raportuar në raportin e auditimit nuk ka gjetur zgjidhje, çështja duhet të përfshihet në Raportin e ardhshëm Vjetor (për shembull, Qipro, Hungari).
- KP-ë mund t'u kërkojë organeve të ndryshme shtetërore të raportojnë mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.
- Mbi bazën e një raporti auditimi, KP-ë mund të miratojë një rezolutë që ngre kërkesa specifike për qeverinë, ministrinë ose organe të tjera administrative të pushtetit qendror. Në veçanti, ai mund të kërkojë që të rregullohen dobësitë e IKLSH-së dhe që KP-ë të informohet për masat përmirësuese të miratuara dhe rezultatet e tyre. Organit të cilit i adresohet rezoluta i kërkohet t'i ofrojë informacion ose t'i japë një shpjegim KP-së brenda një afati kohor të caktuar (për shembull, Republika Çeke, Polonia, Republika Sllovaqe).
- Raporti i KP-së për parlamentin mund të përmbajë propozime konkrete për ndjekjen e masave të propozuara nga IKLSH-ë (për shembull, Rumania).
- Në shumë vende, përdoruesi i fondeve publike, veprimet, parregullsitë ose dobësitë e të cilit janë bërë publike, duhet të dorëzojë në IKLSH-ë një raport mbi përmirësimin e parregullsive dhe dobësive (raporti reagues).

Roli i Komisionit Parlamentar në veprimet e IKLSH-së

E drejta e KP-së të shqyrtojë dhe të ndikojë në programin e auditimit të IKLSH-së dhe të kërkojë një auditim, një hetim ose një rishqyrtim nga IKLSH-ë

55. Praktikisht, të gjitha IKLSH-të kanë efektivisht një shkallë të arsyeshme pavarësie në përgatitjen e programit të tyre vjetor të auditimit. Disa IKLSH-ë nuk ndikohen në planin e tyre të punës në asnjë lloj mënyre nga parlamenti ose nga komisione parlamentare të veçanta (Shqipëri, Qipro, Republika Çeke, Estoni, Maltë). IKLSH-ë të tjera ndikohen deri në njëfarë mase. Megjithatë, pjesa më e madhe e punës së kryer nga IKLSH-të varet nga përparësitë dhe vendimet e IKLSH-së.

56. Ndikimi i parlamentit dhe i komisioneve parlamentare mbi programin e auditimit të IKLSH-së mund të marrë formën e së drejtës së tyre për të rishikuar (ose miratuar) programin vjetor të auditimit ose për të urdhëruar auditime të tjera shtesë. Kështu mund të theksohen shembujt e paktë të ndikimit mbi programin vjetor të auditimit të IKLSH-së:

- Në Kroaci, sipas dispozitave të Ligjit mbi Auditimin e Shtetit, Dhoma e Përfaqësuesve duhet të konfirmojë propozimin e IKLSH-së për Programin Vjetor të IKLSH-së (në praktikë, ajo kurrë nuk ka pasur ndonjë ndikim mbi Programin Vjetor të IKLSH-së).
- Në Slloveni, IKLSH-ë është e detyruar të përfshijë në planin e saj të punës pesë propozime nga parlamenti, dy nga të cilat duhet të jenë nga deputetët e opozitës dhe dy nga komisionet parlamentare.
- Në Hungari, Kryetari i IKLSH-së përcakton përmbajtjen e Programit Vjetor të Auditimit pas konsultimeve me Komisionin Shtetëror të Auditimit.
- Në Poloni, sipas ligjit mbi DhLK-në, “DhLK kryen detyrat e saj mbi bazën e planeve periodike, të cilat i dërgohen Sejm-it (parlamentit)”. Komisioni Shtetëror i Kontrollit diskuton planin vjetor të auditimit pasi ai është miratuar nga DhLK.
- Në Republikën Çeke, me t’u miratuar, plani i aktiviteteve të auditimit i dorëzohet Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit për informimin e tyre, (Kryetari i IKLSH-së raporton edhe personalisht mbi planin e aktiviteteve të auditimit në komisionin e buxhetit).

57. Në disa nga vendet ekziston edhe mundësia e kërkimit të auditimeve shtesë:

- Në disa raste, vetëm njëra nga dhomat e parlamentit mund të kërkojë një auditim ose një shqyrtim tjetër, por këtë gjë nuk mund ta bëjnë komisionet e veçanta parlamentare (Bullgaria, - deri në tre auditime në vit, Kroacia, Hungaria, Lituania, Rumania dhe Republika Sllovake). Komisionet parlamentare e kanë të mundur t’u kthehen seancave plenare të parlamentit për të udhëzuar IKLSH-në të ndryshojë programin vjetor të auditimit ose të përfshijë një temë të re në planin e tij të punës. Megjithatë, në praktikë urdhra e kërkesa të tilla janë të rralla.
- Në Poloni, sipas ligjit të Dhomës së Kontrollit të Lartë, “DHKL ndërmer auditime me urdhër të parlamentit (Sejm-it) ose të organeve të tij”. Këto urdhra janë detyruese për DHKL-në. Një urdhër nga KP zbatohet kur KP miraton një rezolutë mbi kryerjen e një auditimi nga DHKL-ë. Në vitin 1999, u kryen 14 auditime bazuar në urdhrat e parlamentit dhe të organeve të tij. Në vitin 2000 u kryen pesë auditime të tilla.
- Në Letoni, një komision hetimor parlamentar, në përputhje me detyrën që i ka lënë Saema (parlamenti), ka të drejtë të kërkojë kryerjen e një auditimi.

58. Përveç kësaj, në shumë vende kandidate/anëtare, ekziston një praktikë jozyrtare e komisioneve parlamentare (ose edhe e deputetëve të veçantë) që dërgojnë propozime për subjekte që mund të auditohen. Ato mund të përfshihen në programin e auditimit të IKLSH-së nëse këtë e konsideron të arsyeshme kryetari i IKLSH-së ose Këshilli. Megjithëse propozime të tilla nuk janë detyruese, IKLSH-të i trajtojnë ato seriozisht dhe përgjigjen në mënyrë të përshtatshme. Propozimet dërgohen shpesh pas konsultimeve të para me IKLSH-në. Disa IKLSH-ë theksojnë se ata nuk i refuzojnë kurrë propozime të tilla për aq kohë sa ato janë të arsyeshme dhe brenda mandatit të tyre. Sa për shembull përmendim se nga viti 1996 e deri në vitin 2000 IKLSH-ë i Republikës Çeke mori në total 24 sugjerime, kryesisht nga KP-të individuale, nga të cilat 13 u pranuan. Në Poloni, në gjysmën e parë të çdo viti, Kryetari i DHKL-së i kërkon Kryetarit të Parlamentit sugjerime për subjekte auditimi për vitin që pason. KP-të e përdorin shpesh këtë mundësi - në vitin 2000 ata dorëzuan 46 propozime prej të cilave 43 u morën parasysh pjesërisht ose plotësisht (për më tepër, komisionet parlamentare ndikojnë në aktivitetet e auditimit të DHKL-së përmes urdhrave për auditim).

59. Në asnjë nga vendet nuk ka të dhëna të dukshme që të tregojnë se parlamentet ose KP-të i pengojnë auditimet që të mos planifikohen ose të mos kryhen nga IKLSH-ë. Në teori, kjo mund të bëhet ose në rrugë zyrtare ose në rrugë jozyrtare, për shembull, duke ushtruar presion politik mbi IKLSH-në, ose duke kërcënuar me alokimin e buxhetit të saj. Duket se nuk ka raste të përdorimit të kompetencës zyrtare të vetos. Megjithatë, mënyrat jozyrtare të detyrimit mund të jenë një problem serioz nëse një komision parlamentar kontrollon nga partia/koalicioni politik qeverisës, sepse ai/ajo mund të ketë një interes në shmangien e auditimeve që qeveria mund t’i shohë si dëmtuese në pikëpamje politike. Ky rrezik varet nga pjekuria politike e klasës qeverisëse.

Kontaktet midis IKLSH-së dhe komisionit parlamentar para dhe pas mbledhjeve të KP-së

60. Në shumicën e vendeve ekzistojnë kontakte midis IKLSH-së dhe KP-së para dhe pas mbledhjeve të KP-së. Këto kanë të bëjnë me diskutimet e KP-së mbi raportet dhe çështje të tjera që lidhen me IKLSH-në. Disa IKLSH-ë kanë më pak kontakte të tilla (Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Lituania, Malta, Rumania, Republika Sllovaqe). Të tjera IKLSH-ë kanë një mënyrë më të shpeshtë të komunikimit me komisionet parlamentare (Shqipëria, Kroacia, Hungaria, Polonia, Sllovenia).

61. Kontaktet lidhen me informacion më të detajuar rreth raporteve të IKLSH-së të cilat do të ishin në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të KP-së (Shqipëria, Kroacia), me bashkëpunimin dhe përgatitjen për mbledhjen (Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia), përfshirë edhe listat me pyetje të përgatitura nga IKLSH për komisionin parlamentar përpara mbledhjes (Malta), me kërkesën për dokumente, informacion shtesë ose sqarues (Letonia, Polonia), dhe me parashqyrtimin e raporteve të KP-së (Bullgaria). Në Hungari, IKLSH-ë informon KP për një raport auditimi gjashtë muaj përpara përfundimit të auditimit dhe dorëzimit të raportit përkatës në KP.

62. Fusha kryesore e kontakteve IKLSH-KP-ë ka lidhje me raportet e auditimit. Përfundimet që rrjedhin nga aktivitetet audituese ndonjëherë frymëzojnë komisionet parlamentare të ndërmarrin veprime për disa probleme. Përveç kësaj, IKLSH-të ndonjëherë ofrojnë ndihmë dhe mbështetje tjetër, e cila mund të marrë formën e komenteve për projektligjet e dorëzuara në IKLSH-ë për t'i marrë mendim (Bullgaria, Republika Çeke, Lituania, Polonia), formën e diskutimeve për çështje të veçanta (Kroacia), të përgatitjes së dokumenteve analitike shtesë (Lituania, Polonia), të prezantimeve dhe udhëzimeve për çështje profesionale (Hungari) ose të dërgimit të informacionit tjetër të kërkuar nga KP-ë (Rumania, Republika Sllovaqe). Në Republikën Çeke, nëse kërkohet nga Dhoma e Përfaqësuesve ose nga Komisionet e Senatit të caktuara për të diskutuar projektligje të caktuara, Kryetari i Zyrës së Auditimit të Shtetit (ZASH) mund të emërojë kohë pas kohe një anëtar të zyrës, i cili ndodh të ketë ekspertizë në një fushë të veçantë, të marrë pjesë në diskutime për projekte të tilla.

63. Kontakte midis Kryetarit të KP-së dhe kreut të IKLSH-së zakonisht ekzistojnë, por në disa vende njësitë e IKLSH-së (departamente, drejtori, etj.) kanë kontakte të drejtpërdrejta me komisionet parlamentare përkatëse (Shqipëri, Bullgari, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Republika Sllovaqe). Këto kontakte shprehen në komunikime jozyrtare gojore ose më zyrtare me shkrim midis anëtarëve të KP-së dhe të IKLSH-së. Ato mund të kryhen me kërkesën për më shumë detaje, sqarime ose për informacion tjetër mbi disa çështje në raportin e auditimit ose për bashkëpunim në një kuptim më të gjerë. Kur kontaktet ekzistojnë, këto janë zakonisht midis kryetarit të KP-së ose anëtarëve të KP-së dhe zëvendësit, ndihmësve kryesorë ose drejtorëve në IKLSH-ë. Në disa raste, është raportuesi i komisionit përgjegjës për një raport auditimi që, gjatë përgatitjes së raportit të tij/saj, vihet në kontakt me një anëtar përkatës ose drejtor të IKLSH-së ose me audituesit që kanë marrë pjesë në auditim. Ky i mban këto kontakte gjatë punës së tij përgatitore për raportin që do të paraqesë në komision. Kjo bëhet me qëllim që të sqarohen çështjet e veçanta që dalin nga raporti i auditimit. Në vende të tjera, njësitë e IKLSH-së nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me komisionet parlamentare.

Ndikimi i komisioneve parlamentare në punën audituese ose në metodologjinë e IKLSH-së

64. Të 14 IKLSH-të raportuan se komisionet parlamentare nuk mund të ndërhyjnë në punën audituese të IKLSH-së dhe në metodologjinë e saj. U vu në dukje se aktivitetet, organizimi dhe metodologjia që duhej zbatuar janë e drejtë e IKLSH-së. Procedurat e auditimit të IKLSH-së disa herë përcaktohen me një ligj, në mënyrë që asnjë entitet i jashtëm të mos mund të ndikojë në procedurën e auditimit. Komisionet parlamentare nuk mund të ndikojnë në metodologjinë e auditimit. Kjo metodologji mund të përshkruhet në rregulloret ligjore dhe të hartohet me detaje posaçërisht për çdo auditim të IKLSH-së.

Funksione të tjera të Komisionit Parlamentar që lidhen me IKLSH-në

Mendimet dhe propozimet legislative të IKLSH-së

65. Një nga kriteret e auditimeve të kryera nga IKLSH-të është ai i ligjshmërisë. Vlerësimi i aktivitetit të enteve që auditohen nga pikëpamja e ligjshmërisë, u jep IKLSH-ve një bazë të gjerë për formulimin e shënimeve dhe të përfundimeve për ligjin në fuqi ose amendamentet e kërkuara. Kjo ka të bëjë në veçanti me legjislacionin që IKLSH-ve u intereson më shumë, pikërisht me atë legjislacion i cili zbatohet për financat publike ose për çështje të tjera që auditohen, për shembull Ligji për Buxhetin, Ligji për Prokurimet Publike, Ligji për Kontrollin Financiar, Ligji për financat, taksat dhe detyrimet, Ligji për IKLSH-në, etj. Në dokumente

të ndryshme që hartohen gjatë procesit të auditimit (për shembull, dokumentet e punës, protokollet e auditimit, deklaratimet pas auditimit) si edhe në raportet e auditimit, dalin vëzhgime dhe vërejtje për legjislacionin aktual dhe mendimet për amendime që do të ishte mirë të bëheshin.

66. Shumica e IKLSH-ve kohë pas kohe i paraqesin sugjerimet e tyre në formën e mocioneve *de lege ferenda*, megjithëse disa prej tyre e shmangin këtë praktikë të cilën këta e perceptojnë si një kapërcim në fushën e politikës. “IKLSH-ë nuk mund të komentojë për çështjet e politikës”- Maltë. Në praktikë, propozimet legjislative zakonisht nuk dorëzohen drejtpërdrejt nga vetë IKLSH-ë, por përmes organeve të tjera, kryesisht nëpërmjet komisioneve përkatëse parlamentare (Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Hungari, Letoni dhe Poloni). Asnjë IKLSH-ë nuk ka fuqi të propozojë projektligje në parlament dhe vetëm në raste të veçanta IKLSH-të lejohen të dorëzojnë në qeveri. Për pasojë, nëse një IKLSH-ë dëshiron të bëjë amendamente në ligj, së pari ai kërkon të konsultohet me komisionet përkatëse parlamentare dhe të tërheqë vëmendjen e tyre për dështimet e rregullimeve ekzistuese ligjore. Nëse një komision parlamentar bie dakord me propozimet e IKLSH-së, ai mund të dërgojë një projektligj në parlament. Duhet thënë se kjo praktikë nuk është shumë e shpeshtë.

67. Më e zakonshme është zgjidhja përmes së cilës IKLSH-ë paraqet mendimet e veta mbi projektligjet e paraqitura nga ente të tjera. Kjo mund të bëhet gjatë punës së qeverisë (Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Malta dhe Polonia) ose gjatë punës së parlamentit. Zakonisht, këto mendime bëhen të ditura gjatë mbledhjeve të komisioneve parlamentare (Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Polonia, Rumania, Sllovenia). Në vende të ndryshme ekzistojnë procedura të ndryshme, përfshirë: a) të drejtën e përgjithshme të IKLSH-së të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit dhe mundësinë të prezantojë mendimin e saj për të gjitha projektligjet (vetëm në Poloni); b) përgatitjen e një mendimi për një projektligj me kërkesën e parlamentit ose të një organi të tij (Republika Çeke, Letonia, Rumania); c) delegimin e ekspertëve të IKLSH-së si konsulentë në debatet me kërkesën e KP-ve përkatëse (Republika Çeke). Në disa vende konsiderohet si veçanërisht e rëndësishme se është pjesë e mandatit të IKLSH-së të paraqesë komentet e saj mbi projektbuxhetin e shtetit (Estoni dhe Hungari).

68. Ia vlen të përmendet se disa IKLSH-ë i paraqesin mendimet e tyre jo vetëm për projektligje, por edhe për projekte të legjislacionit dytësor, kryesisht në fazën e konsultimit të jashtëm brenda pushtetit ekzekutiv. Në parim, dhënia e mendimeve mbi projekt rregulloret ligjore të përgatitura nga ministrinë ose organe të tjera administrative të qeverisjes qendrore nuk është punë e IKLSH-ve, por ato i perceptojnë aktivitete të tilla si pjesë të përpjekjeve të tyre për të nxitur parimet e menaxhimit të përshtatshëm financiar në administratën shtetërore (Republika Çeke, Estonia, Polonia).

Roli i komisionit parlamentar në shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të IKLSH-së

69. Që IKLSH të realizojë mandatin e vet, duhet të vihen në dispozicion burimet përkatëse financiare. Buxheti i Institucionit të Kontrollit të Lartë (IKLSH) në të gjitha vendet kandidate/anëtare përbën një kapitull të veçantë në buxhetin e shtetit. Projektbuxheti i IKLSH-së përgatitet nga vetë ai dhe pastaj dërgohet në qeveri (ose eventualisht edhe drejtpërdrejt në parlament) për t'u përfshirë në projektbuxhetin e përgjithshëm të shtetit. Në disa vende (Qipro, Estoni, Letoni) qeveria ka të drejtë të ndryshojë projektin e IKLSH-së. Pastaj, projektbuxheti i shtetit dërgohet në parlament për miratim.

70. Dhe kështu, parlamenti dhe qeveria shpesh ndikojnë në vendimet në lidhje me sasinë e buxhetit të IKLSH-së. Komisionet parlamentare luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim në pothuajse të gjitha vendet. Ekzistojnë dy modele bazë:

- Shqyrtimi i projektbuxhetit të IKLSH-së kryhet nga një komision buxheti në kuadër të procesit të përgjithshëm të miratimit të projektbuxhetit të shtetit (Shqipëria, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Republika Sllovake, Sllovenia,). Në këtë drejtim, situata në Poloni është paksa më e ndryshme, d.m.th. Sejm-i ia referon Komisionit të Financave Publike projektbuxhetin e shtetit për shqyrtim. Disa pjesë të projektbuxhetit shqyrtohen edhe nga komisionet parlamentare përkatëse. Për sa i përket projektbuxhetit të DHKL-së, Komisioni i Kontrollit të Shtetit është komisioni parlamentar përkatës. Pasi e shqyrtojnë projektin, komisionet parlamentare i dërgojnë qëndrimet e tyre bashkë me mendimet ose propozimet për amendamente së bashku me justifikimet te Komisioni i Financave Publike. Pasi shqyrton pjesë të veçanta të projektbuxhetit të shtetit dhe qëndrimet e dërguara nga komisionet parlamentare, Komisioni i Financave Publike i paraqet Sejm-it një raport në seancë plenare.
- Shqyrtimi i projektbuxhetit të IKLSH-së kryhet nga një komision i ngritur kryesisht për këtë qëllim. Komisioni i Llogarive i Zyrës së Auditimit të Shtetit (ZASH) në Maltë e shqyrton buxhetin e ZASH-it

si edhe zbatimin e tij dhe dërgon një raport në parlament për analizën e tij. Bazuar në raportin e KP-së, parlamenti pastaj miraton buxhetin e ZASH-it.

71. Në praktikë, roli që luajnë komisionet parlamentare në këto procedura është shpesh vendimtar, përderisa ata mund të sugjerojnë rritje (në shumicën e vendeve) ose ulje në sasinë e buxhetit të IKLSH-së dhe, ndonjëherë, ata e bëjnë këtë gjë. Në disa raste, kjo bëhet nën ndikimin e qeverisë, ngaqë qeveria vetë nuk ka mandat të amendojë projektbuxhetin e IKLSH-së, e megjithatë, ajo mund të bindë parlamentin ta bëjë këtë gjë.

Shqyrtimi i raportit të aktivitetit vjetor të IKLSH-së nga komisionet parlamentare

72. Në disa vende candidate/anëtare, komisionet parlamentare nuk kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe vlerësojnë raportin e aktivitetit vjetor të IKLSH-së (Bullgaria, Qiproja, Estonia, Letonia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia). Në disa vende të tjera, komisionet parlamentare e kanë këtë të drejtë (Shqipëria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Lituania, Malta, Polonia), veçanërisht kur ky shqyrtim përbën një përgatitje për diskutime të mëtejshme në parlament.

73. Deri tani, rezultatet e vlerësimit kanë qenë praktikisht gjithmonë pozitive. Megjithatë, duhet shtuar se, një vlerësim negativ nuk do të ndikonte mbi IKLSH-në. Kjo nuk do të thotë se ai nuk do të merrej në konsideratë - një vlerësim i tillë ndoshta do të përfshinte KP-në që të nxiste dhe këshillonte IKLSH-në që t'i korrigjonte dhe përmirësonte problemet dhe, ndoshta të kërkonte ndihmë profesionale, nëse do të kishte nevojë. Në shumicën e vendeve, IKLSH-ë nuk do të ishte zyrtarisht e detyruar t'i merrte parasysh rekomandime të tilla, po të kihet parasysh klauzola e pavarësisë në kushtetutë dhe në legjislacion (që zakonisht garanton që IKLSH nuk i nënshtrohet autoritetit ose presionit nga çdo person ose organ). Megjithatë, në praktikë, IKLSH-ë do të duhet të vazhdojë të përpiqet të përshtatë rekomandimet e KP-së.

Roli i komisioneve parlamentare në auditimin e IKLSH-së

74. Në disa vende candidate/anëtare ligji i jep KP-së të drejtën të caktojë ose të sugjerojë auditues të jashtëm për të kryer auditimin vjetor të IKLSH-së (Shqipëri, Estoni, Hungari, Maltë, Slloveni). Në disa vende të tjera, është vetë IKLSH-ë që zgjedh audituesin e jashtëm (Republika Çeke, Letoni) ose ai e bën vetë auditimin e vetes (Bullgari, Kroaci, Qipro). Në Republikën Sllovaqe, auditimin e kryen Ministria e Financave. Në Poloni - sipas Ligjit mbi Dhomën e Lartë të Kontrollit -Sejm-i duhet të mbikëqyrë zbatimin e buxhetit të DHKL-së. Një zgjidhje e ngjashme ekziston edhe në Lituani.

75. Në disa vende, rezultatet e auditimit vjetor të IKLSH-së i dërgohen KP-së përkatëse për informim ose për shqyrtim (Shqipëri, Republika Çeke, Hungari, Maltë, Rumania). Më shpesh akoma, auditimi i IKLSH-së është një auditim financiar (Qipro, Republika Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Republika Sllovaqe, Slloveni). Rrallë ndodh që të kryhet auditimi i performancës (Shqipëri, planifikuar në Bullgari dhe Estoni).

Funksionet e komisioneve të tjera parlamentare

76. Në disa vende, komisionet parlamentare kryejnë gjithashtu edhe funksione të tjera që kanë lidhje me IKLSH-në:

- Ata kanë të drejtë të diskutojnë kandidatin/pjesëmarrësit për postin e Kryetarit të IKLSH-së ose për poste të tjera menaxhimi në IKLSH-ë, përfshirë këtu edhe të drejtën për të sugjeruar në fakt kandidatët për poste të tilla (Hungari, Rumania) ose të japin mendime për kandidatët përpara se parlamenti të marrë një vendim përfundimtar (Republika Çeke, Poloni).
- Ata kanë të drejtë t'i japin Kryetarit të Sejm-it një mendim në lidhje me ligjet e brendshme për IKLSH-në, të cilin ai e miraton (Poloni).

KAPITULLI 3: PRAKTIKA TË MIRA TË IDENTIFIKUARA

77. Çdo diskutim për marrëdhëniet midis një IKLSH-je dhe parlamentit të tij dhe i hapave që mund të ndërmerren për të përmirësuar këto marrëdhënie, duhet të fillojë nga pranimi i marrëdhënies së bashkëpunimit reciprok që ekziston idealisht ndërmjet këtyre institucioneve të rëndësishme, por të ndara. Parlamenti mund t'i kryejë funksionet e tij jetësore më efektivisht kur ai përdor dhe mbështet punën audituese të një IKLSH-je. Po ashtu, një IKLSH mund të jetë shumë më tepër efektiv kur parlamenti dhe komisionet e tij ofrojnë edhe një debat për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimit të IKLSH-së dhe mundësisht, një aleat në kryerjen vetë të veprimeve korrigjuese ose në nxitjen e të tjerëve për ta bërë këtë gjë.

78. Kjo pjesë e raportit ka për qëllim të identifikojë praktikatat e mira në marrëdhëniet midis IKLSH-ve dhe komisioneve parlamentare. Këto mbështeten në informacionin e grumbulluar në lidhje me situatën në vendet anëtare, siç përshkruhet në Kapitullin 2; në përvojat e vendeve me sisteme të marrëdhënive midis IKLSH-së dhe KP-së, të detajuara dhe të trajtuara në Aneksat dhe në gjykimet dhe analizat profesionale.

79. Rekomandimet mund të konsiderohen si udhëzime të mundshme për IKLSH-të. Marrëdhëniet zyrtare dhe ligjore midis IKLSH-së dhe parlamentit janë të ndryshme në vende të ndryshme. Çdo IKLSH-ë duhet t'i shohë rekomandimet në kuadër të situatës dhe rrethanave të tij të veçanta si edhe në kuadër të sistemit parlamentar të vendit në fjalë.

80. Pavarësisht nga ndryshimet në strukturën organizative dhe vendndodhjen zyrtare në strukturën e shtetit, kryesisht të gjitha IKLSH-të e pranojnë rëndësinë e:

- sigurimit të pavarësisë së IKLSH-së në përcaktimin e përparësive në auditim dhe në raportimin e drejtë, faktik dhe objektiv të rezultateve të auditimit.
- marrjes së vëmendjes së duhur parlamentare ndaj rezultateve të auditimit si një hap jetësor në kryerjen e veprimit korrigjues për problemet e zbuluara gjatë procesit të auditimit.

81. Realizimi njëherësh i të gjitha këtyre qëllimeve kërkon një veprim të kujdesshëm ekuilibruar. Një marrëdhënie shumë e ngushtë me parlamentin mund të kërcënojë pavarësinë e IKLSH-së, e cila përbën një themel thelbësor për besueshmërinë e tij. Nëse marrëdhënia është shumë e largët, parlamenti mund të injorojë gjetje të rëndësishme të auditimit. Çdo IKLSH-ë duhet ta gjykojë vetë se si mund të ruhet ekuilibri i përshtatshëm, duke pasur parasysh rrethanat e tij kombëtare të papërsëritshme.

82. Rekomandimet që vijojnë duhen parë nga këndvështrimi i IKLSH-ve. Megjithatë, disa rekomandime mund të kenë nevojë të diskutohen me kujdes me komisionet parlamentare përkatëse, ku ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe kanë të bëjnë me komisionet parlamentare.

83. Rekomandimet e paraqitura në këtë kapitull ndahen në dy grupe kryesore. Grupi i parë përfshin veprime që një IKLSH-ë duhet të mendojë t'i kryejë - nëse nuk i ka kryer - për t'u siguruar se është e përgatitur plotësisht për t'i dhënë parlamentit dhe komisioneve të tij ndihmë efektive dhe të besueshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së qeverisë. Të paktën në parim, këto janë veprime që duhet të jenë brenda kompetencës të IKLSH-së, megjithëse disa prej tyre mund të kërkojnë miratimin nga parlamenti të burimeve buxhetore shtesë.

84. Grupi i dytë i rekomandimeve përfshin veprime që parlamenti dhe komisionet e tij mund t'i ndërmarrin - nëse nuk e kanë bërë një gjë të tillë - për të forcuar funksionet e tyre të mbikëqyrjes dhe të përdorimit të punës audituese të IKLSH-së për këtë qëllim. Ky raport i drejtohet IKLSH-ve dhe pranon se një IKLSH-ë nuk ka autoritet (dhe as duhet të ketë) të mësojë parlamentin se si t'i kryejë ai përgjegjësitë e veta kushtetuese. Në këtë mënyrë, këto rekomandime kuptohen më mirë si çështje të cilat drejtuesit e IKLSH-së mund të duan t'i diskutojnë me drejtuesit e parlamentit dhe të tjerët që do të ndihmonin në forcimin e mbikëqyrjes parlamentare mbi veprimtarinë e qeverisë.

Rekomandimet për t'u marrë në konsideratë nga IKLSH-të

85. Këto janë hapa që IKLSH-ë mund të dojë t'i bëjë - nëse nuk i ka bërë - për të rritur efektivitetin auditues dhe dobinë e saj të mundshme në mbikëqyrjen parlamentare.

86. IKLSH-ë duhet të demonstrojë para parlamentit dhe komisioneve të tij se ai është një organ profesional i përgatitur të ndihmojë në një mënyrë profesionale. Për ta realizuar këtë, IKLSH-ë duhet të sigurohet se stafi i tij, i marrë në tërësi, i ka njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer të gjithë gamën e auditimeve që mund të kenë vlerë për parlamentin dhe komisionet e tij. Në varësi të rrethanave në një IKLSH-ë të veçantë, kjo gjë mund të kërkojë ndonjë ose të gjitha këto që vijojnë:

- miratimin e standardeve të përshtatshme të auditimit;
- hartimin dhe miratimin e manualeve të auditimit të cilat pasqyrojnë këto standard;
- trajnimin e stafit për të garantuar që standardet dhe procedurat janë kuptuar dhe mund të zbatohen;
- rekrutimin e stafit për të plotësuar mungesat e rëndësishme të shkathtësive të nevojshme;
- shqyrtimin e brendshëm dhe të jashtëm për të garantuar se puna audituese aktuale është në përputhje me standardet dhe procedurat.

87. IKLSH-ë duhet të garantojë gjithashtu që stafi i IKLSH-së i kryen detyrat e tij me objektivitet dhe profesionalizëm të përshtatshëm. Kjo mund të kërkojë çdonjërin ose të gjitha sa më poshtë:

- Miratimin e standardeve etike të përshtatshme dhe të rregullave të brendshme që zbatojnë këto standarde që mbulojnë ndër të tjera, shmangien e konflikteve personale e financiare të interesit dhe të konsideratës së papërshtatshme të faktorëve të militantizmit partiak.
- Trajnimin për standardet dhe për rëndësinë e objektivitetit dhe profesionalizmit në kryerjen e auditimeve dhe në raportimin e rezultateve të auditimit.
- Analizën e procedurave për të garantuar përputhjen me standardet.

88. IKLSH-ë duhet t'i kushtojë kujdesin e duhur shqetësimeve të deputeteve në përcaktimin e përparësive të auditimeve të tij. Megjithatë IKLSH-ë duhet të veprojë në mënyrë të pavarur, lidhjet e tij me parlamentin, veçanërisht me komisionet parlamentare, janë shpesh shumë të gjera. Është e paevitueshme - dhe e dëshirueshme - që IKLSH-ë të jetë e ndërgjegjshme për nevojat dhe interesat e parlamentit dhe të ekzekutivit dhe duhet t'i marrë ato parasysh në përcaktimin e përparësive të veta, ndërkohë që sigurohet se po i kryen përgjegjësitë e tjera që ka. IKLSH-të që dëshirojnë të nxisin marrëdhënie më të ngushta pune me parlamentin dhe komisionet e tij duhet të jenë të hapur në konsiderimin e pikëpamjeve të parlamentit për objektivitetin dhe përparësitë e auditimit. Ngritja e një njësie lidhëse, diskutuar në çështjen shtatë më poshtë, mund ta lehtësojë këtë gjë. Megjithatë, është themelore që pikëpamjet e parlamentit të mos jenë gjëja e vetme që merret parasysh dhe që IKLSH-ë të ruajë të drejtën e saj për të pranuar ose refuzuar sugjerimet e parlamentit dhe të kryejë auditimet me iniciativën e saj, pavarësisht nga pikëpamjet e parlamentit. Një arsye është se, nëse IKLSH-ë përqendrohet shumë në përgjigjen ndaj interesave të parlamentit, puna e saj mund të ndikohet nga shqetësimet militante në mënyrë të tillë që mund të dëmtojnë pavarësinë e perceptuar të IKLSH-së dhe kështu edhe besueshmërinë e tij. Një arsye tjetër është se deputetët e parlamentit mund të kenë agjenda afatshkurtra dhe kështu mund t'i japin përparësi të ulët arritjes së përmirësimeve afatgjata në menaxhimin financiar dhe çështjeve të tjera, të cilat për IKLSH-në kanë përparësi të lartë.

89. Mënyra me të cilën raportohen rezultatet e auditimit të IKLSH-së mund të ketë një ndikim të madh në reagimin parlamentar ndaj këtyre raporteve. Një IKLSH-ë duhet të jetë shumë përzgjedhës në lidhje me raportet që zgjedh për të paraqitur në parlament dhe në komisionet e tij në atë masë sa ai ka hapësirë për ta bërë këtë gjë. Zakonisht, deputetët e parlamentit janë njerëz shumë të zënë, kanë shumë materiale për të lexuar, më shumë sesa mund të arrijnë. Shumë raporte auditimi kanë të bëjnë me çështje administrative që mund të përballohen më mirë duke punuar më shumë me ministrinë në fjalë ose me Ministrinë e Financave sesa duke kërkuar vëmendjen e parlamentit. Në përgjithësi, shmangia e mbingarkesës së deputetëve do të bëhej më mirë nëse raportet e auditimit për këto çështje do t'i paraqiteshin ministrisë që ka lidhje me to, ndërsa parlamentit apo komisioneve përkatëse parlamentare t'u paraqiteshin përmbledhje periodike për informim. Në parim, IKLSH-ja duhet t'i raportojë parlamentit vetëm për çështje që beson se duhet të kenë patjetër vëmendjen e parlamentit. Këto mund të jenë raporte auditimi që zbulojnë probleme specifike të një rëndësie të tillë që mund të kërkojë presioni i parlamentit ose veprimi legjislativ për ta zgjidhur problemin, ose raporte që zbulojnë një model të qëndrueshëm të dështimit të një ose më shumë ministrive për të ndërmarrë veprime korrigjuese në lidhje me mungesat e zbuluara nga audituesit. Përveç kësaj, mund të ekzistojnë edhe kërkesa statutores sipas së cilave disa raporte t'i dërgohen parlamentit.

90. Raportet e auditimit të IKLSH-së që vlerësohen si materiale duhet t'i bëhen prezente parlamentit ose komisionit përkatës me një deklaram të qartë në lidhje me arsyen pse këto duhet të meritojnë vëmendjen e parlamentit. Raportet e përzgjedhura që janë pjesë e këtij koncepti të materialitetit mund të përmbajnë gjetje, vëzhgime, komente dhe rekomandime për çdonjërin nga pikat e mëposhtme:

- auditime të dokumenteve financiare të qeverisë;
- auditime mbi rregullsinë/përputhshmërinë e rregullave;
- auditime të tipit vlera e parasë/performancës;
- hetime;
- analiza të raporteve të auditimit të mëparshëm të një natyre të zakonshme;
- dokumente këshilluese;
- propozime dhe komente për projektligje;
- udhëzime për praktikë të mirë.

91. Stili i të shkruarit të raporteve të auditimit mund të luajë edhe ai një rol të rëndësishëm në nxitjen e interesit të deputetëve dhe të tjerëve për çështje të caktuara. Raportet duhet të jenë të qarta dhe koncize, por me të dhëna të mjaftueshme për të bindur një lexues objektiv, përfshirë edhe deputetët, për vlefshmërinë e gjetjeve të auditimit. Disa IKLSH-ë kanë zbuluar se është shumë e dobishme që të përfshihet një përmbledhje e shkurtër ekzekutive në raport me qëllim që të përçohen shpejt gjetjet dhe rekomandimet kryesore të lexuesit që nuk kanë shumë kohë. Raportet e auditimit duhet të shkruhen në një mënyrë të drejtë dhe me fakte dhe të merren me çështje të rëndësishme dhe në masën e duhur, të garantojnë komisionin parlamentar për mënyrën profesionale dhe serioze me të cilën është kryer auditimi dhe shkrimi i raportit nga IKLSH-ë, duke përforcuar besueshmërinë e rezultateve të auditimit. Raportet duhet të jenë të ekuilibruara, jomilitante, joideologjike dhe të shkruara në përputhje me legjislacionin për të shmangur kontradiktat me komisionet parlamentare. Raportet e auditimit zakonisht merren me kontrollin financiar, me menaxhimin e duhur të fondeve publike dhe me zbatimin nga qeveria të politikave të saj, por jo me politikën qeveritare në vetvete. IKLSH-ë duhet të jetë tërësisht apolitik. Në parim, IKLSH-ë duhet të shmangë komentet për politikën qeveritare. Megjithatë, në praktikë zbulimi i problemeve në zbatimin e këtyre politikave mund të ngrejë pyetje të pashmangshme për vetë politikën.

92. Shumë IKLSH-ë e kanë parë si të dobishme ngritjen e një njësie të ndarë ose caktimin e një personi për të koordinuar kontaktet e IKLSH-së me parlamentin. Përgjegjësitë e njësisë/personit mund të përfshijnë ruajtjen e kontakteve dhe të komunikimeve të përditshme me komisionet përkatëse parlamentare. Në po këtë rol, edhe njësi koordinuese e parlamentit mund të garantojë që IKLSH-ja t'i njohë interesat dhe shqetësimet aktuale të parlamentit të cilat duhet të merren parasysh kur IKLSH-ë harton programin vjetor të auditimit. Po ashtu, njësi mund të garantojë që deputetët e interesuar mbahen të informuar për punën e IKLSH-së që mund të ketë interes material për ta. Njësi e lidhëse mund të sigurojë edhe një kanal të dobishëm përmes të cilit deputetët të përcjellin pikëpamjet e tyre për çështjet e interesit të përbashkët të IKLSH-ë. Informacioni i grumbulluar nga njësi lidhëse për pikëpamjet e parlamentit në lidhje me punën e IKLSH-së duhet të diskutohen me drejtues të tjerë në IKLSH-ë. Njësi lidhëse mund të ndihmojnë në koordinimin e punës së njësisë të ndryshme të IKLSH-së me komisionet parlamentare.

93. Ndjekja e mëtejshme e çështjeve të auditimit material të viteve të shkuara duhet të përfshihet në programin vjetor të auditimit të IKLSH-së me qëllim që të sigurohet që është kryer veprimi që duhet nga i audituari. IKLSH-ë duhet t'i vërë rezultatet e kësaj analize në dispozicion të komisionit parlamentar përkatës, veçanërisht nëse zbulohet ndonjë model mosveprimi për probleme të rëndësishme. Nëse shihet e arsyeshme, IKLSH-ja duhet të jetë e përgatitur të ndihmojë komisionin parlamentar përkatës për shqyrtimin e këtyre çështjeve që dalin në vazhdim.

Çështje që drejtuesit e IKLSH-së mund të duan t'i diskutojnë me deputetët e parlamentit

94. Çështjet e trajtuara në këtë pjesë kanë të bëjnë me veprimet që janë brenda fushës së veprimit të parlamentit. Në raste të përshtatshme, drejtuesi i IKLSH-së mund ta ndjejë të dobishme t'i diskutojë këto çështje me drejtuesit e parlamentit dhe me deputetët të tjerë të interesuar për përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se IKLSH duhet të shmangë gjithmonë krijimin e

përshtypjes sikur kërkon t'i japë mësimë parlamentit se si t'i kryejë ai detyrat e veta kushtetuese. Për më tepër, IKLSH-ë duhet të theksojë natyrën bashkëpunuese të marrëdhënies ndërmjet parlamentit dhe IKLSH-së, hapat që IKLSH-ë ka hedhur për ta bërë veten më të dobishëm për parlamentin dhe pastaj të paraqesë çështjet e mëposhtme si veprime që parlamenti mund të ndërmarrë për ta bërë IKLSH-në sa më të dobishëm në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare.

Veprimet që ndikojnë drejtpërdrejt mbi marrëdhëniet ndërmjet IKLSH-së dhe parlamentit

95. Përkufizoni qartë në legjislacionin mbi auditimin e shtetit tipet e raporteve të auditimit dhe të dokumenteve të tjera të IKLSH-së që duhet të paraqiten në parlament. Idealisht, do të duhej të zgjidhej një numër i vogël raportesh të domosdoshme, sepse dihet që ato janë dokumente të rëndësishme shtetërore që meritojnë (kërkojnë) vëmendjen e parlamentit. Auditimi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit është vetëm një shembull i tillë. Raporte të tjera auditimi duhet t'i paraqiten parlamentit ose njërit prej komisioneve të tij vetëm nëse kjo gjë kërkohet ose nëse vlerësohet nga IKLSH që ato duhet të tërheqin vëmendjen e parlamentit.

96. Miratoni legjislacionin mbi auditimin e shtetit në një mënyrë të tillë që IKLSH-ë të mos vihet në varësi të ekzekutivit, por të japë llogari vetëm në parlament. IKLSH-ë duhet të jetë i pavarur nga institucionet e tjera sepse kjo pavarësi, bashkë me kompetencën dhe integritetin e stafit të tij, janë bazat themelore për besueshmërinë e IKLSH-së dhe, për pasojë, edhe për ndikimin e tij mbi parlamentin, ekzekutivin dhe publikun në përgjithësi.

97. Emëroni kreun e IKLSH-së në një mënyrë të tillë që ai/ajo të gëzojë sa më shumë konsensus në parlament. Kjo mund të bëhet nga parlamenti duke kryer konsultime të gjera me partitë e përfaqësuara përpara se të bëhet përzgjedhja e kryetarit të IKLSH-së përmes një shumice të thjeshtë ose të cilësuar nga të gjithë deputetët. Për më tepër, kryetari i IKLSH-së nuk duhet të hiqet me lehtësi nga posti kur ai është në detyrë, përveçse për arsye të vlefshme të posaçme të tilla si shëndeti, sjellja e papërshtatshme, mashtrimi ose paaftësia për të vazhduar për të kryer detyrën. Për ta mbrojtur më tej kreun e IKLSH-së nga presionet e mundshme politike dhe nga shkarkimi i padrejtë, çdo propozim për shkarkimin e tij mund të kërkohet të ketë konsensus të gjerë (le të themi, 2/3 e shumicës) në parlament.

98. Nëse IKLSH-ë duhet të jetë i besueshëm dhe më i dobishëm për parlamentin në funksionet e tij të mbikëqyrjes, ai duhet të shihet nga parlamenti dhe nga kushdoqoftë si një organ i pavarur, që ushtron gjykimin e tij në lidhje me çështjet që ka nën përgjegjësinë e tij. Marrëdhënia e parlamentit dhe e komisioneve të tij me IKLSH-në duhet të shihet si një marrëdhënie bashkëpunimi. Në këtë drejtim, IKLSH duhet të ketë kompetencën të përzgjedhë çështjet të cilat duhet t'i nënshtrohen auditimit (përveç atyre që i kërkohen nga ligji) dhe të vendosë si do t'i kryejë sa më mirë këto auditime. Në të njëjtën kohë, parlamenti dhe komisionet e tij kanë një interes legjitim si për programin e përgjithshëm të auditimit të IKLSH-së ashtu edhe për kërkimin e mbulimit me auditim të çështjeve që janë me interes të veçantë për ta. Komisionet parlamentare duhet të jenë në gjendje t'i sugjerojnë IKLSH-së çështje për auditim të cilën ata e konsiderojnë shqetësim të veçantë dhe IKLSH-ë duhet t'i marrë në konsideratë seriozisht propozime të tilla. Duke vepruar kështu, është me rëndësi që komisionet parlamentare të pranojnë se çdo propozim për përfshirje në programin vjetor të auditimit të IKLSH-së, ose si kërkesa shtesë në programin e auditimit duhet të merret patjetër në konsideratë nga IKLSH-ë në dritën e përparësive të tij të auditimit, të buxhetit të alokuar dhe të stafit në dispozicion. Vendimi përfundimtar do të merret nga IKLSH-ë.

99. Kontaktet midis IKLSH-së dhe komisioneve parlamentare duhet të përcaktohen qartë, me qëllim që marrëdhëniet e punës midis dy organeve të jenë të qëndrueshme. Në disa vende, veçanërisht në ato ku IKLSH-ë punon intensivisht me shumë komisione parlamentare, ka rezultuar e dobishme përgatitja e procedurave të shkruara që rregullojnë marrëdhënien. Këto procedura janë hartuar bashkërisht nga IKLSH-ë dhe drejtuesit e parlamentit. Intensiteti i këtyre kontakteve midis IKLSH-së dhe KP-së varet kryesisht nga kërkesat e Kryetarit të komisionit parlamentar dhe të anëtarëve të tij. Ato mund të shkojnë nga kontaktet në nivele shumë të larta (midis kryetarit të KP-së dhe kryetarit të IKLSH-së) deri në ato në nivelet më të ulëta (për shembull, midis stafit të KP-së dhe audituesve të IKLSH-së të përfshirë drejtpërdrejt në raportin e auditimit në fjalë).

100. Ndërtoni rregulla dhe procedura të qarta parlamentare për mënyrën sesi do të merren parlamenti dhe komisionet e tij me raportet e auditimit të IKLSH-së që prezantohen në të. Nëse nuk ekziston të paktën një KP-ë që ka përgjegjësi të qartë për t'u marrë me raportet e auditimit, atëherë parlamenti mund të dëshirojë të mendojë për dobinë e aktivizimit të një ose më shumë se një komision. Ekzistenca e një ose më shumë komisioneve parlamentare përgjegjëse për të reaguar ndaj raporteve të auditimit ndihmon që vëmendja e

qeverisë dhe e publikut të përqendrohet në gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga raportet e auditimit dhe që të ushtrohet presion për zbatimin e rekomandimeve të tilla. Vendimi nëse duhet të ekzistojë një komision parlamentar i specializuar që të merret me raportet e auditimit ose disa komisione (në varësi të tematikës me të cilën merret), është vendim që duhet të merret nga parlamenti i vendit në fjalë. Të dyja sistemet kanë anët e tyre të mira. Modelet e sistemeve efektive të KP-ve në vende me tradita të ngjashme politike dhe shoqërore mund të përdoren si shembuj të praktikave të mira për t'u përhapur. Aneksat që i shtohen këtij dokumenti japin shembuj të vendeve me sisteme të përparuar dhe efektive të marrëdhënieve ndërmjet IKLSH-së dhe KP-së.

101. Caktoni një KP-ë të merret (nuk është nevoja të merret ekskluzivisht) me dokumentet dhe aktivitetet financiare të IKLSH-së për të siguruar që parlamenti është në gjendje të monitorojë IKLSH-në, dhe jo thjesht vetëm raportet e tij. Funksionet e një komisioni të tillë (gjendet në disa vende) mund të përfshijnë:

- shqyrtimin dhe miratimin e projektbuxhetit të IKLSH-së;
- emërimin e audituesve të jashtëm për të audituar deklaratimet financiare të IKLSH-së dhe shqyrtimin e miratimin e dokumenteve të tilla financiare të audituara;
- Vlerësimin e veprimtarive audituese të IKLSH-së.

102. Përcaktoni qartë në legjislacion të drejtën e IKLSH-së për t'i bërë publike raportet e auditimit brenda një kohe të arsyeshme pas paraqitjes së këtyre raporteve në parlament ose para organeve të tjera, sipas rastit. Në të njëjtën kohë, disa raporte auditimi (të çuara në parlament ose jo) mund të përbëjnë, deri në njëfarë shkalle, siguri kombëtare, të ndjeshme nga ana tregtare, ose kanë një natyrë tjetër sekrete ose sensitive që do të ishte më mirë që raporti të mos diskutohet në publik për shkak të pasojave kontradiktore në dëm të interesit publik. Megjithatë raste të tilla duhet të jenë sa më të rralla që të jetë e mundur, do të ishte mirë nëse IKLSH-ë të kishte kompetencë të mos ia jepte këto raporte publikut të gjerë. IKLSH-ë mund t'i sugjerojë KP-së përkatës që një raport i tillë ose pjesë të tij të diskutohen privatisht nga KP-ë, nëse KP-ë nuk e ka marrë ende një vendim për mënyrën e veprimit me to.

Veprimet që mund të rrisin rolin e komisioneve parlamentare

103. Çështjet e mëposhtme, që mund të ofrohen për t'u marrë në konsideratë edhe nga deputetët e parlamentit, kanë të bëjnë me mënyrat e forcimit të veprimeve të komisioneve parlamentare kur ata mund të thërriten për të trajtuar raportet e auditimit të IKLSH-së, por që do të zgjerorin gjithashtu efektivitetin e komisioneve parlamentare në rolet e tjera që ata luajnë. Meqë përbërja dhe mënyra e veprimit të komisioneve parlamentare mund të ndryshojnë ndjeshëm nga një vend në tjetrin, disa nga këto sugjerime mund të mos jenë të përshtatshme dhe të vlefshme.

104. Elementet e gjetura në shumicën e komisioneve parlamentare dhe që vlerësohen si elemente me rëndësi të veçantë për funksionimin e duhur të një KP-je (zakonisht të rregulluar me Urdhrat e Përhershëm të parlamentit ose me ligj) përfshijnë:

- Kuorumin e kërkuar për një mbledhje të KP-së dhe për marrjen e vendimeve nga KP-ë.
- Kompetencën e KP-së për të thirrur çdo person për të dëshmuar në mbledhjet e KP-së dhe për të kërkuar çdo informacion që ka lidhje me çështjen që auditohet.
- Të drejtën e KP-së të kërkojë informacion shtesë me shkrim nga çdo person i rëndësishëm dhe që ka lidhje me çështjen që auditohet.
- Përbërjen e komisioneve parlamentare që pasqyrojnë përbërjen politike të partive në parlament. Masat ruajtëse, njëkohësisht, për të garantuar që komisionet parlamentare funksionojnë sa më shumë që të jetë e mundur në një mënyrë jopolitike si, për shembull, duke pasur për kryetar të KP-së (sidomos të një KP-je që është përgjegjës për mbikëqyrjen e IKLSH-së) një anëtar nga Partia e Opozitës. Një qasje alternative është garantimi se anëtarët e KP-së që mund të mos jenë dakord me shumicën të kenë të drejtën të dorëzojnë një raport të pakicës.

105. Siguroni staf mbështetës të mjaftueshëm që të ndihmojë komisionet parlamentare në detyrat e tyre. Po ashtu, komisionet parlamentare duhet të jenë në gjendje të përdorin ekspertë të pavarur siç kërkohen dhe kur kërkohen. Kjo mund të përfshijë dërgimin e të paktën një anëtarit të IKLSH-së për të ndihmuar KP-në në funksionet e tij raportuese. Kjo mund të jetë veçanërisht shumë e rëndësishme për përgatitjen e raporteve pasuese nga komisionet parlamentare për gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

106. Në shumë vende është parë të jetë me dobi lejimi i publikut të gjerë dhe i medias për të qenë të pranishëm në mbledhjet e komisionit parlamentar me qëllim që të nxitet transparenca dhe ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për çështjet e trajtuara. Përfundimisht më i rëndësishëm nga ky rregull duhet të jenë mbledhjet të cilat mbahen me detyrë të mbyllura për shkak të ndjeshmërisë ose të pasojave mbi sigurinë kombëtare të çështjeve që diskutohen.

107. Përvoja e disa IKLSH-ve tregon se ndikimi i raporteve të auditimit mbi qeverinë rritet kur një KP-ë i shqyrton raportet menjëherë. Kështu, kur IKLSH-ë këshillon komisionin parlamentar përkatës për një raport të rëndësishëm që do të dalë së shpejti, komisioni parlamentar duhet të bëjë përpjekje ta diskutojë raportin brenda një afati kohor të arsyeshëm për të shmangur rrezikun e vjetërimit të gjetjeve të raportit të auditimit.

108. Siç duhet që IKLSH-ë të përgatitet për mbledhjen e KP-së, mund të jetë e dobishme edhe për një kryetar të KP-së të bëjë përgatitjen e vet. IKLSH-ë mund të jetë në gjendje të ndihmojë stafin e komisionit parlamentar të përgatisë pyetje për çështjet kryesore të raportit të auditimit dhe t'i dorëzojë ato te kryetari i KP-së përpara mbledhjes së tij. Është në dorë të kryetarit të KP-së dhe të anëtarëve të tij nëse ata do t'i përdorin apo jo ato pyetje në mbledhjen pasuese të komisionit parlamentar.

109. Është e këshillueshme që kryetari i IKLSH-së dhe/ose stafi i lartë i tij të jetë i pranishëm në mbledhjet e KP-së kur diskutohen raportet e auditimit të IKLSH-së. Është gjithashtu një praktikë e mirë që përfaqësuesit e lartë dhe ekspertët teknikë të enteve të audituara të jenë të pranishëm në mbledhjen e komisionit parlamentar kur diskutohet për ta me qëllim që t'i përgjigjen çdo pyetjeje që mund të bëhet nga anëtarët e KP-së. Megjithatë pyetja e personave gjatë mbledhjes së KP-së përfshirë edhe ata nga IKLSH-ë është e drejtë e KP-së, kjo gjë rezulton e dobishme nëse pyetje të tilla ndërtohen në mënyrë të tillë që të theksojnë ose të përforcojnë gjetjet e auditimit.

110. Komisioni parlamentar duhet të jetë i lirë të kërkojë informacion shtesë përpara ose pas mbledhjes së KP-së me qëllim që të jetë në gjendje të sigurojë të gjithë informacionin që e konsideron të nevojshëm ose të dobishëm për diskutimin e një raporti auditimi ose të çështjeve të tjera.

111. Shumë komisione parlamentare e kanë parë të dobishëm ndërtimin e një procesi pasues të raporteve të auditimit nga IKLSH-ë për të ndihmuar të garantohet që gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit u është kushtuar vëmendja e duhur dhe që çdo mangësi në organin e audituar është korrigjuar.

112. Shumë komisione parlamentare e kanë praktikë të hartojnë, brenda një kohe të arsyeshme, raportin e tyre mbi bazën e një raporti auditimi të IKLSH-së që e kanë shqyrtuar dhe t'i japin qeverisë rekomandimet e tyre bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e IKLSH-së. IKLSH-ë mund t'i ofrojë ndihmë KP-së që po përgatit raportin e vet. KP mund t'i paraqis rekomandimet e veta për miratim në parlament. Kjo procedurë ndihmon të theksohen më shumë ato gjetje dhe rekomandime të auditimit me të cilat komisioni parlamentar bie dakord. Megjithatë, procedura është më efektive kur raporti i komisionit parlamentar ka marrë miratimin unanimitet të anëtarëve të KP-së. Unanimiteti është më i mundur nëse anëtarët i diskutojnë hapur të gjitha diferencat që mund të dalin dhe pastaj arrijnë një zgjidhje që mund të jetë e pranueshme për çdokënd në KP-ë. Kjo gjë do të ishte e vlefshme sepse veprimi korrigjues (siç e ka propozuar KP-ë), që do të merrte ekzekutivi mbi gjetjet e auditimit nuk do të dobësohej.

113. Komisioni parlamentar dhe raportet e IKLSH-së do të ishin më interesante dhe të pranueshme lehtësisht nga qeveria nëse ato përmbanin rekomandime që shihnin përpara dhe që mbështeteshin në mësimet e nxjerra nga e kaluara. Po ashtu, IKLSH-ë mund të japë edhe udhëzime mbi praktikën e mira duke u mbështetur në raportet e auditimit të shqyrtuara në të kaluarën.

114. Për një KP-ë mund të jetë e dobishme të ketë një sistem zyrtar që të përcaktojë nëse kërkohen/priten reagime nga qeveria në lidhje me raportet e IKLSH-së ose të KP-së.

115. Shumë parlamente e kanë parë të dobishëm për komisionet e tyre kërkimin e ndihmës teknike nga IKLSH në përgatitjen e propozimeve legislative, veçanërisht të atyre në lidhje me auditimin, menaxhimin financiar, dhe çështjet që u janë nënshtruar auditimeve të mëdha. Kjo ndihmë mund të përfshijë përgatitjen e projekteve fillestare të ligjeve të propozuara dhe dhënien e komenteve për draftet e përgatitura nga të tjerët. Në analizë të fundit, IKLSH-ë duhet të jetë i interesuar të zhvillojë marrëdhënie të mira pune me parlamentin dhe komisionet parlamentare. Një marrëdhënie e tillë pune është e mundshme vetëm nëse IKLSH-ë dhe KP-ë bashkëpunojnë në fushat me interes të përbashkët dhe nëse ata bien të dy dakord për sa u përket çështjeve të tilla.

ANEKSI 1: DOKUMENT I SHKURTËR I SIGMA-s PËR MARRËDHËNIET MIDIS INSTITUCIONEVE TË KONTROLLIT TË LARTE DHE PARLAMENTEVE³

Marrëdhëniet zyrtare dhe ligjore midis Institucioneve të Kontrollit të Lartë (IKLSH) dhe parlamentit janë të ndryshme në vende me demokraci të formuara. Në disa raste, IKLSH-ë i është atashuar zyrtarisht parlamentit. Kjo lidhje mund të jetë shumë e ngushtë. Në SHBA, Zyra e Llogarive të Përgjithshme përshkruhet kryesisht si një agjenci e pavarur në pushtetin legjislativ (parlamentar). Në raste të tjera, si në Francë, IKLSH-ë është një gjykatë me funksione të ngjashme me ato gjyqësore dhe ligjërish është e pavarur si nga parlamenti ashtu edhe nga qeveria. Në Mbretërinë e Bashkuar, Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm, i cili kryeson Zyrën e Auditimit të Shtetit, përshkruhet si një “nëpunës” i Dhomës së Komuneve me qëllim që të krijojë dhe demonstrojë qartë pavarësinë e tij/saj nga Shërbimi Civil. Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm bashkëpunon ngushtë me Komisionin e Llogarive Publike (KLLP) të Dhomës së Komuneve. Në Suedi, IKLSH-ë është zyrtarisht një agjenci e qeverisë (por ky status aktualisht po rishikohet).

Arsyet për këtë larmi të madhe mund të gjenden në historinë dhe kulturën e papërsëritshme të secilit vend. Në shumë raste, institucioni që më vonë u transformua në IKLSH-ë, e filloi punën si një instrument që i shërbente monarkut dhe mori pozitën e tij të sotme kur u pranua nevoja për një kapacitet të pavarur për të shqyrtuar qeverinë në emër të një komuniteti më të gjerë.

Megjithë diferencat në strukturën organizative dhe vendosjen zyrtare brenda strukturës shtetërore, faktikisht të gjitha IKLSH-të e pranojnë rëndësinë e:

- Sigurimit të pavarësisë së IKLSH-së për përcaktimin e përparësive të auditimit dhe për raportimin objektiv të rezultateve të auditimit.
- Dhënien e vëmendjes së përshtatshme të parlamentit ndaj rezultateve të auditimit si një hap jetësor për arritjen e veprimeve korigjuese ose të problemeve të dala gjatë procesit të auditimit.

Pajtimi i këtyre qëllimeve kërkon një veprim të kujdesshëm ekuilibruar. Një marrëdhënie shumë e ngushtë me parlamentin mund të kërcënojë pavarësinë e IKLSH-së, e cila është një bazë jetësore për besueshmërinë e tij. Nëse marrëdhënia është shumë e largët, parlamenti mund të injorojë gjetjet e rëndësishme të auditimit. Çdo IKLSH-ë duhet ta gjykojë vetë se si ta ruajë sa më mirë këtë ekuilibër të përshtatshëm duke marrë parasysh rrethanat e veçanta kombëtare.

Ashtu siç IKLSH-të ndryshojnë në strukturë dhe në vendosjen ligjore, parlamentet ndryshojnë në mënyrën se si ata i kanë marrë masat për të trajtuar raportet dhe informacionet e tjera të marra nga IKLSH-ë. Këto ndryshime pasqyrojnë historinë unike dhe kulturën politike të secilit vend. Me qëllim që të kuptohet se si parlamentet lidhen me funksionin e auditimit, kërkohet pranimi i një tensioni të brendshëm. Parlamentet janë institucione të larta politike dhe përbëhen, në pjesën më të madhe, nga politikanë profesionistë. Prirja e tyre natyrore është t’i shohin çështjet në një këndvështrim partiak ose ideologjik dhe t’u japin përparësi të ulët çështjeve që duket se nuk kanë rëndësi politike. Auditimi, *në vetvete*, është krejtësisht i lidhur me menaxhimin e ndershëm, eficient dhe efektiv dhe nuk është për çështje madhore të politikave. Auditimi duhet të jetë profesional dhe objektiv, efektiv dhe i besueshëm që shmanget me kujdes imazhin e mbajtjes së anës për çështje partiake dhe ideologjike.

Parlamentet kanë reaguar në mënyra të ndryshme ndaj këtij tensioni. Një qasje e zakonshme në rritje është caktimi i një komisioni të vetëm, i quajtur shpesh Komision i Auditimit Publik (KAP) për të marrë dhe shqyrtuar të gjitha ose pjesën më të madhe të raporteve të përgatitura nga IKLSH-ë. Në shumicën e rasteve ekziston një pritshmëri e qartë se anëtarët e KAP-it do të merren me raportet e auditimit në mënyrë objektive, profesionale dhe jopartiake. Kjo është e vështirë në vetvete për një politikan profesionist, veçanërisht në një demokraci të re pa ndonjë traditë të ndarjes së politikës nga administrata. Megjithatë, ka të dhëna të mjaftueshme nga demokracitë e konsoliduara se trajtimi jopartiak i rezultateve të auditimit mund të arrihet nëse vlerësohet ai qëllim ashtu siç duhet dhe nëse ka hapa që mund të ndërmerren për të përforcuar pritshmërinë e frymës jopartiake.

³ Dokumenti u botua në 27 nëntor 2000 në faqen e internetit të SIGMA-s Q&A: <http://www.oecd.org/sigma>.

Shtetet anëtare të BE-së⁴

Danimarka

Danimarka, për shembull, ka një kulturë politike shumëpartiake dhe një traditë të qeverive me koalicion. Anëtarësia në KAP çmohet shumë nga parlamentarët dhe anëtarësimi bëhet në raport të barabartë me madhësinë e 4-6 partive më të mëdha, përfshirë edhe ato që janë pjesë e koalicionit qeverisës dhe ato që nuk janë. Kryetari i KAP-it tradicionalisht përfaqëson një parti e cila nuk është pjesë e koalicionit qeverisës.

Raportet e Zyrës së Auditimit të Shtetit (ZASH) publikohen vetëm nga KAP-i dhe shoqërohen nga përfundimet e KAP-it në lidhje me auditimin. Pavarësisht nga anëtarësia e fragmentuar partiake e KAP-it, tradita e frymës jopartiake është e tillë që të gjitha raportet e KAP-it janë unanime.

Franca

Gjatë diskutimit të masave të Francës në këtë kontekst, është me rëndësi themelore të theksohet se IKLSH-ë e Francës, Gjykata e Llogarive (Cour des Comptes), është një gjykatë me funksione pothuajse të njëjta si ato të gjykatave. Sipas kushtetutës, Gjykata e Llogarive është e pavarur edhe nga parlamenti, edhe nga qeveria. Kushtetuta përcakton se Gjykata e Llogarive “ndihmon parlamentin dhe qeverinë në mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit të shtetit” dhe, që në vitin 1996, “në mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve që drejtojnë financimin e sigurimeve shoqërore”. Deri kohët e fundit, në parlament nuk kishte një ekuivalent të KAP-it. Marrëdhëniet midis Gjykatës së Llogarive dhe parlamentit lidheshin vetëm me dorëzimin e raporteve vjetore dhe vetëm rast pas rasti ishin ndërtuar marrëdhënie të ngushta pune, për shembull, kur ose Dhoma e Lartë, ose Dhoma e Ulët i kërkonin Gjykatës së Llogarive të raportonte mbi një çështje të posaçme, një kërkesë të cilën Gjykata e Llogarive ishte dhe është ende e lirë ta pranojë ose jo.

Në janar të vitit 1999, parlamenti ngriti Misionin e Vlerësimit dhe të Kontrollit (MVK) si një nënkomision të Komisionit të Financave Publike të Parlamentit Kombëtar, me qëllimin që ai do të funksiononte si një ekuivalent i KAP-it. Për të minimizuar frymën partiake në punën e MVK-së, partitë kanë një përfaqësim të barabartë në komision dhe ky drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga partia kryesore e shumicës dhe një nga partia kryesore e pakicës. Raportet e MVK-së që bazohen në rezultatet e Auditimit të Gjykatës së Llogarive (përfshirë edhe seancat dëgjimore të kryera nga MVK) përgatiten nga një raportues i MVK-së i cili bashkëpunon ngushtë me ekipin përkatës të auditimit të Gjykatës së Llogarive.

Do të ishte e parakohshme të bëheshin gjykime të prera për efektivitetin e kësaj mase të re, por treguesit e fillimit janë të kënaqshëm, premtues dhe inkurajues. Është treguar se parlamenti dhe Gjykata e Llogarive mund të bashkëpunojnë ngushtë pa shkelur pavarësinë e Gjykatës së Llogarive. MVK ka qenë në gjendje të punojë në një mënyrë të arsyeshme jopartiake dhe njerëzit në Gjykatën e Llogarive kanë reaguar në tërësi në mënyrë pozitive për punën në bashkëpunim me MVK-në.

Portugalia

Gjykata e Auditimit në Portugali, si edhe homologia e saj në Francë, është një gjykatë me funksione të rëndësishme gjyqësore dhe është e ndarë me kushtetutë nga parlamenti dhe qeveria. Në të kaluarën, marrëdhëniet e saj me parlamentin janë kufizuar në dërgimin e disa raporteve të caktuara të kërkuara dhe në dërgimin disa raporteve të tjera të cilat kjo gjykatë zgjedh t'i dërgojë si edhe në përgjigjen ndaj kërkesave të parlamentit për informacion ose këshillë.

Nuk ka Komision të Auditimit Publik. Komisioni i Ekonomisë, Financave Publike dhe Planifikimit (KEFPP) ka disa nga përgjegjësitë të cilat në vende të tjera i ka KAP-i. Ai merr dhe shqyrton raportet e auditimit dhe mund të kërkojë informacion, këshilla përkatëse dhe auditime të posaçme në emër të parlamentit. KEFPP-i është komisioni më i madh i parlamentit. Ai ka përfaqësues nga të gjitha palët dhe kryesohet nga një anëtar nga partia më e madhe e opozitës.

Gjykata e Auditimit e ka pranuar nevojën për marrëdhënie më të ngushta dhe më të forta me parlamentin. Ajo ka luajtur një rol proaktiv në nxitjen e takimeve, shkëmbimin e informacionit dhe në dhënien e këshillave për

⁴ Shih edhe tabelën në Shtojcën A.

KEFPP-in. Po ashtu, ajo ka nxitur krijimin e një KAP-i. Kjo nuk është parë si një kërcënim për pavarësinë e Gjykatës për shkak të statusit kushtetues të Gjykatës.

Mbretëria e Bashkuar

Në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioni i Auditimit Publik është një nga komisionet më prestigjioze të Dhomës së Komuneve. Puna e tij respektohet shumë. Ekziston një traditë e fortë që anëtarët e KAP-it duhet të jenë jopartiakë në punën e tyre në KAP. Vendet e KAP-it ndahen në raport me madhësinë e përfaqësimit të partive politike në Dhomën e Komuneve. Kryetari, sipas traditës, është një deputet, anëtar i lartë i partisë së opozitës, zakonisht me përvojë të mëparshme si ministër i Ministrisë së Financave. KAP-i e nxjerr raportin e tij zakonisht pas shqyrtimit të dëshmitarëve në lidhje me raportin e Zyrës së Auditimit të Shtetit (ZASH). Pavarësisht nga përbërja partiake e KAP-it, raportet e tij janë gjithmonë unanime. Kjo traditë jopartiake mbështetet nga dy faktorë të tjerë: së pari, ZASH-i shmang me forcë komentet për çështje që shihen si çështje me natyrë “të politikës”. Së dyti, ekziston një traditë që, për faktet që dalin në dritë në një auditim (por jo domosdoshmërisht përfundimet dhe rekomandimet) duhet të bien dakord ZASH-i dhe i audituari si “të drejta dhe të sakta” përpara se të dalë raporti i auditimit. Këto praktika e pakësojnë ndjeshëm mundësinë për mosmarrëveshje të mundshme partiake gjatë mbledhjeve të komisionit dhe kur hartohen raportet pasuese të KAP-it.

Pavarësisht nga marrëdhëniet e ngushta midis ZASH-it dhe parlamentit, ekziston një rrezik i vogël i cënimit të pavarësisë së ZASH-it. Këtë pavarësi e përforcojnë disa faktorë. Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm duke qenë një nëpunës i Dhomës së Komuneve, emërohet në një mënyrë apolitike për të qenë me kontratë të përhershme. Përveç kësaj, Dhoma ka një traditë të gjatë të respektimit të pavarësisë së ZASH-it për shkak të vlerës që i japin anëtarët e tij besueshmërisë së ZASH-it në publik.

Shtetet perëndimore ioanëtare

Australia

Në Australi, ekzistojnë disa ngjashmëri me rregullat në Mbretërinë e Bashkuar, por ekzistojnë po ashtu edhe dallime të rëndësishme. Komisioni i Përbashkët i Llogarive Publike dhe i Auditimit (KPLPA) në Australi ka anëtarë si nga Senati ashtu edhe nga Dhoma e Përfaqësuesve. Ai ka një shumicë anëtarësh nga partia qeverisëse dhe kryesohet nga një anëtar nga kjo parti. Megjithatë, nënkryetari është gjithmonë nga partia e opozitës. KPLPA shqyrton të gjitha raportet e ZASH-it dhe, përveç kësaj, mund të marrë në shqyrtim çështje me iniciativën e vet ose në përgjigje të rekomandimeve që i bën parlamenti. KPLPA ndihmohet në punën e saj nga sekretariati dhe nga vëzhguesit dhe të dërguarit nga Departamenti i Financave dhe ZASH-i. Si edhe në shumicën e vendeve me KAP ose me ekuivalentin e tij, tradita e frymës jopartiake është shumë e fortë, pavarësisht nga përkatësitë partiake të anëtarëve. Përveç tre nga 359 raportet e nxjerra prej KPLPA-së që prej vitit 1953, të gjithë raportet e tjera kanë qenë unanime.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Pavarësisht nga këto dhe shumë shembuj të tjerë të KAP-eve shumë efektive dhe jopartiake, ato nuk përdoren në të gjitha vendet. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shembull, nuk ekziston një ekuivalent real i KAP-it në Kongresin e SHBA-së. Zyra e Llogarive të Përgjithshme (ZLLP e SHBA-së) duhet të lidhet me shumë komisione si në Senat ashtu edhe në Dhomën e Përfaqësuesve dhe me anëtarët e shumicës dhe të pakicës në këto komisione. Nuk ekziston një traditë e fortë e frymës jopartiake, megjithëse ekziston një traditë (disi më e dobët tani sesa në kohët e shkuara) e bashkëpunimit dypartiak mbi çështje që nuk duken se janë çështje politike. Kufiri midis çështjeve “politike” dhe “apolitike” mund të jetë shumë i paqartë, në varësi të çështjeve në fjalë. Këta faktorë shpesh i bëjnë detyrat e ZLLP-së të SHBA-së më të vështira, meqë nuk ekziston një komision qartësisht i identifikueshëm që do të ishte i interesuar dhe pranues për rezultatet e auditimit. Shpesh është e nevojshme për ZLLP-në e SHBA-së që, për të siguruar vëmendjen e nevojshme të kongresit, të përdorë rrugë që mund të duken shumë agresive për IKLSH-të dhe deputetët e tjerë, të tilla si kërkimi i vëmendjes së medias dhe të publikut për auditimet e rëndësishme si një mjet i nxitjes së interesit të kongresit në këtë gjë.

Përfundim

Nuk ekziston vetëm një rrugë për të tërhequr vëmendjen parlamentare për rezultatet e auditimit. Një nga pengesat kryesore është se parlamentet në tërësi, duke qenë se kanë natyrë politike, mund të priren për fat të keq t'i japin një përparësi të vogël përgjegjësive të tyre për çështjet "jopolitike" të menaxhimit, administrimit, dhe të kontrollit financiar. Një hap shumë i dobishëm në kapërcimin e kësaj pengese mund të jetë krijimi i një KAP-i, që mund të ndihmojë që vëmendja dhe përgjegjësia të përqendrohet në shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe në veprimet korrigjuese që pasojnë.

Që një KAP të jetë sa më efektiv, është e rëndësishme që anëtarët e tij ta shohin punën e tyre edhe si të rëndësishme edhe si jopartiake në natyrë. Kjo varet, së pari dhe kryesisht, nga qëndrimet e anëtarëve të tij. Tradita e frymës jopartiake në një KAP mund të bëhet një faktor vetëpërforcues me kalimin e kohës, por të paktën fillimisht, ai kërkon një përpjekje të ndërgjegjshme të anëtarëve për të ndarë punën e tyre në KAP nga lidhjet dhe simpatitë partiake. Kështu, një hap i rëndësishëm është përzgjedhja e anëtarëve duke parë me vëmendje se si do të mund të jetë qasja e tyre ndaj punës. Qëllimi i frymës jopartiake mund të theksohet më tej duke siguruar një përfaqësim të gjerë dhe të ekuilibruar të partive në KAP. Drejtuesit e KAP-it janë edhe ata me rëndësi jetike. Duket se është dobishme nëse kryetari ose nënkryetari është një anëtar i lartë dhe i respektuar i një partie e cila nuk i është bashkuar qeverisë. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që drejtuesit të jenë të angazhuar fort për arritjen e objektivitetit dhe të frymës jopartiake, të tilla si përpjekjet serioze për të kërkuar unanimitetin e veprimeve të KAP-it.

Megjithëse një pjesë e madhe e këtij diskutimi përqendrohet tek fakti se çfarë duhet të bëjnë parlamentet për të përdorur më efektivisht rezultatet e auditimit, do të ishte gabim të mendohej se e gjithë përgjegjësia bie mbi parlamentin. IKLSH ka edhe ai një përgjegjësi të madhe për të ndihmuar parlamentin në përdorimin e punës së IKLSH-së. Për të nxitur një marrëdhënie efektive, IKLSH-ë duhet:

- t'i raportojë parlamentit vetëm për çështje që vërtet tërheqin vëmendjen e tij;
- të raportojë qartë dhe shkurt, por me të dhëna të mjaftueshme për të bindur një lexues objektiv për vlefshmërinë e gjetjeve të auditimit;
- të garantojë që raportet e auditimit të jenë të drejta, të sakta dhe të merren me çështje të rëndësishme në kohën e duhur;
- të përgatitet të punojë me deputetët pas përfundimit të raportit të auditimit për të garantuar se ata e kuptojnë natyrën dhe rëndësinë e gjetjeve të auditimit, dhe t'i ndihmojë ata të ndërmarrin veprimet e përshtatshme korrigjuese, por pa sakrifikuar pavarësinë e IKLSH-së;
- të ndërtojë procedura të forta që qeveria të reagojë zyrtarisht ndaj rekomandimeve të parlamentit dhe të IKLSH-së.

Më shumë informacion

Bashkangjitur me këtë përgjigje, ju lutemi gjeni një listë faktesh që përmbledhin karakteristikat kryesore të disa prej KAP-ve ekzistuese në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet perëndimore joanëtare të BE-së (Shtojca A).

Ju lutemi, gjeni bashkangjitur edhe një listë /udhëzues të shkurtër mbi disa çështje praktike të sugjeruara për t'u marrë parasysh kur ngrihet një komision parlamentar auditimi (Shtojca B).

Shtojca A: Komisioni i Llogarive Publike - listë me fakte

Vendi	Legjislacioni	Numri i anëtarëve	Procedurat e emërimit	Lidhjet e zakonshme politike të kryetarit dhe të anëtarëve	Marrëdhëniet me IKLSH-në
Australia	Me ligj është ngritur Komisioni i Përbashkët i Llogarive Publike dhe Auditimit. Ky ligj përcakton madhësinë e tij dhe detyrat kryesore. Detyra të tjera mund t'i caktohen këtij komisioni nga Urdhrat e Përhershëm të miratuara nga të dyja dhomat e parlamentit.	Me ligj, 16 anëtarë, 6 nga Senati dhe 10 nga Dhoma e Përfaqësuesve.	Emëruar nga Senati dhe nga Dhoma e Përfaqësuesve.	Kryetari dhe shumica e anëtarëve janë nga partia në pushtet.	Të gjitha raportet e auditimit të ZASH-it merren nga KPLPPA. ZASH-i delegon staf për të ndihmuar në punën e Komisionit.
Danimarka	KAP-i ngrihet mbi bazën e kushtetutës. Ligji përcakton madhësinë dhe përgjegjësitë e KAP-it. Legjislacioni dytësor (urdhri parlamentar) përcakton procedurat për emërimin dhe shkarkimin e KAP-it.	Me ligj, 4-6 anëtarë. Vitet e fundit janë 6 anëtarë.	Emëruar nga Parlamenti për 4 vjet. Posti i anëtarit është i pagueshëm.	4-5 partitë më të mëdha të përfaqësuar në parlament. Kryetari zgjidhet nga anëtarët e KAP dhe tradicionalisht jo nga koalicioni qeverisës.	Në Ligjin për Audituesin e Përgjithshëm (një nëpunës i parlamentit) thuhet se ai ndihmon KAP-in dhe vepron me kërkesë të tij. Rekomandimet e KAP-it jepen vetëm në raportet dhe gjetjet e Audituesit të Përgjithshëm.
Franca	MVK është ngritur me një rezolutë të zyrës të Parlamentit Kombëtar. Kjo rezolutë kërkon zbatimin e rregullave të përgjithshme të procedurave për organet vartëse të Parlamentit Kombëtar.	15 anëtarë të emëruar çdo vit.	Emërohen nga komisioni i financave publike dhe janë anëtarë të tij. Këtyre iu shtohen edhe disa përfaqësues të komisioneve të tjera.	Të gjitha partitë pjesëmarrëse në Parlamentin Kombëtar janë përfaqësuar me një numër të barabartë. Bashkëkryesimin e ka mazhoranca dhe minoranca.	IKLSH-ë (Cour des Comptes) është tërësisht i pavarur nga parlamenti dhe nga qeveria, por i ndihmon të dy. Gjykata e Llogarive (CdC) informon MVK-në për çështje të auditimit që janë shumë të rëndësishme ose ato që paraqesin interes të veçantë e që janë gati për punën në parlament. Pjesëmarrja e stafit të CdC në punën e MVK-së (përgatitja e seancave dëgjimore, vazhdimi nga MVK). Rekomandimet e MVK-së gjenden kryesisht por jo vetëm në raportet dhe gjetjet e

Mbretëria e Bashkuar	<i>Komisioni i Llogarive Publike</i> , është ngritur në vitin 1861, me procedurë parlamentare për të shqyrtuar “llogaritë që tregojnë përdorimin e dejtë të fondeve të dhëna nga parlamenti për të përballuar shpenzime publike dhe llogari të tjera të tilla që i vihen para parlamentit, siç e mendon vetë Komisioni të përshtatshme”.	Përbëhet nga kryetari dhe 15 anëtarë. Kuorumi është 4.	Emëruar për afatin kohor të vetë parlamentit.	Kryetari është një anëtar me përvojë i një partie politike të opozitës. Anëtarët caktohen në raport me vendet e partisë në parlament. Raportet njihen si raporte jopolitike dhe merren vetëm me çështje administrative dhe jo çështje të politikave.	Shumica e punës së Komisionit qëndron në shqyrtimin e vlerës së raporteve të hartuara nga Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm dhe Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm i Irlandës së Veriut për të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë.
SHBA	Nuk ka KAP ose një ekuivalent të tij. ZLLP e SHBA-së punon me të gjitha komisionet e Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve si edhe me anëtarë të mazhorancës dhe minorancës.	Ngritur sipas rregullave të përcaktuara nga Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve dhe ndryshon nga një komision në tjetrin.	Numri i anëtarëve nga secila parti vendoset nga partia në mazhorancë në atë organ. Anëtarët për të zënë këto poste zgjidhen nga partitë përkatëse.	Kryetari dhe shumica e anëtarëve të secilit komision janë nga partia e shumicës. Kjo mund të jetë, por mund edhe të mos jetë partia e Presidentit të SHBA-së.	Pjesa më e madhe e punës audituese të ZLLP-së të SHBA-së iu përgjigjet kërkesave nga komisionet ose anëtarët. Rezultatet pastaj dërgohen në komisionin që i ka kërkuar ose te anëtarët ose te komisioni që ka juridiksionin legjislativ. ZLLP-ë e SHBA-së punon gjithashtu me komisionin përkatës për të kërkuar veprime korrigjuese.

Shtojca B: Listë me çështje që duhet të merren parasysh kur ngrihet një Komision Parlamentar për Auditimin Publik (KAP)

Komisionet Parlamentare të Auditimit Publik (KAP-et) janë pjesë e kuadrit të strukturuar për llogaridhënien dhe financat e qeverisë në kohën që parlamenti autorizon shpenzime për t'u bërë dhe merr informacion të mjaftueshëm që ekzekutivi të japë llogari për shpenzimet dhe menaxhimin e mirë të parave publike, të të ardhurave dhe asetëve. Në këtë kuadër, qëllimi i Komisionit Parlamentar të Auditimit Publik është të përmirësojë mënyrën e shpenzimit të parave publike përmes procesit të grumbullimit të të dhënave, të identifikimit të dobësive dhe të dhënies së rekomandimeve objektive teknike e jopartiake bazuar fort dhe drejt në fakte me qëllim që të shmangët përsëritja e shpenzimeve të parregullta të parave publike. Në këtë kontekst, tiparet kryesore që duhet të merren parasysh kur ngrihet një Komision Parlamentar për Llogaritë Publike janë:

Përgjegjësitë

Përgjegjësitë për ngritjen e një komisioni për të shqyrtuar llogaritë publike dhe raportet e auditimit përcaktohen më mirë nga parlamenti, sidomos në formën e rezolutave ose të urdhrave të përhershëm, sesa nga legjislacioni i posaçëm.

Përgjegjësia e parë e komisionit duhet të jetë shqyrtimi i llogarive financiare dhe i raporteve të auditimit të organeve dhe të enteve publike të paraqitura në parlament. IKLSH-ë i dërgon rregullisht raporte të tilla parlamentit. Ky komision duhet të ketë një interes të gjerë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe kontrollin financiar.

Në emër të parlamentit, komisioni pritët të ketë interes për mënyrën se si vepron IKLSH-ë dhe këtë interes duhet ta shprehë ndoshta duke komentuar mbi planet dhe buxhetet e IKLSH-së, por pa ndërhyrë në pavarësinë kushtetuese të Audituesit të Përgjithshëm.

Përbërja

Komisioni duhet të ketë një strukturë mundësisht të përcaktuar në urdhrat e përhershëm të parlamentit dhe kjo strukturë duhet të përcaktojë madhësinë dhe numrin minimal të anëtarëve të nevojshëm për të formuar një kuorum.

Anëtarët e komisionit duhet të emërohen ndoshta pas konsultimesh midis grupeve kryesore politike sa më shpejt pas mbledhjes së parë të parlamentit që del pas zgjedhjeve të përgjithshme. Ekuilibri politik në përbërjen e komisionit është themelor për të ndihmuar që të garantohet se raportet do të jenë konstruktive, të paanshme, dhe të bazuara në fakte të vërteta dhe realiste. Emërimi i kryetarit është punë e komisionit dhe do të jetë mirë nëse kryetari është një anëtar i lartë i opozitës parlamentare.

Anëtarët e komisionit mund të jenë më efektivë në shërbimin e tyre për komisionin nëse ky shërbim zgjat aq sa e ka jetën edhe vetë parlamenti, pa i përtërirë ata çdo vit.

Programi

Komisioni duhet të përcaktojë programin e tij të punës, ndoshta me këshillën paraprake të Institucionit të Kontrollit të Lartë (IKLSH). Të gjithë anëtarët duhet të marrin pjesë në përzgjedhjen e tematikave për shqyrtim. Programi i punës do të mbështetet kryesisht në raportet që IKLSH planifikon të përgatisë.

Shpeshësia e mbledhjeve dhe kohëzgjatja e tyre duhet të varet nga sasia e materialit të disponueshëm për komisionin, por njëherësh duhet të sigurohen edhe shanse të mjaftueshme që komisioni të mbledhë të dhëna dhe t'i raportojë gjetjet e tij në kohën që çështjet janë ende aktuale.

Procedura

Është e vlefshme për komisionin të ketë një dokument të shkurtër përpara se të fillojë seanca dëgjimore, i cili të parashtrijë çështjet e rëndësishme në raportin e auditimit dhe të identifikojë pyetjet e mundshme.

Kryetari/Audituesi i Përgjithshëm ose ekuivalenti i tij mund të përgatisin një dokument të shkurtër. Forma të tjera që mund të jenë të dobishme janë informimi me gojë ose prezantimet nga audituesit.

Komisioni duhet të ketë kompetenca të gjera për të thirrur persona për t'iu dhënë të dhëna dhe informacion për çështje që ata shqyrtojnë dhe për të kërkuar informacion dhe dokumente kur është e nevojshme.

Megjithëse nuk pritet të jetë tipar i rregullt i punës së komisionit, ai duhet ta ketë të mundur të bëjë edhe vetë inspektive në terren.

Të gjithë anëtarët e komisionit duhet të kenë mundësinë të bëjnë pyetje. Është e nevojshme të përcaktohet edhe koha në dispozicion me qëllim që të garantohet se të gjithë anëtarët e kanë këtë mundësi.

Mbajtja e procesverbalit të hollësishëm të punimeve të komisionit do të ndihmojë në përgatitjen e raporteve që do të vijin më pas.

- Komisioni duhet të vendosë që më parë se cilët dëshmitarë dëshiron ai të thërrasë. Meqë theksi i punës së komisionit është në zbatimin e politikave më shumë sesa në vetë politikat, dëshmitarët kyç do të jenë nëpunës të lartë civilë më shumë sesa politikanë.
- Komisioni duhet presë që dëshmitarët të jenë informuar mirë për temën që diskutohet dhe, megjithatë mund të jetë e paarsyeshme të presë që ata të jenë në gjendje t'i përgjigjen çdo pyetjeje të veçantë, veçanërisht për tema shumë të gjera. Do të ishte e dobishme që dëshmitarët të mbështeteshin nga zyrtarët e tyre, ndërsa komisioni të pranonte të dhënat me shkrim nëse përgjigjet për pyetjet e deputetëve nuk janë të gatshme të jepen aty.
- Pjesëmarrja e një përfaqësuesi nga Ministria e Financave në mbledhjet e komisionit mund të ndihmojë të garantohet se çështjet e gjera për kuadrin financiar të marrin përgjigje, megjithëse ndoshta kjo mund të mos jetë patjetër themelore.
- Pjesëmarrja e Kryetarit/Audituesit të Përgjithshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve për punën audituese dhe për të dhënë këshilla dhe informacion teknik është themelore për komisionin.
- Mbledhjet që merren me të dhënat është më mirë të bëhen në publik nëse mendohet që ato të ndihmojnë në kryerjen e një procesi publik dhe të hapur llogaridhënieje.

Raportimi

Komisioni duhet t'ua dërgojë raportet e tij subjekteve për të cilët ai ka grumbulluar të dhëna. Këto duhet të shihen si dokumente të ekuilibruara, që komentojnë për anët e mira, për kritikën e justifikuar dhe që vënë në dukje kur nuk janë të kënaqur me të dhënat e ofruara. Raportet duhet të përqendrohen në dhënien e rekomandimeve konstruktive dhe vënien në dukje të mësimave të nxjerra. Ato duhet të miratohen me konsensus nga komisioni.

- Raporti i komisionit mund të bazohet në të dhënat që i janë ofruar komisionit (këto do të jenë kryesisht raporte nga Kryetari/Audituesi i Përgjithshëm), duke iu referuar në mënyrë të veçantë ideve të vëna në dukje nga dëshmitarët gjatë mbledhjeve për marrjen e të dhënave me gojë.
- Kryetari/Audituesi i Përgjithshëm mund të përgatisë projekt-raportin e parë të komisionit. Komisioni pastaj mund të shqyrtojë dhe të amendojë projekt-raportin në një mbledhje të mbyllur me Audituesin e Përgjithshëm. Komisioni mund të miratojë raportin për publikim, në përputhje me procedurat e parlamentit për çështje të tilla.
- Nëse raportet e komisionit dalin menjëherë pas mbledhjes për grumbullimin e të dhënave është shumë e dobishme pasi çështjet mund të jenë ende aktuale dhe rekomandimet mund të kenë një ndikim të menjëhershëm.
- Komisioni mund të dojë të shoqërojë publikimin e raportit me një deklaratë për shtyp për të ndihmuar në një mbulim më të mirë mediatik. Në rastet e përshtatshme, kryetari mund të dojë ta shoqërojë këtë edhe me një konferencë për shtyp.
- Qeveria duhet të jetë e detyruar të reagojë zyrtarisht dhe publikisht ndaj rekomandimeve të dhëna në raportin e komisionit.
- Në rastet kur reagimi i qeverisë nuk është i kënaqshëm sipas mendimit të komisionit, është me rëndësi themelore që komisioni të ketë kompetencën që të organizojë një mbledhje tjetër për grumbullimin e të dhënave.
- Që të përmbillet qarku i llogaridhënies, parlamenti duhet të ketë rregullisht mundësi të shqyrtojë dhe të diskutojë për raportet e Kryetarit/Audituesit të Përgjithshëm, të komisionit dhe për reagimet e qeverisë.

ANEKSI 2: MARRËDHËNIET NDËRMJET GJYKATËS EUROPIANE TË AUDITORËVE DHE KOMISIONEVE TË PARLAMENTIT EUROPIAN⁵

1. Roli dhe objektivat e përgjithshëm të Parlamentit dhe të Komisioneve Parlamentare në lidhje me Gjykatën Europiane të Auditorëve (GJEA)

Parlamenti Europian (PE) ka kompetenca të mëdha në lidhje me buxhetin europian dhe Gjykatën Europiane të Auditorëve (GJEA). Marrëdhëniet midis PE-së dhe GJEA-s nuk kanë të bëjë vetëm me raportet e Gjykatës, por mbulojnë një gamë të gjerë fushash të tjera të lidhura me menaxhimin financiar të llogarive të BE-së.

Së pari, Parlamenti Europian është, bashkë me Këshillin e Europës, Autoriteti Buxhetor për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe si i tillë, ai miraton çdo vit buxhetin, përfshirë edhe atë pjesë që lidhet me GJEA-n. Së dyti, me rekomandim të Këshillit, PE autorizon Komisionin Europian dhe për këtë qëllim Këshilli dhe PE shqyrtojnë raportin vjetor, deklaratën e besueshmërisë dhe raportet e posaçme të GJEA-s (Neni 276 i Traktatit të BE-së). GJEA në veçanti ndihmon Këshillin dhe PE-në në ushtrimin e kompetencës së tyre të kontrollit të zbatimit të buxhetit (Neni 248, paragrafi 4 i Traktatit të BE-së). Së treti, roli lidhet me miratimin e akteve ligjore mbi Rregullimin Financiar, me metodat dhe procedurat përmes të cilave të ardhurat e buxhetit i vihen në dispozicion Komisionit dhe me rregullat për përgjegjësinë e kontrollorëve financiarë që autorizojnë nëpunësit dhe ata të financës si edhe masat e përshtatshme për inspektimet (Neni 279 i Traktatit të BE-së). Për sa u përket këtyre akteve ligjore, PE duhet të konsultohet dhe GJEA duhet të shprehë mendimin e vet përpara se Këshilli t'i miratojë ato (shih edhe pikën 6). Së fundi, PE pyetet për emërimin e anëtarëve të GJEA-s, të cilët emërohen nga Këshilli.

Brenda Parlamentit Europian, dy komisione të përhershme parlamentare merren me kompetencat e lidhura me këto funksione. Këto janë Komisioni për Buxhetet (KB) dhe Komisioni i Kontrollit të Buxhetit (KKB). Komisioni kryesor që merret me raportet e GJEA-s është KKB-ë. Komisioni i buxhetit (KB) merret me çështjet buxhetore të GJEA-s. Detyrat që kanë të bëjnë me miratimin e akteve ligjore mbuloohen nga çdonjëri prej këtyre dy komisioneve. Po ashtu, të dy komisionet kanë edhe detyra të tjera përveç atyre që lidhen me GJEA-n. KKB-ë ka përgjegjësi për çështje që kanë lidhje me:

- (a) Kontrollin e masave zbatuese financiare, buxhetore dhe administrative në lidhje me buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian (përfshirë Fondin Europian për Zhvillim (FEZh)).
- (b) Kontrollin e veprimtarive financiare dhe administrative të ECSC dhe të veprimtarive financiare të Bankës Europiane për Investime (BEI), të kryera mbi bazën e udhëzimeve të Komisionit.
- (c) Masat financiare në lidhje me çështjet e zbatimit, menaxhimit dhe kontrollit të llogarive (Neni 279 i Traktatit të BE-së).
- (d) Vendimet e parlamentit për përfundimin e misionit të Komisionit dhe masat shoqëruese ose në zbatim të vendimeve të tilla (Neni 276 i Traktatit të BE-së).
- (e) Financat dhe dokumentet e kontabilitetit në lidhje me vendimet për mbylljen, prezantimin dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të parlamentit si edhe masat shoqëruese ose në zbatim të këtyre vendimeve, në veçanti si pjesë e procedurës së brendshme.
- (f) Mbylljen, prezantimin dhe auditimin e llogarive dhe të dokumenteve të bilancit të Komuniteteve Europiane, të institucioneve të tyre dhe të çdo organi të financuar prej tyre, përfshirë edhe krijimin e kreditit buxhetor dhe vendosjen e ekuilibrave.
- (g) Monitorimin që shoqëron zbatimin e buxheteve aktuale mbi bazën e raporteve periodike të dhëna nga Komisioni dhe masat e marra për një zbatim të tillë me komisionet e specialistëve ose në mënyrë alternative, pa cënuar kompetencat e komisioneve të specialistëve siç e parashikojnë Rregulloret.
- (h) Vlerësimin e efektivitetit të formave të ndryshme të financimit të Bashkimit Europian, koordinimit të instrumenteve të ndryshme financiare dhe vlerësimit të raportit kosto-përfitim në zbatimin e politikave të financuara nga Bashkimi Europian.

⁵ Raport i marrë në 26 qershor 2001 nga Gjykata Europiane e Auditorëve.

- (i) Marrjen në konsideratë të kushteve të kreditimit, të mekanizmave të financimit dhe të strukturave administrative të caktuara për t'i zbatuar ato duke shqyrtuar rastet e mashtrimit dhe të parregullsisve.
- (j) Përcaktimin e rregulloreve ose të pjesëve të tyre të cilat merren me ekzekutimin e buxheteve.
- (k) Organizimin e kontrolleve, parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit të mashtrimit dhe të parregullsisve që prekin buxhetin e Bashkimit Europian dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit në përgjithësi (Neni 280 i Traktatit të BE-së).
- (l) Marrjen në konsideratë të raporteve dhe të mendimeve të Gjykatës së Auditorëve (Neni 248 i Traktatit të BE-së).
- (m) Marrëdhëniet me Gjykatën e Auditorëve dhe emërimin e anëtarëve të saj pa dëmtuar kompetencat e Kryetarit të Parlamentit (Neni 247 i Traktatit të BE-së).

KB-ë është përgjegjës për çështje që kanë të bëjnë me:

- (a) Përkufizimin dhe ushtrimin e kompetencave buxhetore të Parlamentit (Neni 268 deri te neni 273 i Traktatit të BE-së) dhe me rregullat që merren me hartimin e buxhetit.
- (b) Buxhetet e Bashkimit Europian përfshirë edhe buxhetin e ECSC dhe buxhetimin e Fondit Europian të Zhvillimit.
- (c) Përlllogaritjet shumëvjeçare të të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkimit Europian dhe me marrëveshjet ndërinstitucionale të arritura për këto çështje dhe me zbatimin e marrëveshjes për buxhetin.
- (d) Burimet financiare të Bashkimit Europian.
- (e) Aktivitetet financiare të Bankës Europiane për Investime (BEI) dhe me instrumente të tjera financiare dhe buxhetore të Komuniteteve Europiane dhe të Shteteve Anëtare (Neni 248 dhe 267 i Traktatit të BE-së).
- (f) Pasojat financiare të ligjeve të Komunitetit pa cënuar kompetencat e komisioneve të specialistëve.
- (g) Probleme që lidhen me menaxhimin administrativ dhe kontabël dhe me stafin e Bashkimit Europian në atë masë që ato nuk kanë pasoja të rëndësishme për statusin ligjor të punonjësve.
- (h) Transferime të shumave me destinacion të përcaktuar.
- (i) Buxhetin, administratën dhe llogaritë e parlamentit (Rregulli 183).
- (j) Rregullimin financiar, me përjashtim të çështjeve që lidhen me zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e llogarive (Neni 279 i Traktatit të BE-së).

2. Përbërja dhe mënyra e veprimit të Komisioneve Parlamentare në lidhje me GJEA-n

Sipas Nenit 152 të Rregullave të Procedurës së Parlamentit Europian, përbërja e komisioneve pasqyron, sa më shumë të jetë e mundur, përbërjen e parlamentit. KKB-ë si komisioni përgjegjës për marrëdhëniet me GJEA-n dhe për marrjen në konsideratë të raporteve të Gjykatës, përbëhet nga 21 anëtarë dhe 21 anëtarë zëvendësues dhe KB-ë përbëhet nga 45 anëtarë dhe 43 anëtarë zëvendësues.

KKB-ë mbledhet rregullisht (një ose dy herë në muaj për një apo dy ditë) dhe anëtarët e stafit përfaqësojnë GJEA-n në të gjitha këto mbledhje. Në raste të veçanta, anëtarët e GJEA-s i paraqesin raportet e tyre në KKB-ë. Kryetari i GJEA-s e prezanton raportin vjetor të GJEA-s çdo vit para KKB-së në një seancë plenare të Parlamentit Europian.

Si edhe Komisioni i Kontrollit Buxhetor, Komisioni i Buxheteve mbledhet një ose dy herë në muaj për një apo dy ditë. GJEA zakonisht nuk përfaqësohet në këto mbledhje dhe ndjek vetëm prezantimin që i bëhet buxhetit të saj.

3. Roli i Komisionit Parlamentar në shqyrtimin e raportit të GJEA-s dhe të rezultateve të tjera

Sipas Nenit 276 të Traktatit Themelues të BE-së, Parlamenti Europian duhet të marrë në konsideratë raportet e Gjykatës Europiane të Auditorëve për t'i dhënë fund misionit të Komisionit Europian. Vendimi i Parlamentit

Europian për dhënie fund të misionit mund të përfshijë vëzhgime dhe rekomandime që bazohen në raportet e Gjykatës Europiane të Auditorëve.

4. Shkalla e pavarësisë e GJEA-s përkundrejt Komisioneve Parlamentare

Gjykata Europiane e Auditorëve është tërësisht e pavarur përballë të gjitha institucioneve të BE-së në lidhje me aktivitetet e veta audituese. Kjo përfshin përzgjedhjen e fushave të auditimit, metodologjinë e auditimit dhe raportimin e gjetjeve të auditimit. Komisionet parlamentare dhe në veçanti, KKB mund t'i kërkojë GJEA-s të kryejë hetime të posaçme, por është në dorë të GJEA-s të vendosë nëse do t'i pranojë këto propozime apo do të kenë përparësi fusha të tjera auditimi.

Parlamenti Europian është autoriteti kryesor buxhetor për miratimin dhe zbatimin e buxhetit të GJEA-s. Kjo do të thotë se ai miraton buxhetin dhe ushtron kontrollin politik mbi zbatimin e tij. Me miratimin e buxhetit vjetor të GEA-s, Parlamenti Europian miraton edhe numrin e punonjësve që do të punojnë në GJEA. Brenda kuadrit ligjor, GJEA është plotësisht e pavarur në përdorimin e buxhetit të vet (shih edhe pikën 6).

5. Roli i Komisionit Parlamentar në veprimtarinë e GJEA-s në fusha të tilla si:

- (a) Programi i auditimit i GJEA-s.
- (b) Kërkesa e komisionit parlamentar për auditime/hetime nga GJEA.
- (c) Tipi i ndihmës që GJEA ofron për komisionet parlamentare.
- (d) Ndikimi i komisionit parlamentar mbi metodologjinë e auditimit të GJEA-s.

Ndihma që GJEA u jep komisioneve parlamentare është kryesisht përmes raporteve të shkruara. Megjithatë, në rast se Komisioni i Kontrollit të Buxhetit ose ndonjë komision tjetër i specializuar ka pyetje të tjera për vëzhgimet dhe rekomandimet e bëra nga GJEA, GJEA jep detaje dhe shpjegime të mëtejshme.

6. Funksione të tjera të mundshme, të tilla si:

- (a) Funksionet e GJEA-s përkundrejt procesit të hartimit të ligjeve.
- (b) Miratimi i buxhetit vjetor të GJEA-s.
- (c) Vlerësimi i punës së GJEA-s nga Komisioni Parlamentar.
- (d) Auditimi i GJEA-s (dhe tipi i auditimit të kryer).
- (e) Emërimi ose shkarkimi i kryetarit të GJEA-s, miratimi i legjislacionit të GJEA-s, etj.

Sipas Nenit 279 të Traktatit të BE-së, GJEA duhet të shprehë mendimin e vet përpara se Këshilli të miratojë Rregulloren Financiare, procedurat për të vënë në dispozicion të Komisionit burimet e veta të Komunitetit, masat për t'iu përmbajtur kërkesave për para në dorë si edhe rregullat në lidhje me përgjegjësinë e kontrollorëve financiarë, të nëpunësve autorizues dhe të ekspertëve kontabël si edhe masat për inspektimin (shih më sipër, pikën 1).

Vlerësimi për buxhetin vjetor të GJEA-s propozohet nga GJEA në Komisionin Europian, i cili nga ana e vet bashkon propozimet nga të gjitha institucionet dhe ka të drejtën zyrtare të bashkëngjijës edhe mendimin e vet. Komisioni e çon këtë si projektbuxhet paraprak para Këshillit, i cili mund të ketë qëndrime të tjera nga ato të projektbuxhetit, por vetëm pas konsultimesh me Komisionin dhe, kur e quan të arsyeshme edhe me institucione të tjera si GJEA. Pasi Këshilli e harton projektbuxhetin, ai i dërgohet Parlamentit Europian. Këto dy institucione, Këshilli dhe Parlamenti Europian, kanë të drejtë të ndryshojnë atë pjesë të projektbuxhetit që ka lidhje me GJEA-n. Megjithatë, votimi përfundimtar për këtë pjesë të buxhetit bëhet nga Parlamenti Europian. Me qëllim që të përgatisë votën e parlamentit, Komisioni i Buxhetit dhe në veçanti, raportuesit e tij e diskutojnë me vetë GJEA-n pjesën që lidhet me shpenzimet e saj.

GJEA e zbaton pjesën e saj të buxhetit me përgjegjësinë e vet (Neni 274 i Traktatit të BE-së dhe Neni 22 i FR), megjithëse, formalisht Komisioni mbetet plotësisht përgjegjës për përdorimin e të gjithë buxhetit. Sipas Traktatit të BE-së, GJEA është një të njëjtën kohë edhe audituesi i jashtëm i shpenzimeve të veta. Me qëllim që të zgjidhet konflikti i mundshëm i interesave, GJEA ka kontraktuar një firmë private auditimi që të auditojë financat e saj. Raporti i auditimit publikohet çdo vit në Fletoren Zyrtare të BE-së.

Për emërimin e anëtarëve të GJEA-s, pasi kandidatët propozohen nga Shtetet Anëtare, merret mendimi i Parlamentit European. Parlamenti shqyrton të gjitha kandidaturat përpara se rezoluta të kalojë për në Këshill. Këshilli është ai që emëron përfundimisht anëtarët e GJEA-s.

ANEKSI 3: MARRËDHËNIET MIDIS KOMISIONEVE PARLAMENTARE DHE ZYRËS SË AUDITUESIT TË PRGJITHSHËM NË KANADA⁶

1. Roli dhe objektivat e përgjithshëm të parlamentit dhe të komisioneve parlamentare në lidhje me IKLSH-në

- Komisioni i Llogarive Publike i Dhomës së Komuneve ka mandatin të shqyrtojë raportet e Audituesit të Përgjithshëm si edhe të buxhetit të Zyrës.
- Komisioni Kombëtar i Financave i Senatit ka gjithashtu mandatin të shqyrtojë raportet e Audituesit të Përgjithshëm.
- Kontaktet më të shumta kryhen me komisionet e Dhomës së Komuneve, dhe pjesa më e madhe e atij kontakti është me Komisionin e Llogarive Publike (KLLP). Çdo vit, KLLP-ë takohet afërsisht 20-25 herë me Audituesin e Përgjithshëm dhe stafin e tij/saj. Dy prej këtyre seancave dëgjimore bëhen për të diskutuar “Planet dhe Përparësitë” dhe “Raportin e Performancës”.
- Të gjitha komisionet e përhershme të Dhomës së Komuneve pajisen me informacion përmbledhës për secilin nga kapitujt që janë brenda fushës së veprimit të komisionit menjëherë pasi raportet e IKLSH-së bëhen publike. Shumë nga këto komisione ftojnë përfaqësues të IKLSH-së t’u përgjigjen pyetjeve për kapitujt. Ka raste kur Audituesi i Përgjithshëm del para komisioneve të përhershme dhe jo para KLLP-së dhe, kur ndodh kjo, është prezent edhe departamenti i prekur direkt në atë kapitull për të dhënë edhe ai dëshminë e tij.

2. Përbërja dhe mënyra e veprimit e Komisioneve Parlamentare përkundrejt IKLSH-së (a ekzistojnë zakone, parime, rregulla ose norma për të garantuar dhe ruajtur karakterin apolitik të aktiviteteve të komisioneve parlamentare përkundrejt IKLSH-së?)

Sipas marrëveshjes dhe rregullave të Dhomës, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm (ZAP) ka një marrëdhënie të veçantë me Komisionin e Përhershëm të Llogarive Publike (KLLP). KLLP-ë është një nga 16 komisionet e përhershme të Dhomës së Komuneve. Urdhrat e Përhershëm të Dhomës parashikojnë referimin automatik dhe të vazhdueshëm në KLLP-ë të raporteve të Audituesit të Përgjithshëm dhe të Llogarive Publike të Kanadasë sapo ato paraqiten në Dhomën e Komuneve. Ajo që Komisioni bën me këto dokumente dhe nëse dërgon ai ndonjë raport në Dhomë, këto janë në dorë të tij. Kompetencat kryesore të KLLP-së janë të njëjta me ato të Komisioneve të tjera të Dhomës: të thërrasë dëshmitarë, të kërkojë dokumente dhe të raportojë para Dhomës.

Aktualisht, në KLLP-ë janë 17 anëtarë. Që në vitin 1958, komisioni është kryesuar nga një anëtar i parlamentit përfaqësues i opozitës zyrtare dhe nga dy nënkryetarë të cilët janë të palës në qeverisje. Komisioni vepron në përgjithësi me një mënyrë jopartiake duke u përqendruar në administratën publike dhe në zbatimin e politikave dhe jo në meritat e politikave të qeverisë. Audituesi i Përgjithshëm bashkëvepron edhe ai në një mënyrë jopartiake me të gjithë anëtarët e komisionit. Po ashtu, komisioni thërret si vëzhgues zëvendësministrin e një ministrie më shumë sesa ministrin. Audituesi i Përgjithshëm paraqitet si vëzhgues në të njëjtën kohë me vëzhguesin e ministrisë në shumicën e seancave dëgjimore.

Vitet e fundit, komisioni ka prodhuar 10-15 raporte për Dhomën në vit. Këto raporte janë të pavarur në natyrë dhe përmbajnë rekomandime për ministrinë specifike të përfshirë në seancat dëgjimore, për qeverinë dhe Audituesin e Përgjithshëm.

3. Roli i Komisionit Parlamentar në analizën e raporteve të IKLSH-së dhe të rezultateve të tjera

Megjithëse raportet e Audituesit të Përgjithshëm tërheqin shumë vëmendjen e medias kur publikohen, ndikimi i tyre afatgjatë ndjehet kur ato shqyrtohen nga KLLP-ë. Komisioni analizon nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet e miratuara dhe nëse shpenzimi i kryer ka qenë eficient, ekonomik dhe efektiv. Ai e

⁶ Raport i marrë në 27 prill 2001 nga Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kanadasë.

mbështet pjesën më të madhe të punës së vet në raportet e Audituesit të Përgjithshëm. Përgjatë të gjithë vitit, komisioni organizon seanca dëgjimore për të analizuar gjetjet e auditimit. Pas këtyre seancave, komisioni paraqet një raport në Dhomën e Komuneve me rekomandime për qeverinë ose sektorin. Ministrinë kanë 150 ditë në dispozicion për të raportuar mbrapsht te komisioni mbi ato që kanë bërë si reagim ndaj rekomandimeve. Ministrat japin përgjigje në emër të qeverisë. Përmes këtij procesi, KLLP-ë garanton plotësimin e ciklit të llogaridhënies.

Në ato raste kur një kapitull nuk është bërë objekt i seancës dëgjimore, KLLP-ë mund të vijojë më tej me ministrinë duke i kërkuar asaj të japë një raport me shkrim për gjendjen ose të planifikojë të korrigojë dobësitë e zbuluara nga Audituesi i Përgjithshëm. Si rregull, ky proces pasues bëhet një herë në vit.

Siç u përmend edhe më parë, komisione të tjera të përhershme të Dhomës ose të Senatit organizojnë gjithashtu seanca dëgjimore për kapitujt e raportit. Audituesi i Përgjithshëm ndjek 15-20 seanca të tilla në vit.

Përveç kësaj, KLLP-ë analizon edhe dokumente për buxhetin të Audituesit të Përgjithshëm (shih pjesën 6).

4. Shkalla e pavarësisë së IKLSH-së përkundrejt Komisioneve Parlamentare

Interesi parlamentar për çdo çështje zakonisht shfaqet gjatë planifikimit të tematikës që do të auditohet. Komisionet parlamentare ftohen të këshillojnë IKLSH-në për interesat dhe shqetësimet e tyre gjatë seancave dëgjimore dhe mbledhjeve jozyrtare. Zyra i merr me seriozitet rekomandimet e komisionit për të kryer një auditim për një çështje të caktuar. Megjithatë, në fund, IKLSH-ë ka mandatin të zgjedhë në mënyrë të pavarur çështjet për analizë.

5. Roli i Komisionit Parlamentar në veprimet e IKLSH-së në fusha të tilla si:

- **Programi i auditimit i IKLSH-së:** Planifikimi fillon duke marrë në konsideratë çështje të gjera dhe përparësi, nevoja dhe pritshmëri të përgjithshme të parlamentit dhe të aktorëve të tjerë kryesorë, si edhe burimet e alokuara. Kontributet e jashtme në këtë proces vijnë nga konsultimet jozyrtare me anëtarët e parlamentit, me zëvendësministrat dhe me këshilltarë të jashtëm.
- **Kërkesa e Komisionit Parlamentar për auditime/hetime nga IKLSH-ë:** Kërkesat e komisioneve merren në shqyrtim dhe çështja auditohet nëse kjo vlerësohet e përshtatshme nga zyra. Për shembull, zyra po auditon grantet dhe kontributet në një shkallë të gjerë në nivel qeverie si rezultat i një kërkesë nga Komisioni i Llogarive Publike. Zyra ka kryer edhe një auditim më të detajuar të menaxhimit të granteve dhe të kontributeve në Zhvillimin e Burimeve Njerëzore të Kanadasë duke marrë në konsideratë interesat e Komisionit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore. Rezultatet e auditimit mbarëqeveritar do të publikohen në fund të këtij viti. Pavarësisht nga dëshira e zyrës për t'u shërbyer deputetëve dhe për të qenë reaguese ndaj kërkesave të komisioneve, vendimi për kryerjen e këtyre auditimeve është tërësisht në duart e Audituesit të Përgjithshëm dhe pavarësia e tij është e garantuar.
- Tipi i ndihmës që IKLSH-ë u ofron komisioneve parlamentare.
- Dëshmi në seancat dëgjimore, takimet me stafin kërkimor të komisionit për të diskutuar raportet para seancave dëgjimore (stafi kërkimor përgatit shënime informative për anëtarët e komisionit mbështetur në këtë diskutim).
- Ndikimi i komisionit parlamentar mbi metodologjinë e auditimit të IKLSH-së.

6. Funksione të tjera të mundshme, të tilla si:

- **Funksionet e IKLSH-së në lidhje me procesin e hartimit të ligjeve:** Zyra e IKLSH-së përgjithësisht nuk përfshihet në ndonjë aspekt të procesit të hartimit të ligjeve, përveç atyre rasteve kur i kërkohet posaçërisht të komentojë për ndonjë projektligj të studiuar në parlament. Në këto raste, IKLSH-ë zakonisht do të shprehet për projektligjin vetëm nëse projektligji ka ndonjë efekt mbi mandatin e tij. Megjithatë, zyrtarët e qeverisë inkurajohen të analizojnë projektpropozimet për të ndryshuar legjislacionin bazë si për shembull, Ligjin për Administratën Financiare.
- **Miratimi i buxhetit vjetor të IKLSH-së:** KLLP-ë mban një seancë dëgjimore për të diskutuar buxhetin e zyrës (seanca dëgjimore mbi "Planet dhe Përparësitë". Komisioni nxjerr një raport duke u mbështetur në atë seancë dëgjimore (paraqitet një kopje e procesverbalit). KLLP-ë nuk ka

rekomanduar kurrë ndonjë ndryshim në buxhetin e Zyrës. Urdhrat e Përhershëm të Dhomës së Komuneve i kufizojnë në këto drejtimeve kompetencat e komisioneve të përhershme kur analizojnë buxhetet: i miratojnë siç janë prezantuar, i pakësojnë ose i rrëzojnë. Pakësimi i një buxheti do të shihej si një mungesë besimi tek qeveria, gjë që mund të çojë në rënien e qeverisë.

- **Vlerësimi i punës së IKLSH-së nga KFP-ë:** Realizimet e përgjithshme të zyrës vlerësohen nga KLLP-ë gjatë seanceve dëgjimore për Raportin vjetor të Performancës (pjesë e procesit të vlerësimeve). KLLP-ë nxjerr një raport me rekomandime të posaçme në lidhje me përmirësimin e informacionit që IKLSH-ë ofron për punën e vet dhe efektin e tij. Tërthorazi, komisioni gjithashtu e vlerëson punën sa herë që përfaqësuesit e IKLSH-së janë para tyre si dëshmitarë. Në këto raste atyre u bëhen pyetje për punën e tyre audituese.
- **Auditimi i IKLSH-së (dhe tipi i auditimit):** Çdo vit kryhet një auditim financiar i jashtëm i zyrës. Zyra kohët e fundit po analizohet nga një zyrë homologe për praktikën e saj të auditimit financiar. Një vlerësim i ngjashëm për auditimet “vlera e parasë” po planifikohet aktualisht.
- **Emërimi ose shkarkimi i Kryetarit të IKLSH-së, miratimi i legjislacionit për IKLSH-në:** Bordi i Thesarit është i mandatuar për t'i dhënë një rekomandim kabinetit qeveritar për përzgjedhjen e Audituesit të Përgjithshëm. Deputetët nuk përfshihen sistematikisht në procesin e përzgjedhjes. Megjithatë, vendimi për të hequr Audituesin e Përgjithshëm do të kërkonte miratimin e Senatit dhe të Dhomës së Komuneve. Sipas legjislacionit të IKLSH-së, të dyja Dhomat duhet të bien dakord me çdo lloj ndryshimi. Audituesi i Përgjithshëm emërohet për një mandat 10 vjeçar.

7. Perceptimi i pikave të forta dhe i mundësive të sistemit aktual

Praktika e vendosur tashmë nga Komisioni i Llogarive Publike për organizimin e një seance dëgjimore me përfaqësues nga zyra dhe ministrinë për secilin kapitull përbën një nga tiparet më të mira të sistemit. Kjo praktikë u jep shumë vlerë rekomandimeve të IKLSH-së, meqë KLLP-ë në përgjithësi i miraton ato përmes një raporti të cilin Kryetari e paraqet në Dhomën e Komuneve. Raportet e KLLP-së kërkojnë një përgjigje zyrtare nga qeveria brenda 150 ditësh.

Siç u vu në dukje më sipër, edhe nëse një kapitull nuk bëhet objekt trajtimi në një seancë dëgjimore, KLLP-ë ka mundësinë të kërkojë një plan veprimi si reagim ndaj rekomandimeve të IKLSH-së.

8. Praktika të tjera të dobishme të vendosura nga Zyra për të shtuar marrëdhëniet me parlamentin:

Paraqitja e procedurave ditore: Në ditën që një raport i paraqitet parlamentit, deputetëve dhe stafit kërkimor iu jepet mundësia ta shohin paraprakisht raportin, përpara se ai të paraqitet zyrtarisht. Ky veprim konfidencial njohjeje me raportin “mirëpritet” nga Kryetari i KLLP-së dhe nga Zyra. Në ditën e seancës, KLLP-së i jepet një letër ku propozohen tematikat kryesore për seancën dëgjimore. Kjo do të shërbejë për të hartuar planin e seancës dëgjimore. Dy ditë pas paraqitjes së raportit, KFP kryen një seancë dëgjimore për raportin e paraqitur dhe mbi përparësitë e sugjeruara nga Audituesi i Përgjithshëm.

Letra për komisionet: Pas paraqitjes së raportit në parlament, komisioneve parlamentare të veçanta u dërgohen letra për t'i këshilluar ato mbi kapitujt e raportit që mund të jenë në kompetencë të tyre. Jepet edhe një përshkrim i shkurtër i çështjeve kryesore. Parashikohet që këto letra çojnë në seanca dëgjimore.

Letra kalimtare: Pas zgjedhjeve, përgatiten letra kalimtare për të gjithë komisionet e përhershme të Dhomës së Komuneve për t'i informuar ata për punën e kryer në ministrinë që janë kompetencë e tyre. Këto letra theksojnë çështjet që mbeten të pazgjidhura nga qeveria e mëparshme. Audituesi i Përgjithshëm gjithashtu mund t'u shkruajë komisioneve të zgjedhura të Senatit.

Takime me deputetë: Audituesi i Përgjithshëm përpaket të organizojë takime me grupe të vogla deputetësh të partive të ndryshme menjëherë pas zgjedhjeve për të folur për rolin dhe mandatin e Zyrës. Audituesi i Përgjithshëm takohet edhe me grupe të vogla deputetësh rregullisht për të diskutuar për tema me interes të përbashkët.

Letra nga deputetët: Përveç kësaj, Zyra do i përgjigjet një numri letrash nga deputetët. Këto mund të kenë të bëjnë me lloj lloj temash, përfshirë edhe kërkime për punën në të shkuarën ose aktuale të zyrës dhe me

kërkesa që të auditohen disa çështje. Këto letra duhet të merren në konsideratë nga grupet individuale të auditimit kur ato planifikojnë punën do bëjnë.

Takime me komisionet: Të gjithë Ndhmësit e Audituesit të Përgjithshëm nxiten të takohen shoqërisht me anëtarët e komisioneve të përhershme që koincidojnë me përgjegjësitë e tyre të auditimit. Takimet me anëtarë të komisioneve ndihmojnë Zyrën të kuptojë interesat dhe shqetësimet e tyre.


Takime me studiuesit/kërkuesit: Përpara seancave dëgjimore me Komisionin e Llogarive Publike, stafi kërkimor i Komisionit takohet me ekipet audituese përgjegjëse për kapitullin që është objekt i seancës dëgjimore. Ky proces ndihmon që stafi kërkimor të kuptojë më mirë lëndën dhe të përgatisë më mirë anëtarët e Komisionit për seancën aktuale dëgjimore.

ANEKSI 4: MARRËDHËNIET E IKLSH-së DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË DANIMARKË⁷

1. Roli dhe objektivat e përgjithshëm të Parlamentit dhe të Komisioneve Parlamentare në lidhje me auditimin shtetëror

Në vitin 1849 u hartua Kushtetuta e Danimarkës dhe menjëherë pas saj në vitin 1851 u ngrit në Danimarkë Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike (KLLP). Zyra e Auditimit të Shtetit e Danimarkës (ZASHD) nga ana organizative është e vendosur nën Parlamentin si një institucion i pavarur.

Skema vijuese ilustron marrëdhëniet midis Parlamentit (Folketing) dhe komisioneve parlamentare, KLLP-së, dhe ZASHD-it.



Kompetencat dhe funksionet e KLLP-së u përcaktuan në formën që kanë aktualisht në Ligjin për Komisionin e Llogarive Publike të vitit 1976. Sipas ligjit, KLLP-ë mund të kërkojë që ZASHD-i të shqyrtojë disa fusha të interesit, me fjalë të tjera KLLP mund të kërkojë që të kryhet një shqyrtim i caktuar. Pasi një raport përfundon, ai i dërgohet KLLP-ë, i cili nga ana e tij e mbështet punën e vet në raportet e ZASH-it të Danimarkës.

Audituesi i Përgjithshëm ndihmon KLLP-në me analizën e bilancit të shtetit. Duke bërë kështu, garantohej që të ardhurat e shtetit janë përfshirë në bilanc dhe nuk paguhet asnjë shpenzim pa u mbështetur në Ligjin për Financat apo bazë tjetër ligjore. Po ashtu, KLLP-ë garanton që fondet administrohen drejt dhe që janë marrë vendime për financa të shëndosha.

Parlamenti zgjedh gjashtë anëtarë në bazë të përfaqësimit proporcional. Kjo bën që çdo parti e madhe të përfaqësohet në KLLP-ë. Kryetari i KLLP-së është anëtari që ka kohën më të gjatë në shërbim. Anëtarët paguhet dhe nuk është nevoja që të jenë deputetë. Mandati i KLLP-së është për katër vjet dhe ky mandat nuk preket nga zgjedhjet e përgjithshme. KLLP-ë nuk është një komision parlamentar dhe për këtë arsye bilancin financiar e paraqet zyrtarisht Komisioni i Financave.

⁷ Raport i marrë në 7 maj 2001 nga Zyra e Auditimit të Shtetit në Danimarkë.

2. Marrëdhëniet midis KLLP-së dhe ZASHD-it

ZASHD-i është një organizatë e pavarur që kryen auditime në emër të Parlamentit.

Sipas ligjit mbi bilancin e shtetit, etj., (Ligji për Audituesin e Përgjithshëm), i cili u miratua në 1 janar 1976, auditimi i llogarive të shtetit duhet të kryhet nga një Auditues i Përgjithshëm i pavarur që është një organizatë me një njësi.


Pas amendimit të Ligjit për Audituesin e Përgjithshëm në vitin 1991, ZASHD-i u vendos organizativisht nën autoritetin e parlamentit, dhe që atëherë, Audituesi i Përgjithshëm emërohet nga Kryetari i Parlamentit me rekomandim të KLLP-së.

Në vitin 1996, Ligji për Audituesin e Përgjithshëm u amendua përsëri, gjë që midis të tjerash bëri që ZASHD-i të fitonte akses të drejtpërdrejtë në bilancin dhe në lloje të tjera të informacionit të kompanive. Për më tepër, Audituesi i Përgjithshëm u tërhoq si një auditues në kompanitë me përgjegjësi plotësisht të kufizuara.

Përveç Ligjit për Audituesin e Përgjithshëm, Audituesi i përgjithshëm vepron edhe në përputhje me *Shënimin Udhëzues për marrëdhëniet e Audituesit të Përgjithshëm me Administratën Publike dhe me Administratën në përgjithësi*.

3. Roli i KLLP-së në analizën e raporteve të ZASHD-it dhe të rezultateve të tjera

KLLP-ë i shqyrton raportet e Audituesit të Përgjithshëm dhe pastaj Komisioni komenton për to. Prej këtej raportet dërgohen në parlament dhe tek ministri përkatës. Ministrat duhet të përgjigjen ndaj raporteve brenda katër muajve, duke përshkruar edhe veprimet që mendojnë të ndërmerren. Ministrat janë të detyruar të përgjigjen pasi Ligji për Përgjegjësinë Ministrore i bën ata përgjegjës edhe politikisht edhe administrativisht për fushën e kompetencave së tyre.



Skema e mësipërme tregon marrëdhëniet midis ZASHD-it, KLLP-së, ministrive dhe parlamentit. Shigjetat e kuqe që dalin nga ministrinë tregojnë proces konfliktual.

Me të marrë përgjigjen e ministrit për një raport, Audituesi i Përgjithshëm ka një muaj kohë ta shqyrtojë përgjigjen dhe të raportojë pikëpamjet e tij tek KLLP-ë në një memorandum. Përgjigjet e ministrave dhe pikëpamjet e Audituesit të Përgjithshëm riprodhohen në raportin përfundimtar të KLLP-së mbi bilancin

shtetëror. Sipas Kushtetutës, raporti përfundimtar mbi bilancin e shtetit përbën bazën e miratimit të bilancit shtetëror nga parlamenti.

4. Pavarësia e ZASHD-it

Sipas Ligjit për Audituesin e Përgjithshëm, Audituesi i Përgjithshëm është i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Me fjalë të tjera, Audituesi i Përgjithshëm vendos vetë si t'i organizojë dhe t'i kryejë analizat e tij, si edhe nëse nevojiten analiza të tilla shtesë. KLLP-ë është i vetmi organ që mund të kërkojë të kryhet një shqyrtim.

5. Roli i KLLP-së në programin e auditimit të ZASHD-it, në kërkesat për auditime, në metodologji

Për shkak se Audituesi i Përgjithshëm është i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij/saj, KLLP-ë nuk merr pjesë në planifikimin e programit të auditimit të ZASHD-it dhe as në diskutimin e metodologjisë së zgjedhur. Megjithatë, Audituesi i Përgjithshëm e përfshin në programin e vet të auditimit edhe kërkesën e KLLP-së për analizë të auditimeve.

6. Funksione të tjera

KLLP-ë bën propozimin për emërimin dhe shkarkimin e Audituesit të Përgjithshëm tek Kryetari i Parlamentit, i cili, pas diskutimesh me nënkryetarët, e paraqet propozimin tek Komisioni i Urdhrit të Përhershëm. Nëse propozimi nuk mund të miratohet, Kryetari duhet të njoftojë KLLP-në, e cila pas kësaj bën një propozim të ri. KLLP-ë mund që në këtë rast të kërkojë që posti të shpallet edhe një herë publikisht.

KLLP-ë zakonisht mblidhet një herë në muaj dhe vlerëson me kujdes raportet e auditimit. Audituesi i Përgjithshëm merr pjesë në takime, në të cilat diskutohen me hollësi raportet më të fundit e auditimit dhe merren në konsideratë ide të reja për raporte auditimi.

Që prej kalimit të Ligjit të vitit 1991, buxheti i ZASHD-it i paraqitet KLLP-së nga Audituesi i Përgjithshëm. KLLP-ë e diskuton atë, bën komente për rekomandimet dhe ia dërgon Kryetarit të Parlamentit i cili sigurohet që ai të shqyrtohet bashkë me buxhetin e vetë parlamentit. Buxheti i ZASHD-it është pjesë e buxhetit të parlamentit.

Auditimi i ZASHD-it kryhet nga Grothen and Perregaard, një kompani kontabiliteti e çertifikuar, në përputhje me Ligjin e Audituesit të Përgjithshëm dhe Urdhrat e Përhershëm të Parlamentit. Auditimi kryhet në përputhje me parimet e përshkruara në *Praktikën e Mirë të Auditimit Publik*, dhe përfshin auditimin financiar si edhe auditimin e performancës.

Sipas Ligjit të Audituesit të Përgjithshëm, Audituesi i Përgjithshëm ndihmon ministrat në organizimin e kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm. Për këtë arsye, ministratë i dërgojnë ZASHD-it të gjitha projektligjet përkatëse për shqyrtim.

ANEKSI 5: MARRËDHËNIET MIDIS IKLSH-së DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË IRLANDËS

Roli dhe objektivat e përgjithshëm të Parlamentit dhe të Komisioneve Parlamentare në lidhje me Institucionin e Kontrollit të Lartë (IKLSH)

Irlanda ka një kushtetutë të shkruar e cila parashikon dy dhoma në parlament, Dhomën e Përfaqësuesve që quhet Dáil Éireann dhe Senatin që quhet Seanad Éireann. Kushtetuta parashikon edhe praninë e një Institucioni të Kontrollit të Lartë që quhet Kontrolluesi dhe Audituesi i Përgjithshëm (K&AP).

Marrëdhënia e K&AP-së me parlamentin është kryesisht një marrëdhënie raportimi e cila ushtrohet përmes raporteve vjetore dhe periodike të parashikuara nga ligji. Këto raporte përbëjnë bazën për shqyrtimin nga parlamenti të të ardhurave dhe të shpenzimeve të shtetit. Parlamenti e ndërmerret një shqyrtim të tillë përmes një komisioni të përhershëm të Dhomës së Përfaqësuesve që njihet si Komisioni i Llogarive Publike (KLLP). Detyrat dhe kompetencat e këtij komisioni janë përcaktuar në Urdhrat e Përhershëm. KLLP-ë ka funksionuar që prej themelimit të shtetit në vitin 1922 dhe edhe Zyra e K&AP-së janë modeluar sipas ekuivalenteve të tyre në Mbretërinë e Bashkuar, gjë që daton që në kohën e reformave administrative dhe parlamentare të mesit të viteve 1800 në Mbretërinë e Bashkuar.

Përbërja dhe mënyra e veprimit e Komisioneve Parlamentare në lidhje me IKLSH-në

Urdhrat e Përhershëm parashikojnë që KLLP-ë përbëhet nga 12 anëtarë, asnjëri prej të cilëve është anëtar i qeverisë ose ministër i shtetit dhe katër prej të cilëve përbëjnë kuorumin. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të paanshëm të Dáil. Sipas traditës, komisioni cakton si kryetar një anëtar të partisë kryesore të opozitës. Komisionit i ndalohet të hetojë për meritat e politikave ose për objektivat e politikave.

3. Roli i Komisionit Parlamentar në analizën e raporteve të IKLSH-së dhe të rezultateve të tjera

Raportet e K&AP-së për lehtësi mund të ndahen në një numër kategorish. Së pari, ekzistojnë raporte që kërkohen të hartohen në intervale të rregullta, zakonisht çdo vit, dhe që prezantohen drejtpërdrejt në Dhomën e Përfaqësuesve (Dáil Éireann) nga K&AP. Më i rëndësishmi ndër këto raporte është raporti vjetor i auditimit të llogarive të ministrave të shtetit dhe të llogarive të faturave të të ardhurave të shtetit. Ky raport kërkohet nga ligji që të paraqitet jo më vonë se 30 shtatori i vitit pasues për auditimet e vitit pararendës. Ky raport shqyrtohet nga KLLP-ë në mbledhjet e komisionit që janë zakonisht javore dhe përbën bazën e shqyrtimit të shefave të departamenteve qeveritare për punën e tyre. Kategoria e dytë e raporteve është e ngjashme me të parën në kuptimin që raportet kërkohen nga ligji të prodhohen çdo vit, por zakonisht këto u dorëzohen ministrave për t'i paraqitur në secilën prej dhomave të parlamentit. Pastaj KLLP-ë në kohën e përshtatshme i shqyrton përmbajtjen e këtyre raporteve të K&AP dhe të personelit përkatës. Raporte të tilla kanë lidhje për shembull, me shpenzimet e Bordeve Rajonale të Shëndetit dhe me një gamë të gjerë agjencish shtetërore jofitimprurëse.

Kategoria e tretë e raporteve të prodhuara nga K&AP përfshin detyrimin e pakufizuar të Zyrës. Karakteristika kryesore e këtij grupi raportesh është liria e parashikuar me ligj për K&AP që të zgjedhë tematikat për ekzaminim. Komploti më i rëndësishëm i raporteve të kësaj kategorie përbëhet nga raportet që lidhen me vlerën e parasë (value for money (VFM)). Zyrtarisht kjo është një detyrë relativisht e re që daton që prej vitit 1993 kur legjislacioni që rregullonte veprimtarinë e K&AP u rishikua ndjeshëm për herë të parë në mbi 100 vjet. Megjithatë, për shumë vite me radhë përpara vitit 1993, raportet vjetore të K&AP-së janë prirur të tërheqin vëmendjen vetëm për rastet e humbjeve, të dëmtimeve, të shpenzimeve të tepruara, me fjalë të tjera, për disa aspekte të konceptit vlera e parasë. Mandati për vlerën e parasë, siç u përcaktua zyrtarisht në legjislacionin e vitit 1993, ka të bëjë me masën në të cilën burimet publike janë përdorur me ekonomi dhe në mënyrë efëçente dhe nëse agjencitë publike kanë sisteme në fuqi për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve të tyre. Raportet sipas këtij mandati përgatiten për ministrat, të cilët janë të detyruar me ligj t'i paraqesin ato në

⁸ Raport i marrë në 26 prill 2001 nga Zyra e Kontrolluesit dhe Audituesit të Përgjithshëm të Irlandës.

Dhomën e Përfaqësuesve (Dáil Éireann). Kjo çon në shqyrtimin e tyre të mëtejshëm nga KLLP-ë. Deri më sot janë prezantuar për t'u shqyrtuar nga KLLP-ë rreth 38 raporte të tilla.

Kategoria e katërt janë raportet e posaçme. Këto, siç e tregon edhe vetë fjala, synojnë të lejojnë K&AP-ë të raportojë për çështje që dalin nga auditimet, nga shqyrtimet ose inspektimet e tyre që mund të kalojnë edhe pa u raportuar në parlament, duke garantuar kështu një përgjegjshmëri më të madhe publike për përdorimin e drejtë të burimeve publike. Raporte të tilla në radhë të parë u jepen ministrave, pastaj dërgohen në parlament dhe në fund shqyrtohen nga KLLP-ë.

4. Shkalla e pavarësisë e IKLSH-së nga Komisionet Parlamentare

Pavarësia e K&AP-së buron drejtpërdrejt nga pozita e tij/saj si një autoritet kushtetues. Historikisht K&AP ka pasur lidhje të forta me KLLP-në dhe është dëshmitar i përhershëm në të gjitha takimet e tij. Ka qenë KLLP-ë ai që ka bërë presion për zhvillimin e rolit të K&AP-së në vitet 1980. K&AP-ë nuk raporton përmes ndonjë Komisioni tjetër Parlamentar. Në mesin e viteve 1980, u mendua nëse ai mund të kishte marrëdhënie raportimi me komisionet e tjera parlamentare. Megjithatë, ide të tilla nuk gjetën mbështetje dhe një Letër e Bardhë e vitit 1992 mbi rolin e K&AP-së vinte në dukje se qeveria duke rivlerësuar termat e referencës për KLLP-në, kishte qëndrim pozitiv ndaj nevojës për të siguruar që KLLP-ë të vazhdonte të ishte i vetmi komision parlamentar përmes të cilit K&AP t'i raportonte Dhomë s së Përfaqësuesve (Dáil Éireann).

Ndërsa ekzistojnë marrëdhënie të ngushta pune midis KLLP-së dhe K&AP-së, nuk ka dyshim se të dy janë krejt të pavarur, si nga ana ligjore ashtu edhe në praktikë. Kjo pranohet qartë nga të gjithë.

5. Roli i Komisionit Parlamentar në veprimtarinë e IKLSH-së

Duke u marrë me çështjet e ngritura këtu, ia vlen të përmendim se legjislacioni i vitit 1993 parashikon se K&AP-ë auditon disa llogari dhe mund të kryejë edhe auditime që ai i konsideron të përshtatshme për të verifikuar nëse burimet janë përdorur me ekonomi dhe në mënyrë efiçente (mandati "vlera e parasë" (VFM)). Kështu ligji parashikon elementë të detyrueshëm dhe kompetenca (lirinë për të vendosur për disa gjëra) në punën e K&AP-së. Programi i auditimit planifikohet të garantojë që auditimet të kryhen në përputhje me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe brenda kufizimeve të lidhura me stafin dhe buxhetin të cilat Zyra i ka në dispozicion.

Për sa i përket kërkesave të KLLP-së për auditime/hetime, duhet thënë se Ligji i vitit 1993 shprehet specifikisht në lidhje me shqyrtimet e tipit VFM-së, nëse K&AP-ë propozon të bëjë ndonjë shqyrtim mbështetur në këtë pjesë të mandatit të vet, ai ka hapësirë të kërkojë të dijë se cilat janë pikëpamjet e KLLP-së

Duhet të vihet në dukje gjithashtu se Urdhrat e Përhershëm parashikojnë që KLLP-ë ka hapësirë, pa cenuar pavarësinë e K&AP, të përcaktojë punën që duhet të kryhet nga ai, ose mënyrën e kryerjes së saj, përmes komunikimit privat, t'i bëjë sugjerime të tilla K&AP-së në lidhje me punën siç e sheh ai të arsyeshme. K&AP-ë ka liri të plotë të pranojë ose të refuzojë çdo lloj sugjerimi. Kështu, marrëdhënia plotësuese e K&AP-së dhe e KLLP-së është pranuar pa cenuar pavarësinë e secilës palë.

K&AP-ë ose në mungesë të tij, një anëtar i lartë i stafit të tij ndjek takimet e KLLP-së si një dëshmitar i përhershëm. Zyra ndihmon K&AP-në duke i dhënë KLLP-së prezantime me gojë e me shkrim për raportet e tij për të lehtësuar KLLP-në në kryerjen e funksioneve të tij. KLLP ka sekretariatit dhe stafin e vet mbështetës. Një anëtar i stafit nga Zyra e K&AP-së ndihmon Kryetarin e KLLP-së duke mbajtur lidhjet dhe kontaktet me të tjerët.

KLLP-ë nuk ka ndikim në metodologjinë e auditimit që përdor Zyra.

6. Funksione të tjera të mundshme

K&AP-ë nuk ka ndonjë funksion të posaçëm në lidhje me procesin e hartimit të ligjeve. Megjithatë, është gjë e zakonshme që Zyra e tij të konsultohet për zbatimin e atyre ligjeve të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kryerjen e auditimeve për të cilat ai është përgjegjës dhe Zyra e tij shpesh përfaqësohet tek grupet e punës që merren me përmirësime të çështjeve të tilla si kontabiliteti i qeverisë.

Buxheti i Zyrës përcaktohet si pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shërbimit civil si një i tërë dhe i nënshtrohet politikës themelore të qeverisë në këto çështje. Kohë mbas kohe kjo ka çuar në alokime stafi dhe burimesh të

tjera të vogla që nuk janë ideale. Megjithatë, në praktikë kjo nuk ka çuar deri tani në probleme të pakapërcyeshme. Duhet vënë në dukje se rroga e K&AP-së (zakonisht si pagesat në gjyqësor) kryhet nga fondi qendror dhe jo nga pjesa e buxhetit vjetor të parlamentit, gjë që në këtë mënyrë thekson pavarësinë e tij kushtetuese.

Për sa i përket auditimit të Zyrës, përpara vitit 1993, stafi i Zyrës auditonte përdorimin e shumës së ndarë për Zyrën e K&AP-së. Megjithatë, u pranua se kjo ka qenë një situatë më pak se ideale dhe prandaj u hartua një dispozitë në legjislacionin e vitit 1993 për auditimin e kontabilitetit të Zyrës nga një auditues i jashtëm i caktuar nga K&AP-ë. Një auditues i tillë ka hapësirë të lirë të vendosë me miratimin e Ministrisë të Financave të kryejë shqyrtimin e “vlerës së parasë” (VFM) të Zyrës. Raporti i çdo shqyrtimi të tillë duhet të dërgohet tek K&AP dhe të paraqitet prej tij para Dhomës së Përfaqësuesve (Dáil Éireann). Ky raport pastaj duhet t’i vihet në dispozicion KLLP-së për shqyrtim në po të njëjtën mënyrë si çdo raport tjetër që prezantohet sipas ligjit. Deri më sot, asnjë shqyrtim i tillë nuk është kryer.

Për sa i përket rolit të mundshëm të KLLP-së në emërimin ose shkarkimin e K&AP-së, kushtetuta parashikon se K&AP-ë emërohet nga Presidenti me propozim të Dhomës së Përfaqësuesve (Dáil Éireann). Ai/ajo nuk mund të shkarkohet me përjashtim të rasteve të shprehura për sjellje të papranueshme ose paaftësi dhe pastaj vetëm pas një rezolute të miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati (Seanad Éireann) e cila kërkon shkarkimin e tij/saj.

7. Zhvillime të tjera

Në fillim të vitit 1998, raportet e medias sugjerorin se mund të kishte evazion të madh të Taksës për Mirëmbajtjen e Depozitës me Interes përmes përdorimit të llogarive bankare të jorezidentëve fals. KLLP-ë kërkoi të hetonte çështjen por doli në përfundimin se ai nuk kishte kompetencat e duhura për ta bërë këtë gjë. Kjo çoi në miratimin e ligjit për Kontrollorin dhe Audituesin e Përgjithshëm dhe të Komisioneve të Dhomave të Oireachtas (dispozita të posaçme) në vitin 1998, i cili i jepte K&AP-së kompetenca të gjera pothuajse si ato të gjyqësorit. Ligji i lejonte K&AP-së të hetonte funksionimin e taksave nga autoritetet për të ardhurat dhe institucionet financiare dhe të raportonte gjetjet e veta para Dhomës së Përfaqësuesve (Dáil Éireann). Ky hetim hapi një terren të ri dhe raporti i K&AP-së përbënte bazën për një analizë pasuese publike nga një nënkomision i KLLP-së për gjithë çështjen që krijoi një interes të madh publik. Kjo më në fund bëri që institucionet financiare dhe të tjera t’i paguanin shuma të mëdha autoriteteve që merreshin me të ardhurat. Kjo situatë rriti ndërgjegjësimin e publikut, të KLLP-së dhe të Zyrës së K&AP-së në nivele të panjohura më parë.

ANEKSI 6: BASHKËVEPRIMI MIDIS AUDITUESIT TË SHTESTIT DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE (IZRAEL) 9

Marrëdhënia midis Audituesit të Shtetit dhe Parlamentit izraelit (Knesset) shpreh edhe në nivel formal, edhe në nivel praktik, dy parime themelore:

1. Pavarësinë e Audituesit të Shtetit jo vetëm nga pushteti ekzekutiv, por edhe nga ai legjislativ.
2. Krijimin e një IKLSH-je të pavarur si një mjet kryesor për realizimin efektiv të parimit bazë të “së drejtës së publikut për t’u informuar”.

Duhet të mbahet parasysh se parlamentet janë, sipas përkufizimit, organe politike siç janë edhe të gjitha komisionet parlamentare. Përderisa auditimi i shtetit funksionon në një mjedis politik, atëherë ekziston mundësi për një tension të mundshëm midis interesit publik, siç paraqitet në raportet e auditimit dhe programit politik të deputetëve të parlamentit dhe ose të partive politike. Prandaj është e rëndësishme të mbahet mend se sa më shumë të merret auditimi i shtetit në fushat e auditimit të performancës, aq më shumë rritet mundësia për tensione të mundshme ngaqë vendimmarrësit mund që në disa rrethana të caktuara të përpiqen të kërcënojnë statusin e profesionalizmit dhe të paanësisë së Audituesit të Përgjithshëm.

Marrëdhëniet midis auditimit të shtetit në përgjithësi dhe parlamenteve kanë një bazë zyrtare ligjore, por ekzistojnë gjithashtu edhe disa aspekte jozyrtare të cilat zhvillohen përgjatë viteve dhe ndryshojnë nga rasti në rast.

Në rastin e Izraelit, disa prej këtyre marrëdhënieve janë formuluar në Ligjin Bazë, duke u dhënë atyre një pozicion kushtetues.

Nuk mund të ekzistojnë rregulla ose norma që të mund të eliminojnë frymën e politikës në diskutimet në komisionet parlamentare. Për më tepër, formalizmi nuk ka patjetër epërsi mbi traditën. Kjo do të thotë se kultura politike nuk është më pak dhe zakonisht është më shumë dominuese në formësimin e ekuilibrit dhe të marrëdhënieve midis aktorëve në arenën politike nga ç’janë rregullat zyrtare. Ky fakt themelor gjen zbatim edhe në marrëdhëniet midis organeve për të cilat po flasim.

Çështja nëse marrëdhëniet e IKLSH-së me parlamentin kanë ngjyrosje politike duhet të shqyrtohet edhe nga aspekti zyrtar, edhe nga ai jozyrtar dhe nuk duhet të ndahet nga çështja e pavarësisë së IKLSH-së.

Në aspektin zyrtar, në ligjin e Izraelit ka dispozita që përcaktojnë pavarësinë e Audituesit të Shtetit nga parlamenti duke siguruar kështu eliminimin e ndikimit politik mbi Audituesit e Shtetit.

Ligji parashikon se “në kryerjen e funksioneve të tij/saj, Audituesi i Shtetit mban përgjegjësi vetëm përpara parlamentit (Knesset-it) dhe nuk varet nga Qeveria”. Kjo do të thotë se Audituesi i Shtetit nuk varet nga parlamenti (Knesset-i).

Kjo pavarësi sigurohet nga procedurat për zgjedhjen e Audituesit të Shtetit (votim i fshehtë në seancë plenare), nga procedurat për përcaktimin e buxhetit të zyrës dhe nga fakti se as parlamenti dhe as komisionet e tij nuk kanë ndonjë ndikim mbi programin e auditimit të zyrës. Ata nuk kanë kompetencë të diktojnë ose të përfshihen në përzgjedhjen e subjekteve që do të auditohen ose të përcaktojnë se çfarë metodologjie duhet të përdoret si në fusha të veçanta ashtu edhe në përgjithësi. Për më tepër, një kërkesë e bërë nga një anëtar individual i parlamentit që Audituesi i Shtetit të hetojë një çështje të caktuar, nuk ka asnjë përparësi ndaj një kërkesë të dorëzuar nga çdo person tjetër. Të dy këta njoftohen që çështja që ata kanë sjellë në vëmendjen e Audituesit do të shqyrtohet sipas përparësive të zyrës dhe se ata nuk do të informohen personalisht as për vendimin nëse çështja do të shqyrtohet apo jo, dhe as për gjetjet e një raporti të ndërmjetëm.

Bashkëveprimi midis Audituesit të Shtetit dhe Parlamentit kryhet kryesisht në dy organe të parlamentit: në seancën plenare dhe në Komisionin e Çështjeve të Auditimit të Shtetit. Ky i dyti është organ më madhor në këtë drejtim.

Kontaktet me seancën plenare të parlamentit bëhen për tre çështje madhore:

⁹ Raport i përgatitur nga Z.Yehoshua Roth nga Zyra e Auditimit të Shtetit të Izraelit (marrë në 9 maj 2001).

1. Zgjedhja e Audituesit të Shtetit: autoriteti që propozon për postin e Audituesit të Shtetit është pushteti legjislativ. Pushteti ekzekutiv nuk ka rol në këtë çështje. 10 ose më shumë deputetë të parlamentit mund të propozojnë një kandidat që do të zgjidhet si Auditues. Audituesi zgjidhet nga seanca plenare e Knesset-it me një votim të fshehtë për një mandat prej shtatë vjetësh. Kjo procedurë (dhe kohëzgjatja e mandatit) është e njëjtë me atë të zgjedhjes së Presidentit të Shtetit. Presidenti nuk ka kompetenca ekzekutive dhe konsiderohet se simbolizon unitetin e shtetit. Procedura e njëjtë e zgjedhjes synon të shprehë që Audituesi i Shtetit duhet të gëzojë konsensus publik. Duhet vënë në dukje se deri në vitin 1998, Audituesi i Shtetit zgjidhet nga Komisioni i Dhomës i Knesset-it (dhe pastaj emërohet nga Presidenti). Amendimi i ligjit është shprehje e idesë së sipërpërmendur dhe përforcohet nga fakti se e drejta e zgjedhjes së tij u përjashtua nga autoriteti i vetëm një grupi anëtarësh. Shkarkimi i Audituesit nga detyra kërkon një rezolutë të Knesset-it të mbështetur me një shumicë prej 2/3 e atyre që kanë votuar.
2. Vendosja e Raportit Vjetor të Audituesit të Shtetit në tryezën e seancës plenare të parlamentit (Knesset-it).
3. Miratimi i rekomandimeve të formuluar pas diskutimeve të raporteve të Audituesit të Shtetit në Komision.

Komisioni i Çështjeve të Auditimit të Shtetit është kanali kryesor i komunikimit midis dy institucioneve. Ligji shprehet se Audituesit duhet t'i kryejë aktivitetet e veta në kontakt me Komisionin. Kështu, sipas tekstit të ligjit, ai/ajo nuk varet as nga komisioni. Ky është një komision i posaçëm i përhershëm parlamentar, i ngritur me qëllim që të merret kryesisht me raportet e auditimit të shtetit. Nga kjo dispozitë del se Audituesi nuk duhet të marrë pjesë në seancat e komisioneve të tjera të parlamentit (Knesset-it) gjatë kryerjes së aktiviteteve rutinore të tij/saj, megjithëse ato mund të merren me subjekte që hetohen nga Audituesi. Ai/ajo nuk del as para seancës plenare të Knesset-it, me përjashtim të rastit të kryerjes së betimit.

Komisioni mban tre seanca javore në të cilat Audituesit dhe stafi i tij/saj merr pjesë gjithmonë. Meqë Komisioni nuk është në gjendje të trajtojë të gjitha raportet e Kontrollorit, duhet të kryhet një përzgjedhje. Është temë interesante se si kryhet kjo zgjedhje.

Në fakt, është kompetencë e Kryetarit të Komisionit të përcaktojë se me cilat subjekte do të merret. Megjithatë, Audituesi e këshillon jozyrtarisht Kryetarin e Komisionit në lidhje me përparësitë e raporteve që do të diskutohen.

Megjithatë do të ishte naive të mendohej se përzgjedhja e kryer nga Kryetari i Komisionit e injoron në çdo rast agjendën publike.

Përzgjedhja aktuale nuk pasqyron domoshmërisht një preferencë të njëjtë të Audituesit dhe të Kryetarit të Komisionit meqë preferenca e Kryetarit mund që disa herë të shprehë më shumë një interes të fshehtë "sektorial" sesa një rëndësi objektive të disa raporteve të shqyrtuara nga pikëpamja thjesht profesionale.

Sipas një dispozite të caktuar të ligjit, Audituesi duhet (nëse kërkohet kjo nga Knesset-i, nga Komisioni ose nga Qeveria) të përgatisë një "mendim" për çdo çështje të fushës së veprimit të funksioneve të tij/saj. Çështja nëse ky "mendim" duhet të interpretohet si një hetim vetëm në lidhje me një çështje parimore apo si një kërkesë për një raport të rregullt, nuk është trajtuar ndonjëherë.

Kjo dispozitë që u mundëson organeve të sipërpërmendura të detyrojnë Audituesi e Shtetit të kryejë një auditim për një çështje të caktuar ka gjetur zbatim shumë rrallë.

Knesset-i dhe Qeveria asnjëherë nuk kanë kërkuar një "mendim" dhe Komisioni nuk e ka bërë këtë që prej një dekade.

Në praktikë, kur Komisioni shqyrton një kërkesë të tillë për "mendim", e cila mund të jetë bërë nga çdonjëri prej anëtarëve të tij, ia lë Audituesit në fakt për konsideratë nëse do ta shqyrtojë atë çështje apo jo. Ekziston një lloj "marrëveshje xhentëlmenësh" midis Audituesit dhe Komisionit sipas së cilës nuk do të ketë votim me qëllim që të mos imponohet zyrtarisht Audituesi në kryerjen e një hetimi. Kështu, praktika tregon "realitetin kushtetues" në këtë drejtim.

Anëtarët e Komisionit disa herë e përdorin këtë dispozitë me qëllim që të ngrenë çështje të posaçme në Komision. Duke qenë se ky Komision ka terma reference shumë të qarta, mund të pritët që këto çështje të kenë të bëjnë me ato të ngritura në raportin e auditimit. Megjithatë, realiteti është krejt ndryshe. Këto çështje janë disa herë të lidhura dobët me raportet dhe pasqyrojnë më shumë përpjekjet e anëtarëve të Komisionit për

të tërhequr vëmendjen e publikut për veprimtarinë e tyre parlamentare. Kështu, ata zakonisht mjaftohen duke ngritur çështjen dhe nuk i kërkojnë Kontrollorit të dorëzojë një mendim të posaçëm për atë çështje. Kur çështja ka natyrë të qartë politike (gjë që është shumë e rrallë), Audituesi heq dorë nga ndjekja e këtyre seancave parlamentare, megjithëse ai/ajo është i ftuar.

Duhet të vihet në dukje se Komisioni zakonisht i kryen diskutimet e tij në një atmosferë jopolitike. Anëtarët e Komisionit në përgjithësi janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e Zyrës së Audituesit të Shtetit si një burim informacioni të besueshëm dhe të paanshëm për Kneset-in dhe publikun. Ata janë të ndërgjegjshëm për pasojat negative të politizimit të diskutimeve dhe heqin dorë nga këto.

Audituesi i Shtetit ka gjithashtu të drejtë të vendosë nëse faktet e zbuluara përgjatë hetimit të tij/saj kërkojnë të dorëzohet një raport i posaçëm në Komision apo jo. Ai/ajo do të vendosë për të dërguar raport kur hetimi zbulon shkeljen e standardeve morale ose ngre një problem themelor dhe kështu kërkon, sipas mendimit të tij/saj, vëmendjen e veçantë të Komisionit. Nëse Audituesi e bën këtë gjë, Komisioni, me nismën e vet, ose me propozim të Kontrollorit, mund të vendosë për krijimin e një komisioni hetimor. Komisioni mund që në rrethana të veçanta dhe me miratim të Audituesit, të vendosë mbi krijimin e një komisioni të tillë për një çështje që përfshihet në ndonjërin prej raporteve të tij/saj të rregullta.

Në praktikë, Komisioni nuk ka vendosur kurrë për ngritjen e një komisioni hetimor mbi bazën e iniciativës së tij. Ai e ka bërë këtë gjë vetëm me propozim të Audituesit. Për më tepër, Audituesi heq dorë nga dërgimi i një raporti të tillë të veçantë, nëse ai nuk ka arritur në përfundimin se ngritja e një komisioni hetimor është i domosdoshëm. Duhet të vihet në dukje gjithashtu se Komisioni nuk e ka mohuar kurrë një propozim të tillë të Audituesit. Një nga shembujt e përdorimit të këtij mjete ishte krijimi i një komisioni hetimor pasi Audituesi dorëzoi një raport të posaçëm që hetonte krizën e tregut të aksioneve të Izraelit në fillim të viteve 1980, i cili çoi në shkarkimin e krerëve të bankës së përfshirë në të.

Në vijim të diskutimeve mbi raportet e auditimit, Komisioni dorëzon përfundimet dhe rekomandimet e tij për miratim në seancën plenare të Kneset-it. Duhet thënë se mbi bazën e marrëdhënieve jozyrtare të ndërtuara midis Komisionit dhe Audituesit, Komisioni i kërkon Audituesit t'i nisë vërejtjet që ka për rekomandimet përpara se t'i dorëzojë ato për të marrë miratimin e Kneset-it. Duhet theksuar se ky është i vetmi komision i Kneset-it, të gjitha rekomandimet e të cilit sipas ligjit duhet të miratohen në seancë plenare.

Komisioni, me propozim të Audituesit, mund të vendosë që disa pjesë të caktuara të raportit të mos botohen nëse ai e sheh të nevojshme të veprojë kështu në interes të ruajtjes së sigurisë së shtetit ose me qëllim që të shmangë dëmtimin e marrëdhënieve të tij të jashtme apo të marrëdhënieve të tij tregtare ndërkombëtare. Praktikisht, organet e audituara ia bëjnë të ditur Audituesit se cili informacion në raport rrezikon interesat e përmendura sipas mendimit të tyre, dhe prandaj nuk duhet të bëhet publik. Ndodh shumë shpesh që Audituesi të mos i pranojë argumentet e organeve të audituara. Duhet thënë se pavarësisht nga fakti që Komisioni përbëhet nga figura politike që natyrshëm kanë perceptimet e tyre të ndryshme për kufijtë e sekretit, gjenden zakonisht pika të përbashkëta në përcaktimin e këtyre kufijve. Ka shumë pak mundësi që Komisioni të vendosë ta lerë jashtë informacionin që bie në kontradiktë me pozicionin e Audituesit.

Versioni i plotë i raportit të auditimit diskutohet ose në një seancë e cila deklarohet sekrete, ose në rastin e një raporti që merret me shërbimet sekrete, nga një komision i posaçëm i përbashkët i Komisionit të Çështjeve të Auditimit të Shtetit dhe Komisionit të Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë të Kneset-it. Komisioni i përbashkët u ngrit si një mjet praktik për të trajtuar këto raporte dhe sipas ligjit nuk ka asnjë kompetencë.

Duhet vënë në dukje se Kryetari i Komisionit të Çështjeve të Auditimit të Shtetit të Kneset-it është sipas traditës një anëtar i opozitës dhe arsytet e kësaj kuptohen qartë. Nga ana tjetër, shumica e anëtarëve janë nga partitë që përbëjnë bllokun e koalicionit.

Në të njëjtën mënyrë, Kneset-i e ka pranuar mendimin e Audituesit që një ministër të mos emërohet si kryetar i Komisionit, gjatë një periudhe të caktuar kohe pasi partia e tij ka rënë nga pushteti. Ideja e kësaj është ose të shmangët përshtypja ose mundësia aktuale që ai është në këtë pozitë si rezultat i veprimtarisë së tij në qeverinë ku ka qenë edhe vetë anëtar, ose të hiqet dorë nga shtruarja për diskutim në tavolinën e Komisionit e çështjeve të pakëndshme.

Mbi bazën e propozimit të Audituesit, Kneset-i amendoi ligjin, i cili parashikon se një person që ka shërbyer si ministër, si zëvendësministër, ose si Drejtor i Përgjithshëm apo Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i ndonjë institucioni qeveritar nuk duhet të jetë Kryetar i Komisionit për dy vjet nga dita e përfundimit të një detyre të tillë. Një anëtar i Komisionit që ka pasur ndonjërin nga postet e sipërpërmendura nuk duhet të marrë pjesë në

diskutimet e Komisionit që kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së tij gjatë periudhës që ai ka shërbyer në postet e mësipërme.

Amendamentet në Ligjin mbi Audituesin e Shtetit janë ose të iniciuara nga Audituesi ose nga anëtarët e Knesset-it dhe trajtohen nga Komisioni. Në praktikë, anëtarët e Knesset-it konsultohen me Audituesin para se të fillojnë zyrtarisht të merren me këto amendamente, kryesisht me qëllim që të bindet Audituesi për nevojën e amendamentit. Kjo gjë bëhet jo thjesht për mirësjellje, por për faktin e njohur se nuk është e mundur që Knesset-i të imponojë një amendament për Audituesin.

Procedura e punës me buxhetin e Zyrës së Audituesit të Shtetit është e papërsëritshme dhe trajtohet nga dy komisione të Dhomës me qëllim që të shmanget pozita monopoliste e një Komisioni të Knesset-it përkundrejt Audituesit.

Komisioni i Financave i Knesset-it me propozim të Audituesit të Shtetit, miraton buxhetin e zyrës, por raporti financiar i përgatitur pas përfundimit të vitit financiar, dërgohet në Komisionin e Çështjeve të Auditimit të Shtetit.

Kur miratojnë buxhetin, anëtarët e Komisionit të Financave mund të kërkojnë sqarime. Megjithatë, për shkak të respektit dhe të besimit që gëzon Audituesi, ata nuk e kanë vënë asnjëherë në diskutim filozofinë ose strategjinë bazë të buxhetit të propozuar. Duhet të vihet në dukje se në praktikë, buxhetet e propozuar nga të gjithë Audituesit nëpër vite, janë miratuar gjithmonë pa ndonjë ndryshim.

Marrëdhëniet midis dy institucioneve pasqyrojnë përvojën e Izraelit në zbatimin e parimit të ndarjes së pushteteve, të udhëhequr nga rregulli i vetëkontrollit, si pjesë e kulturës politike të zhvilluar në Izrael.

ANEKSI 7: MARRËDHËNIET MIDIS GJYKATËS SË AUDITIMIT DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË HOLANDË¹⁰

1. Roli dhe objektivi i përgjithshëm i parlamentit dhe i Komisioneve Parlamentare në lidhje me Institucionin e Auditimit të Lartë (IKLSH)

Roli dhe objektivat e përgjithshëm të parlamentit dhe të Komisioneve Parlamentare në marrëdhëniet me Gjykatën e Auditimit të Holandës mund të përshkruhen me fjalët “kontroll” dhe “informacion”. Të fillojnë me fjalën e parë: mund të thuhet se parlamenti holandez sigurisht që e kontrollon qeverinë, siç bën çdo parlament që e kryen seriozisht rolin e tij. Në Holandë megjithatë, ka një diskutim publik për mundësitë e kufizuara që ka parlamenti për të kontrolluar qeverinë që ka mijëra nëpunës civilë. Të 150 deputetët e parlamentit kanë secili, në rastin më të mire, nga një ndihmës, por çdo ministër ka me mijëra nëpunës civilë që mund ta ndihmojnë atë në bashkëveprimin e tij me parlamentin. Po të shpreheshim në mënyrë cinike, mund të thuhet se është një “mision i pamundur” për një ose edhe dy deputetë të parlamentit që të mos bien dakord me një ministër përderisa ky ministër ka një staf shumë të madh për të parandaluar këtë konflikt. Sipas kësaj linje arsyetimi, parlamenti holandez përdor, veç raporteve të tjera të jashtme, edhe auditimet e Gjykatës së Auditimit të Holandës në funksionin e tij kontrollues në lidhje me qeverinë. Gjykata e Auditimit të Holandës ka një staf mjaft të madh dhe me kualifikimet përkatëse për të vlerësuar seriozisht punën e ministrisë. Parlamenti mund të formulojë një gjykim politik rreth ministrit përgjegjës duke u mbështetur në auditimet e IKLSH-së.

Faza e dytë që mund të përdoret për të përshkruar objektivat e parlamentit në lidhje me Gjykatën e Auditimit të Holandës është, siç u përmend më sipër, “informacioni”. Ashtu si mundësia e parlamentit për të kontrolluar qeverinë është e kufizuar, edhe mundësitë e parlamentit holandez për të kërkuar informacion për punët publike janë të kufizuara, për shkak të stafit të tij të vogël. Prandaj parlamenti është i kënaqur të përdorë informacionin e institucioneve të pavarura të tilla si Zyra Qendrore e Statistikave, Zyra e Planifikimit Qendror, dhe Gjykata e Auditimit të Holandës. Raportet e publikuara nga këto institucione përmbajnë informacion të cilin deputetët e parlamentit mund ta përdorin për të vlerësuar gjendjen e vendit, e si rrjedhim funksionimin e qeverisë dhe formulimin e pikëpamjeve politike.

Kohët e fundit, parlamenti holandez e fuqizoi stafin e tij mbështetës dhe rriti buxhetin e tij për kërkime. Është ngritur një njësi që synon të veprojë si një “ndërmjetës” midis parlamentit (që ka nevojë për informacion) dhe publikut ose studiuesve komercialë (që kanë shkathtësitë, njohuritë dhe kapacitetet). Aktualisht nuk ekzistojnë plane për krijimin e ndonjë instituti kërkimor për çështje parlamentare.

2. Përbërja dhe mënyra e veprimit e Komisioneve Parlamentare përkundrejt IKLSH-së

Përbërja dhe mënyra e veprimit e Komisioneve Parlamentare përkundrejt Gjykatës së Auditimit të Holandës përgjithësisht nuk është shumë e ndryshme nga përbërja dhe mënyra e veprimit e komisioneve parlamentare përkundrejt institucioneve të tjera. Komisionet përbëhen nga anëtarë të të gjitha partive politike të përfaqësuara në parlament dhe kontakti i Gjykatës së Auditimit të Holandës është me parlamentin si një i tërë ose me një komision përfaqësues dhe jo me parti politike të veçanta. Auditimet e Gjykatës së Auditimit të Holandës publikohen ose nën kujdesin e ministrit ose nën atë të parlamentit. Në rastin kur me to merret parlamenti, Gjykata ofron një informim të shkurtër për auditimin para se të bëhet publikimi. Komisioni i Shpenzimeve Shtetërore që merr këtë ofertë, përgjithësisht e pranon atë dhe fton edhe komisionet e tjera për informimin. Pjesa më e madhe e komisioneve përkatëse parlamentare janë prezent në informim, meqë audituesit që i drejtohen parlamentit mund të përdoren me lehtësi për debatin politik me ministrin/at përgjegjës. Është shumë e vështirë të thuhet nëse ekzistojnë rregulla për të garantuar karakterin apolitik të veprimtarisë së komisionit parlamentar përkundrejt Gjykatës së Auditimit të Holandës, meqë komisionet e parlamentit janë nga natyra institucione politike. Sigurisht ekzistojnë rregulla për të garantuar që Gjykata të mos ndikohet nga një parti e vetme ose nga një numër i vogël partish, të tilla si rregulli që kërkesa për auditim mund të bëhet vetëm nga shumica e parlamentit. Gjykata e Auditimit të Holandës gjithashtu siguron që debati

¹⁰ Raport i përgatitur nga Z. Omar Ramadan, zëdhënës i Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe Z. Steven Jongejan, Këshilltar Politik për Gjykatën e Auditimit të Holandës (marrë në 27 shtator 2001).

politik të jetë një debat midis parlamentit dhe qeverisë, pa përfshirë Gjykatën e Auditimit të Holandës si një palë të tretë. Auditimet shpesh ofrojnë mundësinë për një debat të tillë politik, por nëse anëtarët e parlamentit, për shembull, e pyesin Gjykatën nëse sipas mendimit të saj një ministër duhet të japë dorëheqjen apo jo, përgjigja gjithmonë do të jetë që Gjykata nuk ka mendime për këtë çështje dhe që kjo çështje i takon parlamentit. Pyetjet në lidhje me përmbajtjen e dëshirueshme të politikave të ardhshme në përgjithësi nuk marrin përgjigje të hollësishme, me përjashtim të çështjeve të tilla si kontrollueshmëria e të gjitha llojeve të politikave.

3. Roli i Komisionit Parlamentar në shqyrtimin e raporteve të IKLSH-së dhe të rezultateve të tjera

Roli i Komisionit Parlamentar në shqyrtimin e raporteve të auditimeve të IKLSH-së fillon me informimin që u përmend më sipër. Komisionet përkatëse ftohen në informim, i cili është i mbyllur për publikun dhe kryhet në ndërtesat e parlamentit. Siç u përmend më parë, të gjitha komisionet parlamentare përbëhen nga anëtarë të të gjitha partive politike, por shumica e informimeve të Gjykatës së Auditimit të Holandës ndiqen vetëm nga anëtarë të pesë partive më të mëdha politike. Aktualisht këto janë tre parti qeveritare dhe dy partitë më të mëdha të opozitës. Tre partitë më të vogla të opozitës nuk kanë numër të mjaftueshëm deputetësh në parlament për të ndjekur shpesh informimet që në dukje nuk janë dhe aq të rëndësishme. Informimet bëhen përpara se auditimet të jenë gati për publikim në shtyp dhe të gjithë anëtarët e komisioneve përkatëse parlamentare (edhe ato nga partitë më të vogla që ka mundësi të mos e ndjekin informimin) do ta marrin raportin e auditimit një ditë përpara informimit dhe publikimit. Informimi përbëhet nga një prezantim i një anëtari të Bordit dhe të anëtarëve stafit të Gjykatës, pas të cilit deputetët e parlamentit mund të bëjnë pyetje. Zakonisht, deputetët e parlamentit nuk bëjnë pyetje politike të llojit që nuk mund t'u jepet përgjigje nga gjykata, të tilla si pyetja e fundit e përmendur më sipër nëse duhet të japë dorëheqjen një ministër apo jo. (Një ministër duhet të japë dorëheqjen për asnjë arsye tjetër përveçse për mungesën e besimit të parlamentit tek ai). Pak kohë pas informimit dhe publikimit të auditimit, Gjykata e Auditimit e Holandës shpesh merr pyetje me shkrim nga parlamenti. Përveç pyetjeve me gojë që bëhen në kohën e informimit, komisioni parlamentar si një i tërë bën pyetje me shkrim. Gjykata e Auditimit iu përgjigjet gjithmonë atyre. Po ashtu, ministri ose ministrat përkatës mund t'i bëjnë parlamentit pyetje me shkrim për auditimin dhe të marrin informacionet që Gjykata planifikon t'ia japë parlamentit.

4. Shkalla e pavarësisë së IKLSH-së nga Komisionet Parlamentare

Shkalla e pavarësisë e Gjykatës së Auditimit të Holandës në marrëdhëniet e saj me parlamentin mund të konsiderohet shumë e madhe. Nga përgjigjet e pyetjeve më poshtë, mund të arrihet në përfundimin se parlamenti, në pak mënyra, ka njëfarë ndikimi zyrtar mbi veprimtarinë e IKLSH-së. Megjithatë, në praktikë, ky ndikim është shumë i kufizuar.

5. Roli i Komisionit Parlamentar në veprimtarinë e IKLSH-së

(a) Programi i auditimit i Gjykatës së Auditimit të Holandës është prerazi përgjegjësi e vetë IKLSH-së, përveç faktit që Gjykata është e detyruar me ligj të kryejë një auditim të rregullt çdo vit dhe që kërkohet t'i kushtojë vëmendje efikasitetit të qeverisë. Programi është konceptuar me bashkëpunimin e ngushtë të Bordit me stafin. Prej një numri të madh auditimesh dhe veprimtarish të tjera të mundshme përzgjidhet një pjesë bazuar në programin strategjik të Bordit dhe në monitorimin e gjerë të fushave të politikave përkatëse. Programi i prezantohet parlamentit në një seancë të mbyllur të Komisionit të Shpenzimeve të Shtetit (dhe bëhet publik). Gjatë kësaj seance ekziston mundësia që anëtarët të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë për përmbajtjen e programit.

Vitet e fundit, Gjykata e Auditimit e Holandës e ka përfshirë më shumë parlamentin në procesin që çon në programin e auditimit. Para se Gjykata e Auditimit e Holandës bëri publik programin e vet, parlamenti morri një draft. Bashkë me Komisionin e Shpenzimeve të Shtetit që vepron si një ndërmjetës, komisioneve të tjera parlamentare iu kërkua të bëjnë propozime për auditime dhe/ose për përshtatje të auditimeve të propozuara. Disa nga këto propozime kanë çuar në auditime të reja ose në ndryshime në program. Këtë vit do të përdoret një qasje tjetër. Përpara se të fillojë procesi përzgjedhës, parlamenti do t'i jepet mundësia të bëjë vetë propozime. Këto propozime do të përdoren si input për procesin e përzgjedhjes.

(b) Parlamenti (jo një komision parlamentar) ka të drejtën të kërkojë një auditim. Që kjo të bëhet e mundur nevojitet një shumicë parlamentare. Kjo bëhet përmes hapave të mëposhtëm:

- Ideja për një kërkesë del fillimisht nga një ose më shumë deputetë të një prej komisioneve.
- Nëse diskutimi në këtë komision tregon se ekziston një shumicë, kërkesa i çohet për mendim Komisionit të Shpenzimeve Shtetërore.
- Komisioni i Shpenzimeve Shtetërore jep mendimin e vet për përmbajtjen e kërkesës (për shembull, nëse një auditim është i mundshëm të bëhet apo jo) dhe për mundësinë e bërjes së auditimit nga Gjykata e Auditimit e Holandës (duke pasur parasysh kompetencat dhe pozicionin e saj kushtetues).
- Propozimi sillet zyrtarisht para gjithë parlamentit dhe hidhet në votim.

Gjatë këtij procesi, ekziston një kontakt i shpeshtë në nivel stafi midis Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe parlamentit. Në këtë mënyrë sigurohet që kërkesa është e pranueshme dhe e mundshme për Gjykatën e Auditimit të Holandës. Për këtë, përgjigjja e Gjykatës së Auditimit të Holandës është pothuajse gjithmonë pozitive.

(c) Gjykata e Auditimit e Holandës e ndihmon rregullisht Komisionin e Shpenzimeve Shtetërore përmes vendosjes së përkohshme të një punonjësi të vet në këtë komision.

Komisione të tjera parlamentare dhe/ose vetë parlamenti si i tërë marrin mbështetje mbi një bazë *ad hoc*, duke marrë njohuri ose njerëz.

(d) Metodologjia e auditimeve të Gjykatës së Auditimit të Holandës është një çështje e vetë IKLSH-së dhe parlamenti nuk përfshihet në këtë gjë.

6. Funkzione të tjera të mundshme

(a) Gjykata e Auditimit e Holandës nuk ka një rol zyrtar në procesin ligjberës. Megjithatë, IKLSH-ë ka mundësinë t'ia komunikojë komentet e veta parlamentit ose ministrit përkatës.

(b) Zyrtarisht, buxheti i Gjykatës së Auditimit të Holandës (bashkë me atë të Këshillave të tjerë të Lartë të shtetit) është pjesë e buxhetit të Ministrit të Punëve të Brendshme. Kjo do të thotë se është ky ministër personi që e bën propozimin për këtë buxhet në parlament. Në rast mosmarrëveshjeje, Gjykata e Auditimit e Holandës mund ta ngrejë çështjen në Komisionin e Shpenzimeve të Shtetit, por duhet të mbështetet tek anëtarët e Dhomës së Ulët për të propozuar amendamente në buxhet. Rregulli i pashkruar është se parlamenti është i kujdesshëm në ushtrimin e të drejtave të tij buxhetore, sepse një përfshirje shumë e madhe mund të ndërhyjë në pavarësinë e IKLSH-së. Megjithatë, zyrtarisht është e mundur që parlamenti të pakësojë ose të rrisë buxhetin e Gjykatës së Auditimit të Holandës.

(c) Puna e Gjykatës së Auditimit të Holandës nuk vlerësohet nga parlamenti në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale. Gjykata e Auditimit e Holandës paraqet çdo vit në parlament raportin e vet në një seancë të mbyllur të Komisionit të Shpenzimeve të Shtetit. Gjatë kësaj seance dhe takimeve të tjera midis Bordit dhe Komisionit, deputetët kanë shansin të shprehin mendimet e tyre në lidhje me Gjykatën e Auditimit të Holandës dhe me punën e saj. Përveç kësaj, deputetët e parlamentit komentojnë shpesh në media mbi raportet e auditimit dhe të gjithë institucionin si tërë.

(d) Rregullsia e shpenzimeve të Gjykatës si një auditues shtetëror duhet sigurisht të auditohet. Sistemi i auditimit është si më poshtë: Gjykata cakton një auditues të brendshëm, i cili auditon llogaritë vjetore dhe menaxhimin financiar për vitin në fjalë. Audituesi i brendshëm raporton tek Komisioni i Auditimit. Departamenti i Auditimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme i përdor këto gjetje, kryen auditime shpesh nëse e ka të nevojshme dhe raporton tek ministri. Cikli mbyllet në momentin kur Gjykata, si pjesë e auditimit të rregullt të të gjithë kapitujve të buxhetit, shqyrton auditimet e departamentit të auditimit të ministrisë, përfshirë edhe atë të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi Këshillat e Lartë të Shtetit (ku futet edhe vetë Gjykata). Në këtë proces, Gjykata mund të zbulojë mangësi në menaxhimin financiar, të cilat ajo i raporton pastaj në auditimin e saj të rregullt. Gjykata kupton se ajo duhet të japë një shembull dhe përpiqet ta bëjë këtë gjë.

(e) Bordi i Gjykatës së Auditimit të Holandës përbëhet prej tre anëtarësh të emëruar me dekret mbretëror. Në një proces të ndarë prej këtij, njëri prej tyre emërohet nga presidenti. Ky dekret mbretëror është në fakt një vendim qeverie.

Në rastin kur në Bord krijohet një vend vakant, njoftohet parlamenti dhe Gjykata e Auditimit e Holandës ofron një listë me gjashtë kandidatë. Mbështetur në këtë listë dhe në kandidatë të rinj të mundshëm të propozuar nga vetë parlamenti, bëhet një rekomandim për qeverinë. Qeveria merr vendimin. Anëtarët e emëruar janë të përhershëm, por dalin në pension maksimumi në moshën 70 vjeçare. Anëtari mund të shkarkohet vetëm nga Gjykata e Lartë e Holandës.

Legjislacioni në lidhje me Gjykatën e Auditimit të Holandës është i përcaktuar në Ligjin mbi Llogaritë Qeveritare. Në këtë ligj thuhet se Ministri i Financave ka detyrimin të konsultohet me Gjykatën e Auditimit të Holandës në lidhje me ndryshimet në ligj, ndryshime të cilat kanë ndikim në punën e këtij organi.

ANEKSI 8: MARRËDHËNIET E ZYRËS SË AUDITUESIT TË PËRGJITHSHËM TË NORVEGJISË DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE¹¹

1. Roli dhe objektivat e përgjithshëm të parlamentit dhe të komisioneve parlamentare në marrëdhëniet me IKLSH-në

Zyra e Audituesit të Përgjithshëm (ZAP) është agjencia kontrolluese e parlamentit. Origjina e saj është në Kushtetutën e Norvegjisë të vitit 1814 e cila parashikon se parlamenti, për mandatin e tij 4 vjeçarë duhet të zgjedhë pesë Auditues të Përgjithshëm për të shqyrtuar deklaratimet financiare të qeverisë. Këta pesë auditues të përgjithshëm, njëri prej të cilëve zgjidhet si kryetar, përbëjnë Bordin e Audituesve të Përgjithshëm (Bordi) me autoritetin të drejtë dhe të mbikëqyrë të gjitha çështjet e politikave të përgjithshme. Angazhimet politike të audituesve të përgjithshëm priren të pasqyrojnë përbërjen politike të parlamentit dhe Bordi shpesh përbëhet prej anëtarësh që kanë qenë më parë deputetë të parlamentit.

ZAP-i është organi mbikëqyrës i parlamentit. Ai i dorëzon raportet e tij tek parlamenti, si ato për rezultatet e auditimeve që ka kryer ashtu edhe ato mbi veprimtarinë e vet. Të gjitha publikimet e ZAP-it paraqiten si dokumente zyrtare të parlamentit dhe në fund ato trajtohen në seancat plenare të parlamentit. Të gjitha gjetjet ose rezultatet e dorëzuara nga ZAP-i trajtohen dhe paraqiten në emër të parlamentit nga Komisioni i Përhershëm mbi Inspektimin dhe Çështjet Kushtetuese (Komisioni).

Komisioni analizon dhe i dorëzon parlamentit rekomandime për:

- Shpjegimet e ZAP-it me përgjigjet dhe miratimin e llogarive vjetore si edhe për vendimet dhe masat e rekomanduara të konsideruara të nevojshme në lidhje me miratimin.
- Raportin vjetor të ZAP-it për aktivitetet e tij si edhe raportin për parlamentin i cili dëshmon nëse auditimi i llogarive është kryer në përputhje me udhëzimet për ZAP-in.
- Raportet nga ZAP-i në lidhje me inspektimin e administrimit e interesave të shtetit në ndërmarrjet që janë pronë shtetërore, etj., si edhe për çështjet e lidhura me veprimtarinë e ZAP-it.

2. Përbërja dhe mënyra e veprimit të Komisioneve Parlamentare përkundrejt IKLSH-së

Pas zgjedhjeve, të gjithë deputetët e parlamentit caktohen si anëtarë të komisioneve të përhershme parlamentare. Procedurat për zgjedhjen dhe detyrat e komisioneve të ndryshme janë të përcaktuara në Rregullat e Procedurave të Parlamentit. Sipas këtyre rregullave, grupet parlamentare duhet të jenë të përfaqësuara proporcionalisht në komisione sa më shumë që të jetë e mundur kjo.

Siç u përshkrua, Komisioni i Përhershëm mbi Inspektimin dhe Çështjet Kushtetuese (Komisioni) analizon dhe bën rekomandime për të gjitha raportet e ZAP-it. Komisioni është pranuar të kryejë edhe shqyrtimet e veta në ministrinë. Qëllimi i shqyrtimeve të filluara nga vetë Komisioni është të grumbullojë informacion të nevojshëm për t'i dhënë mundësi parlamentit të merret me përgjegjësinë kushtetuese dhe parlamentare të anëtarëve të qeverisë. Në raste të tilla, ZAP-it mund t'i kërkohet të japë mendimin e vet ose të bëjë një deklaratë para se të merret çdo lloj vendimi. Megjithatë, ZAP-i nuk është i detyruar ta bëjë këtë gjë.

3. Roli i Komisionit Parlamentar në analizën e raporteve të IKLSH-së dhe të rezultateve të tjera

Raportet e auditimit nuk ka shumë të ngjarë të çojnë në hetimin parlamentar të një ministri. Në vend të kësaj, parlamenti mund të kërkojë që qeveria ose ministri të mbajnë përgjegjësi parlamentare ose politike. Megjithatë, kritikata parlamentare e politike të ministrit përgjegjës është rezultati më i zakonshëm i raporteve. Me këtë rast kryhen edhe seanca të hapura dëgjimore që bazohen në raportet e auditimit të performancës të kryer nga ZAP-i.

¹¹ Raport i marrë më 30 prill 2001 nga Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë.

Zakonisht, kryetari i Bordit dhe anëtarë të tjerë të stafit të ZAP-it janë të pranishëm si vëzhgues gjatë seancës plenare të parlamentit ku debatohet për raportet e auditimit.

Përfaqësues nga ZAP-i kanë qenë të pranishëm edhe gjatë seancave të hapura dëgjimore në Komision kur seanca dëgjimore bazohet në një raport të ZAP-it. Kohë pas kohe, përfaqësues nga ZAP-i takohen kur Komisioni mbledhet për të diskutuar raportet e auditimit. Megjithatë, kjo nuk është një procedurë e zakonshme.

4. Shkalla e pavarësisë e IKLSH-së nga Komisionet Parlamentare

Nga pushteti legjislativ që i jep kushtetuta parlamentit del se ai është i detyruar të hartojë dispozita ligjore në lidhje me mandatin, detyrimet dhe përmasat e punës audituese. Parlamenti përcakton gjithashtu edhe burimet financiare për ZAP-in.

Legjislacioni aktual nuk thotë gjë se si duhet t'i kryejë ZAP-i detyrat e veta. Megjithatë, pranohet si e mirëqenë nga parlamenti dhe ZAP-i se ZAP-i gëzon pavarësi të plotë në zgjedhjen e punës së tij në lidhje me standardet, metodologjinë dhe procedurën që do të përdoret për të kryer auditimin.

Megjithatë, ekziston një marrëdhënie jozyrtare midis anëtarëve të Komisionit dhe Bordit të Audituesve të Përgjithshëm dhe përfaqësuesve të tjerë nga Zyra. Komisioni dhe Bordi kohë pas kohe organizojnë takime të përbashkëta.

ZAP-i mban kontakte të rregullta me administratën e parlamentit dhe presidencën e parlamentit për çështjet buxhetore dhe ato administrative.

5. Roli i Komisionit Parlamentar në veprimet e IKLSH-së në fusha të tilla si (a) Programi i Auditimit i IKLSH-së, (b) Kërkesa e Komisionit Parlamentar për auditim/hetim nga IKLSH-ë, (c) Tipi i ndihmës që IKLSH-ë u ofron Komisioneve parlamentare, (d) Ndikimi i Komisionit Parlamentar në metodologjinë e auditimit të IKLSH-së

(a) ZAP-i është i lirë të përcaktojë vetë përparësitë dhe planin e tij të punës në përputhje me termat e referencës dhe të zgjedhë metodat e përshtatshme për detyrat që do të kryejë.

(b) Dispozitat ligjore që drejtojnë veprimtarinë e ZAP-it nuk përcaktojnë nëse parlamenti ose komisioni mund të drejtojnë ZAP-in për kryerjen e punës së vet specifike të auditimit, veçanërisht auditimin e performancës. Megjithatë, sipas të drejtës zakonore, vetëm parlamenti në seancë plenare mund të kërkojë të kryhet punë e posaçme audituese. Komisioni nuk shihet të ketë kompetencë ta bëjë këtë gjë. Sot duket se midis politikanëve ekziston një mirëkuptim reciprok për kufizimin e numrit të kërkesave.

(c) Nëse komisioni ka nevojë për më shumë informacion në lidhje me një gjetje specifike të auditimit, në shumicën e rasteve ai i bën një kërkesë ministrisë. ZAP-it i dërgohen zakonisht kopje të korrespondencës midis komisionit dhe ministrive, por nuk ndodh gjithmonë kështu. Kohë pas kohe komisioni i kërkon ZAP-it t'i dërgojë më shumë informacion. Kontakti dhe komunikimi midis komisionit dhe ZAP-it kur ata merren me raportet e auditimit nuk parashikohet nga ndonjë dispozitë ligjore dhe as nuk ndjek ndonjë procedurë të caktuar.

(d) E gjithë puna audituese bazohet në standardet dhe udhëzimet e auditimit të cilat janë miratuar nga Bordi i Audituesve të Përgjithshëm. Komisioni nuk ka fare ndikim në metodologjinë e auditimit të ZAP-it.

6. Funksione të tjera të mundshme të tilla si, (a) Funksioni i IKLSH-së në lidhje me procesin e hartimit të ligjeve, (b) Miratimi i buxhetit vjetor të IKLSH-së, (c) Vlerësimi i punës së IKLSH-së nga komisioni parlamentar, (d) Auditimi i IKLSH-së (dhe tipi i auditimit të kryer), (e) Emërimi ose shkarkimi i kreut të IKLSH-së, miratimi i legjislacionit për IKLSH-në, etj.

(a) ZAP-i nuk ka ndonjë funksion të veçantë në lidhje me procesin e hartimit të ligjeve dhe është tërësisht i pavarur nga pushtetet ekzekutive (nga qeveria dhe administrata të tjera publike). Megjithatë, ZAP-i zakonisht ftohet të komentojë mbi projektligjet nga pushteti ekzekutiv përpara se ato t'i dërgohen parlamentit për miratim përfundimtar.

(b) ZAP-i përgatit një projektbuxhet vjetor dhe këtë ia kalon drejtpërdrejt kryesisë së parlamentit. Kryesia përgatit propozimin e buxhetit bashkë me buxhetin për vetë parlamentin për miratim në një seancë plenare të parlamentit. Zakonisht, kryesia e parlamentit nuk ka ndonjë kompetencë të modifikojë projektbuxhetin e ZAP-it. Megjithatë, kryesia e ka kompetencën ta bëjë këtë gjë dhe gjatë përgatitjes së propozimit të buxhetit për në parlament, Kryetari i Bordit të Audituesve të Përgjithshëm duhet të shprehet mbi projektbuxhetin në një takim me kryesinë. Miratimi përfundimtar kryhet pa shkurtime ose pakësime.

(c) Komisioni ose parlamenti nuk e vlerëson në mënyrë të posaçme punën e ZAP-it. Megjithatë, komisioni bën shpesh komente për punën e tij bashkë me rekomandime për parlamentin në raportin vjetor të ZAP-it për veprimtarinë e tij.

(d) Llogaritë e ZAP-it auditohen nga një Kontabilist Publik i Autorizuar i Shtetit, i cili emërohet nga kryesia e parlamentit si auditues (për auditim financiar). Raporti i auditimit i dorëzohet parlamentit bashkë me dokumentin financiar të ZAP-it të miratuar nga Audituesit e Përgjithshëm.

(e) Audituesit e Përgjithshëm zgjidhen për një periudhë katërvjeçare dhe përbëjnë Bordin e Audituesve të Përgjithshëm. Posti i anëtarit të bordit konsiderohet si pozicion besimi dhe anëtarët nuk mund të shkarkohen gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e ZAP-it nuk është në ndryshim. ZAP-i vetë ka përgatitur legjislacion të ri dhe drafti i tij i është dërguar parlamentit në janar të këtij viti. Drafti tani ndodhet në procesin e një seance dëgjimi me persona të jashtëm brenda pushteteve ekzekutive (ministrive). Parlamenti ndoshta do ta shqyrtojë këtë draft nga fundi i këtij viti.

Një çështje e rëndësishme që duhet të trajtohet në legjislacionin e ri është statusi i pavarur i ZAP-it (pavarësia nga qeveria dhe nga parlamenti). Për shembull, shihet si një gjë e rëndësishme që ZAP-i të vendosë vetë se cilat auditime të përfshijë në programin e saj të punës. Nga ana tjetër, ZAP-i do të vazhdojë të synojë të ketë një marrëdhënie dhe dialog të ngushtë me parlamentin dhe Komisionin e Përhershëm mbi Inspektimin dhe Çështjet Kushtetuese. Kështu që edhe nëse parlamenti ose Komisioni nuk bëjnë kërkesa zyrtare, kërkesat e tipit jozyrtar do të merren parasysh në momentin që ZAP-i përgatit planin e vet të auditimit.

Sipas këtij drafti, vetëm parlamenti në seanca plenare do ta ketë kompetencë t'i japë udhëzime ZAP-it në për të bërë hetime të veçanta audituese. Ka rëndësi të madhe që e gjithë puna e auditimit të bazohet në vlerësimin e rrezikut dhe të materialitetit. ZAP-i vë në dispozicion të kësaj një sasi të madhe burimesh dhe në këtë kuadër, ai duhet të vendosë si t'i alokojë detyrat e ndryshme që kryen. Nevoja që parlamenti t'i japë udhëzime të tilla ZAP-it ndoshta duhet të mendohet përkundrejt nevojës së ZAP-it për të planifikuar dhe përcaktuar përparësi financiare dhe njerëzore të nevojshme për detyrimet dhe përgjegjësitë e veta ligjore.

ANEKSI 9: MARRËDHËNIET E GJYKATËS SË LLOGARIVE TË PORTUGALISË DHE KOMISIONEVE PARLAMENTARE¹²

Marrëdhëniet kryesore midis Gjykatës së Llogarive (Tribunal de Contas) dhe parlamentit trajtohen në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave. Megjithëse nuk ekzistojnë rregulla ose norma për të siguruar karakterin apolitik të komisioneve parlamentare, Gjykata në bazë të kushteve të Nenit 7 të Ligjit Nr. 98/97 është e pavarur, ka vetëqeverisje dhe është e përgjegjësia, anëtarët e saj nuk mund të shkarkohen dhe zbatojnë vetëm ligjin.

Sipas Kushtetutës së Republikës, parlamenti vetëm mund të pranojë Llogaritë e Përgjithshme të Shtetit përmes Gjykatës së Audituesve. Në realitet, megjithëse është një akt në thelb konsultativ, Mendimi i Gjykatës së Llogarive (Tribunal de Contas) është një instrument i rëndësishëm për analizën e kontabilitetit të shtetit. Gjykata vlerëson veprimtarinë financiar përkatëse që kulmon në marrjen e një vendimi mbi rregullsinë dhe ligjshmërinë e zbatimit të buxhetit. Ajo vlerëson gjithashtu edhe ekonominë, eficientë dhe efektivitetin e menaxhimit të kryer dhe besueshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Gjykata i jep parlamentit ndihmë teknike brenda fushës së vet të veprimit.

Po ashtu, marrëdhënia bashkëpunuese që vendoset midis këtyre dy organeve bazohet në pikën 2 të Nenit 36 të Ligjit Nr.8/97, i cili sanksionon mundësinë që Gjykata të njoftojë parlamentin për informacionin që ka grumbulluar, qoftë gjatë zbatimit të buxhetit ose deri në momentin e publikimit të *Llogarive të Përgjithshme të Shtetit*.

Për më tepër, në kuadër të përdorimit të Buxhetit të Shtetit, dhe me objektivin e rritjes së marrëdhënieve të ngushta me parlamentin, përfituesi kryesor i veprimtarisë së Gjykatës, Ligji parashikon se parlamenti mund të kërkojë që Gjykata “të dorëzojë raporte të ndërmjetme për rezultatet e kontrollit të buxhetit gjatë të gjithë vitit si edhe çdo sqarim të nevojshëm për vlerësimin e buxhetit të shtetit dhe raport mbi Llogaritë e Përgjithshme të Shtetit”, ose edhe më tej, “Gjykata të njoftojë parlamentin për informacione, raporte ose mendime që kanë lidhje me funksionet e kontrollit financiar respektiv”.

Përveç fushës strikte të përdorimi korrekt të buxhetit, parlamenti mund të kërkojë gjithashtu që Gjykata të kryejë auditime të aktivitetit të kryer nga secili nga entet publike ose private që janë në kompetencë të kontrollit të saj.

Të paktën, Parlamenti mund t’i kërkojë Gjykatës së Llogarive t’i japë informacion, raporte ose mendime për detyrat përkatëse të kontrollit financiar, sidomos për praninë e kryetarit ose të relatuesve të saj në seancat e komisioneve parlamentare ose të bashkëpunëtorëve teknikë të stafit nga shërbimet mbështetëse, siç e përcakton pika 4 e Nenit 11 të Ligjit Nr. 98/97.

Po ashtu, po aq e rëndësishme është pjesëmarrja e Gjykatës së Llogarive (Tribunal de Contas) në hartimin e projekteve legislative të natyrës financiare me kërkesën e parlamentit për mendime dhe këshilla.

Komisionet parlamentare nuk kanë ndikim në Programin e Auditimit dhe në metodologjinë e auditimit të Gjykatës.

Parlamenti miraton një pjesë të legjislacionit që ka të bëjë me Gjykatën e Llogarive (Tribunal de Contas) si edhe buxhetin vjetor (burimin e buxhetit të shtetit)

Raporti vjetor i Gjykatës për aktivitetet si edhe çertifikimi i llogarive të Gjykatës së Llogarive (Tribunal de Contas) prezantohen në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave - vetëm për informacion. Komisionet parlamentare nuk kanë kompetencë të vlerësojnë punën e Gjykatës.

Emërimi ose shkarkimi i Kryetarit të Gjykatës bëhet nga Presidenti i Republikës me propozim të qeverisë.

(Për më shumë informacion, shih *Gjykata e Auditimit Sot* në faqen e internetit : www.tcontas.pt (version në anglisht)

¹² Raport i marrë më 2 maj 2001 nga Gjykata e Auditimit të Portugalisë.

1. Origjina e Komisionit të Llogarive Publike (KLLP)

- Komisioni i Llogarive Publike (KLLP) për herë të parë u krijua në vitin 1861 me një mocion të William Gladstone, në atë kohë Kancelar i Ministrisë së Financave. Kjo erdhi pas një raporti nga Komisioni i Zgjedhur për Paratë Publike në vitin 1857, i cili rekomandoi që llogaritë që krahasonin shpenzimet me paratë që kishte votuar parlamenti të bëheshin për të gjitha ministrinë e qeverisë dhe të dorëzoheshin çdo vit në një komision të Dhomës së Komuneve.
- Krijimi i KLLP-së u pasua pesë vjet më vonë nga Ligji për Ministrinë e Financave dhe të Auditimit i vitit 1866, i cili u kërkonte të gjitha ministrive qeveritare të nxirrnin llogaritë për auditime të pavarura. Ligji krijonte gjithashtu postin e Kontrollorit dhe të Audituesit të Përgjithshëm duke kombinuar funksionet e Kontrollorit të fondeve me ato të Komisionerëve të Auditimit.
- Sipas përcaktimeve të Ligjit të vitit 1866, Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm autorizonte dhënien e parave ministrive, shqyrtonte çdo shumë të dhënë dhe ia raportonte rezultatet e shqyrtimeve të tij KLLP-së. Pastaj KLLP-ë ia raportonte përfundimet e veta Dhomës së Komuneve.

2. Funksionimi i Komisionit të Llogarive Publike (KLLP)

- Komisioni i Llogarive Publike (KLLP) vepron në bazë të Urdhrit të Përhershëm 148 të Dhomës së Komuneve. Ky është një grup shumëpartiak, jomilitant prej 15 deputetësh, që përfshin Sekretarin Financiar të Thesarit. Komisioni nuk e ngarkon veten të merret me politikën. Qëllimi i tij është të shqyrtojë nëse paraja e votuar në parlament është shpenzuar apo jo sipas vullnetit të parlamentit. Anëtarët e tij zgjidhen nga Komisioni Përzgjedhës në përputhje me përfaqësimin e partisë në Dhomën e Komuneve. Me marrëveshje, Kryetari i KLLP-së ka qenë gjithmonë një anëtar i lartë i opozitës zyrtare dhe është zakonisht një ishministër. Kryetari aktual është Rt. Hon David Davis, deputet dhe ishministër i shtetit për punët e jashtme.
- Kompetencat e Komisionit shtrihen në të gjitha ministrinë qendrore qeveritare, agjencitë ekzekutive, dhe organet publike ekzekutive që nuk janë ministri. Komisioni mbulon gjithashtu edhe Shërbimin Kombëtar të Shëndetit, institucionet e larta arsimore dhe rreth 1700 organe të tjera që marrin grante nga ministrinë qeveritare. Shpenzimet dhe të ardhurat e përgjithshme brenda fushës së kompetencave të Komisionit i tejkalojnë 600 miliard paund në vit.
- Marrëdhënia e KLLP-së me K&AP-ë është themelore për punën e Komisionit. Hetimet e KLLP-së bazohen në llogaritë, në raportet dhe në memorandumet që i prezantohen parlamentit dhe komisionit nga K&AP-ë, i cili është edhe kreu i Zyrës së Auditimit të Shtetit (ZASH). K&AP-ë është autoriteti auditues i jashtëm i të gjitha ministrive dhe agjencive qeveritare dhe e një numri të gjerë organesh të tjera publike. Sipas Ligjit të Auditimit Kombëtar të vitit 1983, ai ka kompetencën t'i raportojë parlamentit për ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin me të cilin këto organe i kanë përdorur burimet e tyre.
- Kjo çon në një marrëdhënie të ngushtë midis KLLP-së dhe K&AP-së. K&AP-ë dhe KLLP-ë takohen rregullisht për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët, dhe K&AP-ë dhe Komisioni kryejnë takime të planifikuara për të diskutuar për punën që pritet të bëhet në të ardhmen.

3. Punonjësit e kontabilitetit

- Sistemi i punonjësve kontabilistë është një tipar tjetër kyç i punës së KLLP-së. Ministria e Financave cakton një "punonjës kontabilist" për çdo votim parlamentar dhe për çdo agjenci ekzekutive dhe organ publik që nuk është ministri. Punonjësi kontabilist është zakonisht sekretari i përhershëm i një ministrie ose i përgjegjësi ekzekutiv i një agjencie ekzekutive ose i një organi publik që nuk është

¹³

Raport i marrë më 4 maj 2001 nga Zyra e Auditimit të Shtetit e Mbretërisë së Bashkuar.

ministri. Një punonjës kontabilist ka përgjegjësinë personale të sigurojë menaxhimin e duhur financiar brenda organizatës së tij dhe të japë llogari para KLLP-së për menaxhimin që u bën fondeve publike.

4. Seancat dëgjimore të KLLP-së

- Nëse Komisioni vendos të dëgjojë fakte mbi bazën e një raporti të K&AP-së, anëtarët e komisionit do t'i kërkojnë punonjësit përkatës kontabilist të japë faktet. Kontabilisti inspektohet së bashku me Punonjësën e Llogarive të Ministrisë së Financave, një punonjës i lartë i Thesarit, i cili përgjigjet në emër të qeverisë për çështje më të përgjithshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e fondeve publike të cilat nuk janë kompetencë e punonjësit të kontabilitetit. K&AP-ë gëzon statusin e një dëshmitari të përhershëm para KLLP-së dhe zëvendësi i tij/saj ndjek të gjitha seancat dëgjimore.
- Megjithëse KLLP-ë e pranon që punonjësit e kontabilitetit t'i kenë deleguar shumë nga përgjegjësitë e tyre, kjo nuk i çliron ata nga detyra e dhënies së llogarisë para Komisionit dhe parlamentit për të gjitha fushat e shpenzimeve për të cilat ata janë përgjegjës.
- Seancat e Komisionit zakonisht janë publike dhe mund të regjistrohen për transmetim televiziv ose radiofonik. Në të gjitha rastet mbahet procesverbal mbi të dhënat e prezantuara dhe ky në fund bëhet publik si një dokument i Dhomës së Komuneve.

5. Raportet e KLLP-së

- Pas një seance me të dhëna, dhe me marrjen në konsideratë të ndonjë të dhëne tjetër të përgatitur me kërkesë të Komisionit gjatë seancës dëgjimore, Komisioni mblidhet për të diskutuar një projekt raport të kryetarit. Raporti eventual do të përmbajë një numër gjetjesh dhe rekomandimesh dhe do të përfshijë procesverbalin e të dhënave të dala gjatë seancës dëgjimore.
- Kur bën rekomandimet e veta, Komisioni përpiqet të zhvillojë ekspertizë në fusha të veçanta dhe të përhapë praktikat e mira. Për shembull, raporti i Komisionit "*Marrja e vlerës së parasë në privatizimet*" (*Getting Value for Money in Privatisations*) solli së bashku gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga mbi 35 privatizime të shqyrtuara nga Komisioni.
- Rekomandimet e KLLP-së priren të jenë të orientuara nga e ardhmja për të siguruar që mësimet për të ardhmen janë nxjerrë. Vitet e fundit, Komisioni ka ndihmuar në zhvillimin e teknikave novatore të menaxhimit publik të tilla si matja e performancës dhe kontabiliteti i burimeve.
- Dhoma e Komuneve një herë në vit ka shansin të debatojë për raportet që ka hartuar Komisioni përgjatë vitit. Me marrëveshje, Kryetari i Komisionit prezanton debatin dhe përmbledh disa nga raportet e publikuara nga Komisioni përgjatë 12 muajve të fundit. Ministri i Financave, një ministër i qeverisë, përgjigjet në debat. Ky debat plotëson rrethin e llogaridhënies, i cili fillon me miratimin nga parlamenti të buxheteve të ministrive ose të vlerësimeve të përafërta të tyre.

6. Procesverbali i Ministrisë së Financave

- Me anë të një marrëveshjeje afatgjatë, pritët që qeveria t'i përgjigjet një raporti të KLLP-së brenda dy muajve. Përgjigjet njihen si "Procesverbalet e Ministrisë së Financave" dhe pasqyrojnë faktin që ato janë koordinuar nga Ministria e Financave, e cila reagon ndaj çdo rekomandimi që prek të gjithë qeverinë.
- Mbi 90% e rekomandimeve të Komisionit pranohen çdo vit dhe gjatë tre viteve të fundit puna e ZASH-it dhe e KLLP-së ka çuar në kursimin e mbi 1.3 miliard paundëve, që i bie mesatarisht 427 milion paundësh në vit.

ANEKSI 11: DOKUMENT I SHKURTËR I SIGMA-s PËR PERSONAT E KONTAKTIT TË GRUPIT TË PUNËS PËR MARRËDHËNIET MIDIS INSTITUCIONEVE TË KONTROLLIT TË LARTË DHE PARLAMENTIT (ME FOKUS TË VEÇANTË NË RASTET NGA SHBA DHE AUSTRALIA)

1. Panoramë e përgjithshme

Një Institucion i Kontrollit të Lartë (IKLSH) është një element përbërës në strukturën e qeverisë, misioni i të cilit është të ndihmojë që sektori publik të jetë i përgjegjshëm dhe të përdorë ndikimin e tij për të forcuar integritetin e shërbimit civil si edhe të përmirësojë ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të tij. Megjithatë, arritja e këtyre qëllimeve kërkon që IKLSH-ë të mbajë një ekuilibër delikat.

Nga njëra anë, IKLSH-ë duhet të jetë e pavarur nga institucionet e tjera të qeverisë sepse kjo pavarësi, bashkë me kompetencën dhe integritetin e stafit të saj, janë bazat kryesore për besueshmërinë e IKLSH-së dhe, në këtë mënyrë, edhe të ndikimit të saj. Nga ana tjetër, IKLSH-ë nuk duhet të jetë kaq e distancuar nga institucionet e qeverisë sa që të injorohet me lehtësi nga ata që kanë kompetencë për të zbatuar konkluzionet dhe rekomandimet e saj. Ky ekuilibër është veçanërisht i ndjeshëm në marrëdhënien e IKLSH-së me parlamentin, i cili në shumicën e demokracive, është një rrugë thelbësore për zbatimin e rekomandimeve të IKLSH-së. Ky është edhe objekti i këtij dokumenti.

Në vende të ndryshme IKLSH-të arrijnë ta krijojnë dhe ta mbajnë këtë ekuilibër të çmuar në mënyra të ndryshme. IKLSH-të e Australisë dhe të SHBA-së funksionojnë në shumë mjedise të ndryshme qeveritare dhe lidhjet e tyre me organet e tyre përkatëse legislative kanë marrë forma krejt të ndryshme. Megjithatë, çdonjëra nga këto ka formuar dhe ruajtur përgjatë shumë viteve të dyja, edhe kanalet e komunikimit që janë themelore për efektivitetin, edhe pavarësinë që është baza themelore për besueshmërinë.

2. Australia

Hyrje: IKLSH-ë e Australisë është Zyra e Auditimit të Shtetit e Australisë (ZASHA) dhe ka një staf prej rreth 270 punonjës. Ajo drejtohet nga Audituesi i Përgjithshëm i Australisë (AP), i cili është me ligj një punonjës i pavarur i Parlamentit Australian të Komonuellthit. Audituesi i Përgjithshëm emërohet nga Guvernatori i Përgjithshëm i Australisë, por vetëm me miratimin e Komisionit të Përbashkët të Parlamentit për Llogaritë Publike dhe Auditimin (KPLPPA).

AP-ë ka një mandat për një periudhë të caktuar prej dhjetë vjetësh dhe mund të mos rrimërohet. Ai/ajo mund të shkarkohet nga detyra vetëm me kalimin e një rezolute për shkarkim (për shkaqe të sjelljes së papërshtatshme ose të paaftësisë fizike a mendore), e cila duhet të miratohet edhe nga Dhoma e Përfaqësuesve, edhe nga Senati.

Ligji që krijon detyrën e Audituesit të Përgjithshëm specifikon se AP-ë:

Ka liri të plotë në performancën ose ushtrimin e funksioneve ose të kompetencave të tij/saj. Në veçanti, AP-ë nuk i nënshtrohet drejtimit nga askush për sa i përket:

- (a) Kryerjes apo jo të një auditimi të caktuar.
- (b) Mënyrës me të cilën duhet të kryhet një auditim i caktuar.
- (c) Përparësisë që i duhet dhënë ndonjë çështjeje të veçantë.

Ky ligj dhe ligje të tjera si ky ofrojnë bazën për një shkallë të lartë pavarësie për AP-në dhe, rrjedhimisht edhe për ZASH-in e Australisë.

Mjedisi qeveritar: Komonuellthi i Australisë ka një strukturë federale, të përbërë nga gjashtë shtete dhe dy territore. Formimi i qeverisë kombëtare (federale) buron nga modeli britanik (Westminster), por ka disa ndryshime të rëndësishme. Kryetari i Shtetit është Guvernatori i Përgjithshëm dhe përfaqëson nominalisht Mbretëreshën e Anglisë. Megjithatë, roli i Guvernatorit të Përgjithshëm është kryesisht ceremonial dhe të gjitha kompetencat e tij janë të kufizuara ndjeshëm. Për shembull, teorikisht ai/ajo ka në dorë të shpërndajë parlamentin. Megjithatë, në realitet kjo mund të bëhet vetëm me kërkesë të qeverisë.

Parlamenti i Komonuellthit përbëhet nga dy organe, Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati. Dhoma ka 148 anëtarë që përfaqësojnë ndarjet elektorale me një numër afërsisht të barabartë zgjedhësish. (Për shkak të ndryshimeve të mëdha në dendësinë e popullsisë të Australisë, ndarjet elektorale ndryshojnë shumë gjeografikisht). E gjithë Dhoma duhet të dalë në zgjedhje çdo tre vjet, por zgjedhjet shpesh mbahen pa u mbushur tre vjet dhe këtë e ka në dorë qeveria.

Senatorët janë 76, nga 12 prej secilit prej gjashtë shteteve dhe dy nga Territori i Kryeqytetit Australian (rrethinat e Kanberrës) dhe dy nga Territori Verior. Senatorët që përfaqësojnë shtetet shërbejnë në afate kohore prej gjashtë vjetësh, dhe gjysma e tyre shkojnë në zgjedhje çdo tre vjet. Senatorët që përfaqësojnë dy territoret kanë të njëjtat afate të kohës së shërbimit si edhe anëtarët e Dhomës, tre vjet ose më pak, në varësi të kohëzgjatjes së Dhomës. Senatorët zgjidhen duke përdorur sistemin e përfaqësimit proporcional. Ky sistem përpiket të shpërblejë kandidatët nga partitë e vogla, disa prej të cilave janë të përfaqësuara në Senat.

Qeveria e kryesuar nga Kryeministri, ndërtohet nga partia ose koalicioni që ka shumicën në Dhomë. Shpesh ndodh që qeveria përballet me Senatin ku shumicën e përbën partia ose koalicioni i opozitës. Ministrat e qeverisë mund të jenë anëtarë ose të Dhomës së Përfaqësuesve, ose të Senatis. Qeveria nuk e ka të garantuar shumicën në Senat.

Që një ligj të dekretohet duhet që ai të miratohet edhe nga Dhoma, edhe nga Senati. Një projektligj (e quajtur "bill") mund të propozohet nga çdo anëtar i secilit organ. Megjithatë, shumica e tyre hartohen nga Dhoma dhe prezantohen nga qeveria. Senati duket se sheh si rolin e vet kryesor jo atë të ligjberësit, por të rishikuesit të legjislacionit që miratohet nga Dhoma dhe të analizuesit të veprimtarive të qeverisë.

Shumica e mosmarrëveshjeve për çështje legjislativ midis Dhomës dhe Senatis zgjidhen me kompromis. Megjithatë, në rastin e ndryshimeve kontradiktore për ndonjë çështje madhore - siç është rasti kur Senati refuzon dy herë të kalojë një projektligj të cilin Dhoma e ka kaluar dy herë, pas një intervali prej tre muajsh-qeveria mund të shpërndajë si Dhomën ashtu edhe Senatin dhe të çojë vendin në zgjedhje të reja për të dy organet. Kjo ngjarje, të cilën quhet "shpërndarje e dyfishtë" gjatë shekullit të 20-të ka ndodhur gjashtë herë dhe hera e fundit e saj ka qenë viti 1987. Megjithëse kjo është përdorur rrallë, ky proces ndoshta krijon një stimul të dobishëm (i cili nuk është prezent, për shembull, në sistemin dydhomësh të SHBA-së) për të zgjidhur mospajtimet nëpërmjet kompromisit.

Parlamenti i Komonuellthit lidhet me ZASH-in e Australisë kryesisht përmes Komisionit të Përbashkët për Llogaritë Publike dhe Auditimin (KPLLLPA). Ky komision ka 16 anëtarë, dhjetë prej të cilëve caktohen nga Dhoma dhe gjashtë nga Senati. Kryetari dhe shumica e anëtarëve janë nga partia në qeverisje. Nën kryetari është gjithmonë nga partia e opozitës. KPLLLPA ka një staf profesional (sekretariat) i cili plotësohet me të dërguarit e ZASH-it të Australisë, me vëzhguesit nga ZASH-i i Australisë dhe nga Ministria e Financës si edhe me konsulentët.

Roli i vetëpërcaktuar i KPLLLPA (themeluar për herë të parë në vitin 1913) është të inspektojë performancën e agjencive të Komonuellthit për shpenzimin e fondeve të dhëna nga parlamenti. Në këtë rol, ajo merr dhe shqyrton të gjitha raportet e AP-së që janë dërguar në parlament. Detyrat statutorë të Komisionit përfshijnë edhe një gamë tjetër çështjesh specifike që lidhen me llogaritë publike. Megjithatë, përveç kësaj, KPLLLPA ka kompetenca të gjera për të shqyrtuar dhe raportuar për çdo rrethanë që lidhet me raportet e AP-së ose me llogaritë a dokumentet financiare të Komonuellthit. Këto kompetenca të gjera i japin KPLLLPA-së shumë liri për duke e lejuar kështu atë të ndërmarrë hetimet e veta, dhe në një shkallë të madhe, për të përcaktuar vetë përparësitë e saj. Në këtë mënyrë, KPLLLPA nuk kufizohet vetëm në shqyrtimin e çështjeve të sjella në vëmendjen e saj nga ZASH-i i Australisë. Për më tepër, ajo mund - dhe edhe e bën këtë gjë - të fillojë hetime për çështje të tjera të cilat tërheqin vëmendjen e saj.

Ndër detyrat e tjera që kryen, KPLLLPA analizon propozimet për buxhetin vjetor të ZASH-it të Australisë dhe jep rekomandimet e saj për t'u përfshirë në buxhetin e përgjithshëm të qeverisë. Qeverisë nuk i kërkohet të miratojë rekomandimet e KPLLLPA-së. Megjithatë, për shkak të staturës së KPLLLPA-së dhe të profilit të lartë të AP-së dhe të ZASH-it të Australisë, shmangia e madhe e këtyre rekomandimeve ka të ngjarë të tërheqë vëmendjen e parlamentarëve.

Fillimi i auditimeve: ZASH-i i Australisë kryen një numër të gjerë auditimesh, përfshirë auditimet e dokumenteve financiare (verifikimet) dhe auditimet e performancës të cilat vlerësojnë ekonominë, eficientësinë dhe efektivitetin e menaxhimit të sektorit publik. Një produkt tjetër i rëndësishëm i ZASH-it të Australisë janë Udhëzues me Praktikë më të Mira, të cilat synojnë të sigurojnë një përhapje të gjerë të praktikave të mira të

menaxhimit që kryhen në organizata të caktuara. Këto Udhëzues hartohen zakonisht mbi bazën e informacionit të grumbulluar gjatë procesit të auditimit.

Siç u vu në dukje më sipër, ligji i jep AP-së një pavarësi të plotë në përcaktimin e programit të auditimit të ZASH-it të Australisë: në zgjedhjen e subjekteve të auditimit¹⁴, në sigurimin e stafit dhe në hartimin e planit të auditimit. Mbrojtja statutorë në këtë këndvështrim nuk mund të ishte më shumë e qartë se ç'është. Nëse Audituesi i Përgjithshëm vendos se është e nevojshme ose e dëshirueshme të auditojë deklaratimet financiare ose performancën e një agjencie të Komonuellthit, ai e ka plotësisht autoritetin ta bëjë këtë gjë. Po ashtu, ai mund të heqë dorë nga kryerja e një auditimi nëse mendon se stafi i ZASH-it të Australisë mund të përdoret më mirë për të kryer punë të tjera. Askush nuk ka autoritet ta urdhërojë atë veprorë ndryshe. Por do të ishte naive të mendohej se AP-ë i merr këto vendime duke e injoruar mjedisin institucional në të cilin ai vepron. AP-ë është një nëpunës (i pavarur) i parlamentit. Marrëdhëniet e tij dhe të stafit të ZASH-it të Australisë me parlamentin dhe veçanërisht me JCPAA, janë shumë të gjera. Është e pashmangshme që AP të mos i njohë nevojat dhe interesat e parlamentit dhe të mos i marrë parasysh ato kur përcakton përparësitë e ZASH-it të Australisë.

Çështjet e auditimit të performancës zgjidhen sipas dy kritereve: së pari, përqendrimi në ato auditime që pritet të kenë një dobi më të madhe për përmirësimin e përgjegjshmërisë, ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit administrativ dhe, së dyti, siguri i mbulimit të përshtatshëm të operacioneve të enteve brenda kufizimeve të burimeve në dispozicion. Pikëpamjet e KPLIPA-së dhe të enteve të tjera të parlamentit dhe të sektorit publik kërkojnë në momentin kur planifikohen auditimet. Sugjerimet nga anëtarë të veçantë të parlamentit dhe senatorë janë të mirëpritura, por si rregull, ato duhet të kalojnë për mendim më parë në KPLIPA. Në raste të veçanta, ZASH-i i Australisë merr kërkesa për të kryer auditime specifike drejtpërdrejt nga ministrat, përfshirë këtu edhe Kryeministrin dhe nga deputetë të tjerë, përfshirë edhe anëtarë të opozitës. Këto kërkesa dhe sugjerime mendohen seriozisht gjatë procesit të planifikimit të ZASH-it të Australisë dhe mund të miratohen nëse AP i sheh të arsyeshme.

Kjo nuk do të thotë se ZASH-i i Australisë i nënshtrohet një procesi kërkesash për auditime të krahasueshëm në ndonjë farë mënyre me atë që bën Zyra e Llogarive të Përgjithshme e SHBA-së (USGAO) kur merret me Kongresin e SHBA-së (do të trajtohet më tej në këtë dokument). Por, siç është e vërtetë edhe me shumicën e IKLSH-ve të tjera, ZASH-i i Australisë është e ndjeshme ndaj nevojave të parlamentit të Komonuellthit dhe përpiket t'u shërbejë këtyre nevojave sa më shumë që të jetë e mundur, pa harruar edhe përgjegjësitë e saj të tjera.

Kryerja e auditimeve: Realizimi aktual i një auditimi është tërësisht nën kontrollin dhe përgjegjësinë e ZASH-it të Australisë dhe të stafit të vet profesional. Ata hartojnë planin e auditimit në përputhje me objektivat dhe fushën e miratuar nga AP. Fusha e auditimit sigurohet që mund të përshtatet ose të zgjerohet, nëse konsiderohet e nevojshme për shkak të çështjeve që dalin në procesin e auditimit. Të gjitha auditimet duhet të jenë në përputhje me standardet e auditimit të përcaktuara nga AP. Kryerja e një auditimi udhëhiqet nga manuali e auditimit të përgatitura nga ZASH-i i Australisë, manuale që ndër të tjera përcaktojnë masa procedurale dhe masa të tjera mbrojtëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në arritjen e rezultateve të auditimit. Gjatë kryerjes së auditimeve, ZASH-i i Australisë ka autoritet statutor të kërkojë që enti që auditohet t'i ofrojë akses në shënime dhe dokumentet e tij të tjera. Po ashtu, ZASH-i i Australisë ka kompetencë të kërkojë që përgjigjet e pyetjeve të jepen nën betim, megjithëse kjo procedurë rrallë është e nevojshme.

Përfundimi i auditimit dhe nxjerrja e raportit: Kur ZASH-i i Australisë e përfundon përgatitjen e raportit të propozuar për një auditim, AP-së i kërkohet nga ligji të dorëzojë një kopje në agjencinë ose entin i cili iu nënshtrohet auditimit. Nëse marrësi i raportit jep me shkrim komentet e tij brenda 28 ditëve nga marrja e raportit të hartuar, ZASH-i i Australisë duhet t'i shqyrtojë këto komente përpara se të përgatisë versionin përfundimtar të raportit. Kur AP-ë e ka miratuar raportin përfundimtar ai i dërgohet KPLIPA-së, Ministrisë të Financave, ministrit përgjegjës për entin e audituar dhe agjencisë në fjalë ose ndonjë enti tjetër. Raporti pastaj i bëhet i njohur publikut.

Aktiviteti pas daljes së raportit përfundimtar të ZASH-it të Australisë në qarkullim: Analiza e raporteve nga AP është një nga elementet kryesore në programin e punës të KPLIPA-së (siç u përmend më sipër,

¹⁴ Auditimet e performancës së ndërmarrjeve të biznesit që janë në pronësi të plotë të qeverisë kryhen vetëm me kërkesë të ministrit përgjegjës, të Ministrisë të Financave ose të KPLIPA-së. Ky kufizim nuk zbatohet ndaj auditimit të faturave financiare ose ndaj auditimeve të performancës së enteve të tjera të sektorit publik.

KPLPPA mund të ndërmarrë auditime me iniciativën e vet). Kur KPLPPA e përfundon punën e saj për një çështje, ajo përgatit një raport i cili i dërgohet edhe Dhomës edhe Senatit si edhe të gjitha ministrive ose agjencive të interesuara.

Karakterit i përgjigjes së qeverisë ndaj raportit të KPLPPA-së varet nga përmbajtja e raportit. Nëse raporti merret me çështje administrative, Ministri i Financave i përgjigjet Komisionit me anën e një dokumenti i cili përmban një përgjigje ku janë kombinuar mendimet nga të gjitha agjencitë përkatëse për të cilat KPLPPA ka bërë rekomandime. Zakonisht, ky dokument merret brenda gjashtë muajve pas daljes së raportit të KPLPPA-së. Nëse KPLPPA është e pakënaqur me përgjigjen e dhënë në dokument, atëherë ajo mund të vendosë të rifillojë hetimin e saj.

Nëse një raport i KPLPPA-së bën rekomandime për politikën, reagimi i qeverisë zakonisht përgatitet nga ministri përgjegjës, i cili zakonisht e prezanton përgjigjen e vet në parlament brenda tre muajve. Për një përgjigje të tillë nuk është e pazakonshme të fillojë një debat midis deputetëve.

Përfundim: AP-ë dhe ZASH-i i Australisë kanë krijuar marrëdhënie të ngushta me Parlamentin e Komonuellthit dhe kanë arritur të ruajnë me sukses pavarësinë e tyre të nevojshme. Kjo pavarësi ka një bazë fare të qartë të shprehur në ligj. Është e dukshme se kjo pavarësi e AP-së dhe ZASH-it së Australisë është forcuar nga respekti i fituar nga parlamenti, qeveria dhe publiku i gjerë.

KPLPPA ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin dhe ruajtjen e një marrëdhënieje të mirë. Ajo nuk shërben vetëm si një kanal efektiv përmes të cilit raportet e ZASH-it së Australisë mbërrijnë në parlament, por edhe si një mbrojtës i dobishëm dhe një burim i rëndësishëm mbështetjeje për AP-në dhe ZASH-in e Australisë.

Në kushte të tjera, roli i KPLPPA -së mund të shihet si një kërcënim për pavarësinë e ZASH-it së Australisë. KPLPPA e mbikëqyr ZASH-in e Australisë dhe ka një zë përcaktues në marrjen e vendimit për buxhetin që do i vihet në dispozicion ZASH-it. Për më tepër, KPLPPA kryesohet nga një anëtar i partisë në pushtet dhe ka shumicën e anëtarëve nga kjo parti. Teorikisht, ajo mund t'i përdorë kompetencat e veta për të ushtruar presion të konsiderueshëm mbi ZASH-in e Australisë, duke pasur mundësi ta pengojë atë të kryejë auditime që kundërshtohen nga qeveria ose duke raportuar rezultate të cilat qeveria mund t'i shihet si të padëshirueshme për arsye politike ose arsye të tjera.

Megjithatë, në fakt, për arsye të cilat mund të veprojnë vetëm në Australi, ky kërcënim teorik nuk është materializuar ndonjëherë. Është e qartë se një faktor i dukshëm është forca e KPLPPA-së, tradita e gjatë e mungesës së frymës partiake. Tregues i kësaj është fakti se pothuajse të gjitha raportet e Komisionit përgatiten me mbështetjen unanime të anëtarëve të tij. Një faktor tjetër kyç është sigurisht vlerësimi i lartë që ekziston për AP-në dhe ZASH-in e Australisë. Çdo kërcënim serioz për pavarësinë e tyre, pavarësisht sesa i rafinuar mund të jetë, do të bëhej publik në një kohë shumë të shkurtër, me mundësinë shoqëruese që partia që do të nxishte një sulm të tillë do të merrte mbi kurriz kosto të mëdha politike.

Në këto rrethana, duket e arsyeshme të arrihet në përfundimin se aftësia e AP-së dhe e ZASH-in e Australisë për të ruajtur si një marrëdhënie pune efektive me parlamentin ashtu edhe pavarësinë e nevojshme për të kryer punën e vet, është e garantuar për të ardhmen.

3. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Hyrje: Institucioni i Auditimit të Lartë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është Zyra e Përgjithshme e Llogarive e SHBA-së (ZPLL e SHBA-së), e cila ka një staf prej rreth 3200 personash. Kjo është një agjenci e pavarur e pushtetit legjislativ të qeverisë. Kryetari i ZPLL-së së SHBA-së, Audituesi i Përgjithshëm i SHBA-së (AP), emërohet nga presidenti i SHBA-së nga një listë me kandidatë e cila i vjen nga Kongresi. Lista përgatitet nga një komision i kongresit, i cili përfshin anëtarë nga Senati, nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe nga të dy partitë e mëdha politike. Kur presidenti e ka kryer përzgjedhjen e tij, Senati duhet pastaj të miratojë emërimin e tij.

Audituesi i Përgjithshëm shërben për një periudhë fikse prej 15 vjetësh dhe nuk mund të ketë rrimërim. Ai/ajo mund të shkarkohet nga detyra vetëm me një rezolutë të miratuar edhe nga Senati, edhe nga Dhoma e Përfaqësuesve, një veprim i cili nuk është kryer ndonjëherë. Pas përfundimit të këtij afati, Audituesi i Përgjithshëm del në pension me pagë të plotë dhe nuk mund të emërohet në ndonjë detyrë tjetër në qeverinë e SHBA-së. Të gjitha postet e tjera në ZPLL-në e SHBA-së zihen mbi bazën e konkurrimit të meritës. Këta

punonjës kanë të njëjtin nivel pagash dhe të njëjtën mbrojtje ndaj shkarkimit arbitrar si edhe nëpunësit e tjerë të shërbimit civil të SHBA-së¹⁵.

Këto dhe masa të tjera institucionale sigurojnë që ZPLL-ë e SHBA-së të ketë realisht pavarësi të plotë nga ekzekutivi i qeverisë. Për shembull, buxheti i propozuar i ZPLL-së së SHBA-së duhet të përfshihet pa u ndryshuar në propozimin e presidentit për buxhetin.

Marrëdhëniet midis ZPLL-së së SHBA-së dhe Kongresit janë shumë më pak drejtvizore sa ato me ekzekutivin. Disa aspekte të këtyre marrëdhënieve mund të perceptohen si marrëdhënie që krijojnë kërcënime të mundshme për pavarësinë institucionale të ZPLL-së së SHBA-së, megjithëse për arsye të cilat do të trajtohen më poshtë, kërcënime të tilla nuk janë materializuar ndonjëherë.

Mjedisi qeveritar: Marrëdhëniet e ZPLL-së së SHBA-së me Kongresin kuptohen më mirë si marrëdhënie që burojnë nga kompleksiteti që karakterizon sistemin qeveritar të SHBA-së, në të cilin njëri nga parimet themelore është ndarja ose ushtrimi bashkërisht i pushteteve. Kongresi ka dy dhoma. Senati ka 100 anëtarë, dy për secilin nga 50 shtetet. Dhoma e Përfaqësuesve ka 435 anëtarë, të cilët përfaqësojnë distriktet që përmbajnë afërsisht të njëjtin popullatë. Të gjithë janë të zgjedhur mbi bazën e sasisë më të madhe të votave. Megjithatë, kjo siguron një pluralitet (si në rastin kur janë më shumë se dy kandidatë) më shumë sesa një mazhorancë. Ministrat (të quajtur “sekretarë” në frazeologjinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës) emërohen nga Presidenti, marrin miratimin e Senatit dhe nuk lejohen të jenë në të njëjtën kohë as në Senat e as në Dhomën e Përfaqësuesve.

Projektligjet (të quajtura “bills”, si në Australi) mund të propozohen nga çdo anëtar i Dhomës ose i Senatit. Qeveria nuk ka ndonjë privilegj të posaçëm në këtë drejtim dhe duhet të kërkojë mbështetje nga një anëtar për të propozuar ligjet e saj. Ligjet mund të hyjnë në fuqi vetëm me miratimin e Senatit dhe të Dhomës si dhe me mbështetjen e presidentit. Nëse presidenti e kthen ligjin e propozuar, ai mund të hyjë në fuqi vetëm nëse ai rimiratohet me mazhorancë prej 2/3 të Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit.

Struktura e kompetencave të përbashkëta ndërlikohet edhe më tej për faktin se senatorët dhe përfaqësuesit zgjidhen si individë, ndarazi nga zgjedhja e presidentit. Nuk ka garanci se në Dhomë ose në Senat do të ekzistojë ndonjë shumicë e së njëjtës parti politike nga e cila është presidenti. Vitet e fundit, në fakt, situata më e zakonshme është që presidenti të ketë të bëjë me një Kongres në të cilin ose Dhoma ose Senati (ose edhe të dyja bashkë) kontrollohen nga partia në opozitë.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është se disiplina partiake në Kongresin e SHBA-së është shumë më e dobët sesa në shumicën e demokracive parlamentare. Senatorët dhe Përfaqësuesit zgjidhen si individë nga një zonë zgjedhore specifike gjeografike dhe votuesit presin, ndër të tjera, që ata të mbështesin interesat e njësive të tyre zgjedhore. Kështu, për çështje që kanë efekt të rëndësishëm tek anëtarët e një zone zgjedhore (ose tek një a më shumë grupe të rëndësishëm në atë zonë zgjedhore), nuk është e pazakontë për anëtarin të mbrojë ato interesa sesa të votojnë automatikisht për qëndrimin e mbështetur nga drejtuesit e partisë politike ku bën pjesë ai anëtar.

Për më tepër, dy partitë kryesore politike të SHBA-së janë të ndikuara më pak ideologjikisht sesa partitë në shumicën e demokracive perëndimore. Në përgjithësi, partia republikane është disi në të djathtë të demokratëve. Megjithatë, ekziston një mbivendosje e madhe në qendër, ku disa republikanë pozicionohen në të majtë të disa demokratëve. Për këtë arsye ndodh që anëtarët t’u largohen udhëheqësve të tyre partiakë si për motive ideologjike ashtu edhe për të mbrojtur interesat e zonave të tyre zgjedhore.

Nuk është çështja vetëm te dobësia e disiplinës partiake. Edhe pushteti është i fragmentuar organizativisht brenda Kongresit. Komisionet e shumta të përhershme të Dhomës dhe të Senatit (dhe kryetarët e këtyre komisioneve) janë shumë më të fuqishëm në krahasim me udhëheqësinë e përgjithshme të të dy organeve sesa në shumicën e demokracive parlamentare. Për shembull, kryetari i komisionit ka një kontroll të madh mbi kohën dhe përmbajtjen e legjislacionit të propozuar për t’u marrë në shqyrtim nga Senati ose Dhoma. Ajo që ka më shumë rëndësi në marrëdhëniet e ZPLL-së së SHBA-së me Kongresin është se këta Kryetarë kontrollojnë kryesisht edhe programin e mbikëqyrjes së kongresit për agjencitë e pushtetit ekzekutiv dhe veprimtarinë nën juridiksionin e tyre. Ata luajnë rol kryesor në vendimet që merren se me cilat çështje do të merret Kongresi, cilat probleme do të trajtojnë ai dhe se cilat masa korrigjuese do të shqyrtojnë ai.

¹⁵

Ligji me të cilin është themeluar ZPLL-së e SHBA-së parashikon edhe postin e Zëvendësit të AP-së, i cili të zihet në të njëjtën mënyrë si edhe ai i AP-së, por posti ka qenë vakant prej shumë vitesh. Aktualisht, Nëpunësi më i Lartë Veprues, zyrtari i dytë në rang në ZPLL-në e SHBA-së, është një nëpunës civil karriere i emëruar nga AP-ë.

Marrëdhëniet e ZPLL-së së SHBA-së me Kongresin e pasqyrojnë këtë strukturë të fragmentuar. Tregues i kësaj është fakti se në SHBA nuk ka një strukturë homologe të Komisionit të Llogarive Publike (KLLP) që gjendet në shumicën e demokracive parlamentare. Struktura më e përafërt me këtë është Komisioni i Çështjeve Qeveritare në Senat dhe Komisioni mbi Reformën Qeveritare në Dhomë. Këto dy komisione kanë përgjegjësi të mbikëqyrin ZPLL-në e SHBA-së (si edhe një numër të madh subjektësh të tjera) dhe të marrin një pjesë disproporcionale të raporteve të saj të auditimit. Megjithatë, këto komisione nuk kanë kompetenca të posaçme dhe rëndësi të veçantë krahasuar me komisionet e tjera të përhershme. Madje edhe përgjegjësia për mbikëqyrjen e ZPLL-së së SHBA-së ndahet me Komisionet e buxheteve të Dhomës dhe të Senatit, të cilat kontrollojnë në një masë të madhe buxhetin e ZPK-së së SHBA-së dhe ndryshojnë në mënyrë rutinore sasinë e propozuar¹⁶.

Duke pasqyruar fragmentimin e pushtetit në Kongres, ZPLL-ë e SHBA-së duhet të jetë e përgatitur të punojë me çdo lloj komisioni të Dhomës apo të Senatit. Ai raporton në mënyrë rutinore, të paktën herë pas here, tek të gjithë komisionet e tjera.

Fillimi i auditimeve: Sipas ligjit, çdo anëtar i Dhomës ose i Senatit mund të kërkojë që ZPK e SHBA-së të ndërmarrë një auditim të caktuar¹⁷. Përveç kësaj, ZPLL-ë e SHBA-së mund të ndërmarrë auditime me iniciativën e vet, me miratim të AP-së¹⁸.

Në realitet, auditimet mund të propozohen në çdonjërin nga mënyrat e mëposhtme:

- Njëpërmjet një mandati nga Kongresi si i tërë, ose nga Senati ose nga Dhoma veçmas, bazuar në një ligj ose në ndonjë rezolutë.
- Njëpërmjet një letre për AP-në drejtuar nga drejtuesit ose të Dhomës, ose të Senatit (Kryetari i Dhomës ose drejtuesi i Shumicës ose i Pakicës i Dhomës ose i Senatit).
- Njëpërmjet një kërkesë nga Kryetari ose anëtari më i lartë i komisionit nga partia në pakicë i një komisioni të Dhomës ose të Senatit, në formën e një letre për AP-në ose në formën e udhëzimeve në një raport komisioni.
- Njëpërmjet një letre për AP-në nga një anëtar i veçantë.
- Njëpërmjet një iniciative të ndërmarrë nga punonjësit e ZPLL-së së SHBA-së.

Shumica dërmuese e auditimeve të ZPLL-së së SHBA-së, rreth 90% e tyre, janë të regjistruara zyrtarisht si të kryera në përgjigje të kërkesave nga kryetarët e komisioneve. Megjithatë, ky fakt i koklavit disi punët. Për hartimin e programit të auditimeve të veta, ZPLL-ë e SHBA-së ndjek një proces planifikimi rigoroz, të gjerë dhe të hapur. Ky proces përfshin diskutime të gjera me punonjësit e agjencive, me ekspertët e jashtëm dhe anëtarët e kongresit dhe stafin. Gjatë këtyre diskutimeve shkëmbehen pikëpamje rreth çështjeve, problemeve dhe rreziqeve të vëna re nga pjesëmarrës të ndryshëm dhe zhvillohet debat i hapur për përparësinë relative me të cilën këto çështje mund të trajtohen më mirë përmes procesit të auditimit. Propozimet për auditime shpesh lindin nga këto shkëmbime pa të dhëna të qarta për origjinën reale të idesë. Propozimi mund që pastaj të përshtatet nga një komision përkatës dhe të përbëjë bazën e një letre drejtuar AP-së e cila i kërkon atij një auditim specifik. Kështu, një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të komisionit për auditim buron në sugjerimet e bëra nga ZPLL-ë e SHBA-së.

Mundësia për një numër të madh kërkesash nga burime të ndryshme ka bërë që ZPLL-ë e SHBA-së të përcaktojë përparësi të shprehura qartë për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave. Këto janë si më poshtë:

¹⁶ Një shembull ekstrem i kësaj ishte seria e shkurtimeve buxhetore në mesin e viteve 1990, e cila çoi për disa vjet rresht në një pakësim me 1/3 e numrit të stafit të ZPLL-së së SHBA-së. Është e rëndësishme të vihet në dukje se këto pakësime ishin pjesë e një nxitësi me bazë të gjerë ekonomike dhe nuk u shoqëruan me ndonjë përpjekje për të ndryshuar fokusin ose përmbajtjen e punës së ZPLL-së së SHBA-së.

¹⁷ Për të mos u zgjatur dhe për lehtësi, termi "auditim" në këtë dokument do të përdoret për të përshkruar të gjithë gamën e punës që kryen ZPLL-ë e SHBA-së. Kjo përfshin jo vetëm auditimin e deklarimeve financiare (auditime për vërtetësinë e tyre), por edhe tipe të ndryshme të auditimeve të performancës, vlerësime të programeve dhe studime për alternativa të politikave.

¹⁸ Sipas Ligjit, Presidenti i SHBA-së mund të kërkojë një auditim, por nuk ka të dhëna që ndonjë president e ka bërë këtë gjë deri tani.

1. Përparësi më e lartë i jepet mandatit të kongresmenit, kërkesave nga drejtuesit e Dhomës ose të Senatit, dhe kërkesave të drejtuesve të komisioneve. Është e rëndësishme të vihet re se kërkesat nga drejtuesit e pakicës në Dhomë e në Senat dhe kërkesave të komisioneve të atyre organeve u është dhënë përparësi e barabartë me atë që u jepet kërkesave të shumicës. Kjo bëhet me qëllim që të shmangen pasojat e frymës partiake në drejtimin e punës së ZPLL-së së SHBA-së. Përparësi e lartë u jepet kërkesave të drejtuesve të komisioneve me argumentin se këta njerëz janë në pozicionin më të mirë për të nxitur një reagim efektiv ndaj rezultateve të auditimit.
2. Përparësia tjetër është ndaj kërkesave nga anëtarë të veçantë në lidhje me çështje që janë në kompetencë të komisionit ku ata bëjnë pjesë.
3. Përparësia më e ulët u jepet kërkesave nga anëtarë të veçantë për çështje që nuk janë në kompetencë të komisionit ku bëjnë pjesë këta anëtarë.

AP-ë dhe stafi i tij i lartë vendosin se si do ta ndajnë personelin që është në dispozicion të ZPLL-së së SHBA-së për të kryer tipe të ndryshme punësh në fusha të ndryshme në të cilat do të kryhen auditime. Këto alokime pasqyrojnë gjykimin e AP-së në lidhje me përparësitë relative dhe nuk janë patjetër proporcionale me vëllimin e kërkesave për auditime që mund të jenë marrë ose që mund të parashikohen të bëhen në fusha të ndryshme. Kështu, brenda secilit prej grupeve prioritare, dhe, veçanërisht në lidhje me kërkesat e drejtuesve të komisioneve, ekziston një mundësi që puna e kërkuar në një fushë të caktuar të jetë më e madhe sesa burimet që ZPK e SHBA-së është përgatitur të vendosë në atë fushë. Nëse lind një situatë e tillë, stafi i ZPLL-së së SHBA-së punon me anëtarët dhe personelin e komisionit përkatës për të arritur një marrëveshje në lidhje me përparësitë dhe planifikimin e punës audituese për të plotësuar sa më mirë nevojat e komisionit.

Teorikisht, vëllimi i mundshëm i punës së kërkuar nga kongresi mund të jetë më i madh sesa burimet e kufizuara të ZPLL-së së SHBA-së dhe ta pengojë këtë të fundit të ndërmarrë punë audituese të cilën ajo e konsideron themelore. E çuar në ekstrem, kuptohet që një komision mund të përpiqet të pengojë ZPLL-në e SHBA-së të kryejë auditime, të cilat komisioni i konsideron “të padëshirueshme” për një arsye ose për një tjetër, duke e mbingarkuar atë me kërkesa për auditime të tjera.

Megjithatë, praktikisht ky rrezik teorik ka rezultuar se ka qenë e lehtë të shmanget. Ndërsa procesi mund të mos jetë i këndshëm, AP-ë dhe nëpunësit e tij të lartë kanë qenë gjithnjë në gjendje të arrijnë marrëveshje me drejtuesit e komisioneve për përcaktimin e kufijve të arsyeshëm për pjesën e burimeve të ZPLL-së së SHBA-së të cilat mund të investohen në punë në emër të një komisioni të vetëm.

Një masë tjetër parandaluese në lidhje me aftësinë e ZPLL-së së SHBA-së për të ndërmarrë auditimet të cilat ajo i quan të rëndësishme është fragmentimi i pushtetit në Kongres. Nëse ZPLL-ë e SHBA-së mendon se një auditim duhet të ketë përparësi, është pothuajse gjithmonë e mundshme të gjendet një mbështetës për atë auditim i cili t’i japë atij përparësinë e nevojshme. Nëse një drejtues komisioni refuzon të mbështesë një auditim, atëherë një drejtues tjetër, në të njëjtin komision ose në një komision tjetër në të njëjtin organ, ose edhe të një organi tjetër, mund të jetë i interesuar ta mbështesë auditimin e refuzuar.

Në fund të fundit, me siguri që ZPLL-ë e SHBA-së e ka mundësinë të ndërmarrë auditime me iniciativën e vet, duke përdorur burime të vogla por të rëndësishme, të cilat ajo i ka rezervë për punë të cilën e fillon vetë. Kjo rrallë ka rezultuar të jetë e nevojshme. Për më tepër, rezerva për punë audituese që fillohet me iniciativë, mund të përdoret për a) studime mbi ato çështje të cilat Kongresi ka nevojë t’i trajtojë në të ardhmen, b) sigurimin e informacionit me interes të gjerë institucional për Kongresin, por përtej juridiksionit të çdo komisioni të vetëm.

Kryerja e auditimeve: Kur merret një kërkesë për auditim, ZPLL-ë e SHBA-së angazhohet të përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve pune ose me pranimin e kërkesës, ose me refuzimin e saj. Nëse kërkesa refuzohet, letra e përgjigjes duhet të shpjegojë pse. Nëse kërkesa pranohet, përgjigja duhet të tregojë se kur stafi do të jetë gati të punojë për auditimin. Pas pranimit të kërkesës, stafi i ZPLL-së së SHBA-së do të takohet me kërkuesin për të sqaruar detajet e kërkesës nëse kjo është e nevojshme dhe do të diskutojë afatet e parashikuara kohore për punën si edhe do të vlerësojë nivelin e burimeve të kërkuara për kryerjen e auditimit. Marrëveshja që pason këtë proces i konfirmohet me një letër me shkrim kërkuesit të auditimit dhe përmban një datë të pritshme të përafërt të përfundimit të auditimit. Me përparimin e punës, stafi i ZPLL-së së SHBA-së nxjerr raporte periodike mbi gjendjen, njofton kërkuesin për ndonjë ndryshim të rëndësishëm që prek fushën e veprimit dhe afatin kohor të auditimit dhe jep përmbledhje mbi rezultatet paraprake dhe përfundimtare.

Kontrulli mbi realizimin aktual të një auditimi është tërësisht në dorë të ZPLL-së së SHBA-së, e cila ka autoritetin e vetëm të vendosë mbi një plan auditimi (në përputhje me fushën e veprimit dhe objektivat e marrëveshjes) dhe të përzgjedhë stafin i cili do ta kryejë këtë detyrë. Puna duhet të kryhet në përputhje me standardet e zbatuara të auditimit të përcaktuara nga AP dhe me procedurat dhe kërkesat e parashikuara në manualët që zbaton ZPLL-ë e SHBA-së. Në procesin e vazhdimit të auditimit, ZPLL-ë e SHBA-së ruan kompetencën e plotë të zgjerohet fushën e veprimit të auditimit nëse e konsideron të nevojshme këtë gjë për shkak të problemeve të parashikuara që mund të dalin gjatë auditimit. Sipas ligjit, ZPLL-ë e SHBA-së ka kompetencë të shqyrtojë çdo dokument, regjistër, ose material tjetër që e konsideron me interes për auditimin. Në përfundim të auditimit, ZPLL-ë e SHBA-së ka kompetencë dhe përgjegjësi të plotë për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet që ajo nxjerr nga auditimi.

Përmbyllja e auditimit dhe nxjerrja e raportit: Kur kanë përfunduar grumbullimi dhe analiza e të dhënave, ekipi i auditimit zakonisht mban një konferencë me zyrtarët e agjencisë së audituar për të vlerësuar saktësinë e të dhënave dhe për të diskutuar në lidhje me pasojat e atij informacioni. Po ashtu, ZPLL-ë e SHBA-së u jep agjencive dhe palëve të tjera të prekura mundësinë të bëjnë komente zyrtare për çdo projektraport që ka lidhje me ta. Zakonisht, mundësia për të bërë komente është brenda 30 ditëve, por në raste të rrethanave të pazakonshme, ZPLL-ë e SHBA-së mund ta zgjasë ose shkurtojë këtë periudhë dhe këtë e ka në dorë vetë ajo. Të gjitha komentet e dhëna brenda periudhës së caktuar publikohen në raportin përfundimtar të auditimit bashkë me vlerësimet e ZPLL-së së SHBA-së për ato komente. ZPLL-ë e SHBA-së mund të refuzojë të japë mundësi për analizën dhe komentet për një projektraport nëse ajo del në përfundimin se kjo do të përbëjë rrezik për individët dhe për konfidencialitetin e tyre ose nëse kjo mund të dëmtojë rezultatet e punës së auditimit.

Kërkuesi i auditimit njoftohet përpara se ZPLL-ë e SHBA-së të dorëzojë projektraportin për komente tek palët e audituara dhe një kopje e projektraportit i jepet kërkuesit për informim. Kur raporti përfundimtar është gati për t'u bërë i njohur, kërkuesit i jepet mundësia të kufizojë shpërndarjen e përgjithshme deri në 30 ditë. Pas skadimit të këtij afati kufizues, të gjitha raportet vihen në dispozicion të palëve të interesuara, të shtypit, dhe të publikut nëse shpërndarja nuk është e kufizuar për motive të sigurisë kombëtare¹⁹.

Me raste, kërkuesi i auditimit mund të vendosë - gjatë vazhdimit të auditimit ose në përfundim të tij - që auditimi nuk i plotëson nevojat e kërkuesit ose që ai nuk është më me interes për kërkuesin. Është e lejueshme që një kërkesë për auditim të tërhiqet, por kjo duhet të ndodhë me kushtin që raporti përfundimtar të mos jetë dërguar për t'u shtypur. Në këtë rast, ZPLL-ë e SHBA-së ruan të drejtën ta nxjerrë raportin pa e përmendur kërkuesin (tamam sikur raporti të kishte dalë si një produkt i një auditimi në nisur me iniciativën e vetë audituesit). Kjo ndodh në rastin kur ZPK e SHBA-së mendon se një veprim i tillë do të jetë në interes të publikut ose në rastin kur është investuar një punë e madhe në auditim para se mbështetësi i tij të tërhiqej.

Aktiviteti pas daljes së Raportit Përfundimtar: Pas daljes së të raportit të auditimit, agjencisë së audituar i kërkohet të dorëzojë në Kongres një përgjigje zyrtare në të cilën të tregojë veprimet që mendon të bëjë për përmirësimin e gjendjes. Kjo nuk ka të bëjë me komentet që agjencia mund të ketë dërguar në ZPLL-në e SHBA-së në lidhje me projektraportin. Kjo është një gjë shtesë dhe një mënyrë e dobishme për të detyruar ekzekutivin të marrë mirë parasysh në mënyrë zyrtare problemet që kanë dalë nga auditimi. Shpesh vetëm kjo nuk mjafton për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës, veçanërisht nëse drejtuesit politikë të agjencisë nuk janë të angazhuar plotësisht për veprimet menaxhuese që kërkohen të kryhen për zgjidhjen e problemeve.

Metoda e parapëlqyer me të cilën komisionet e kongresit kërkojnë të tërheqin vëmendjen për një problem dhe në këtë mënyrë të ushtrojnë presion për zgjidhjen e atij problemi, është nëpërmjet mbajtjes së seancave publike dëgjimore. Seanca të tilla dëgjimore për çështje të rëndësishme shpesh njoftohen nga shtypi dhe disa prej tyre ia vlejné të përfshihen edhe në lajmet ditore të televizioneve. Të paktën, ato zakonisht tërheqin vëmendjen e veçantë të zyrtarëve të lartë të ekzekutivit të cilëve mund t'u kërkohet të dalin dhe të japin versionin zyrtar për çështje që përbëjnë objektin e seancës dëgjimore.

Shumë prej seancave dëgjimore të komisioneve të kongresit nuk merren me rezultatet e auditimit të ZPLL-së së SHBA-së. Për ato seanca që e bëjnë këtë gjë, zakonisht merren masa si më poshtë. Dëshmitari i parë shpesh është një zyrtar nga ZPLL-ë e SHBA-së dhe ky dëshmon për punën e auditimit të kryer. Dëshmitari kryesor

¹⁹ Nëse shpërndarja e një raporti duhet kufizuar për motive sigurie, ZPLL-ë e SHBA-së përpiqet shpesh "ta shërojë" tekstin e raportit duke hequr informacionin sekret, me qëllim që të prodhojë një version i cili të pasqyrojë mesazhin parësor të raportit dhe të mund të jepet për t'u shpërndarë në përgjithësi.

nga ZPLL-ë e SHBA-së mund të jetë përgjegjësi i ekipit të auditimit. Megjithatë, në varësi të natyrës dhe të ndjeshmërisë së çështjeve që do të diskutohen, dëshmitari mund të jetë një zyrtar edhe më i lartë - deri në nivelin e AP-së dhe përfshirë atë - i cili do të jetë në gjendje të diskutojë çështje më të gjera ose të paraqesë rezultatet e auditimit në një kontekst më të gjerë. Në këtë rast, zyrtari i lartë do të shoqërohet zakonisht nga një ose më shumë anëtarë të ekipit të auditimit për t'iu përgjigjur çdo kërkesë të detajuar për auditimin.

Procedura e zakonshme është që dëshmitari dorëzon paraprakisht një deklaratë zyrtare. Shpesh për të kursyer kohë, deklaratat zyrtare futet në dokumentacionin zyrtar të seancës dëgjimore dhe me gojë bëhet vetëm një përmbledhje e shkurtër. Anëtarët e komisionit pastaj i bëjnë pyetje dëshmitarit dhe ai jep përgjigjet e tij. Komisioni zakonisht i trajton dëshmitarët nga ZPLL-ë e SHBA-së me mjaft respekt dhe shumica e pyetjeve synojnë të theksojnë dhe të përforcojnë gjetjet e auditimit. Por mund të ketë edhe largime nga kjo mënyrë veprimi. Disa anëtarë mund të përpiqen të mbrojnë agjencinë ose programin e kritikuar nga raporti i auditimit duke bërë pyetje më agresive duke u përpjekur për të dëmtuar besueshmërinë ose rëndësinë e gjetjeve të auditimit.

Zyrtarët e ZPLL-së së SHBA-së dhe stafi i tij zakonisht dëshmojnë në disa qindra seanca dëgjimore të komisioneve përgjatë një viti. Ata përgatiten me kujdes për këto seanca dëgjimore, jo vetëm duke hartuar deklaratën zyrtare, por veçanërisht duke marrë masa që të jenë gati të përgjigjen me efektivitet dhe me respekt si ndaj pyetjeve miqësore ashtu edhe ndaj atyre agresive.

Pasi dëgjohet dëshmitari i ZPLL-së së SHBA-së, zakonisht merret dëshmia e një zyrtari të agjencisë së audituar. Përdoret e njëjta procedurë: deklaratat e hapjes e dëshmitarit ndiqet nga pyetjet e anëtarëve të komisionit. Megjithatë, nëse agjencia ka qenë hezituese në pranimin e gjetjeve të auditimit ose në zbatimin e veprimeve përkatese korrigjuese, mënyra e të pyeturit mund të marrë karakter të gjerë dhe agresive. Dëshira për të shmangur një përvojë të tillë të pakëndshme për dëshmitarin e agjencisë mund të jetë një nxitës i dobishëm, edhe pse i vogël, për të ndërmarrë veprimeve korrigjuese në përgjigje të një auditimi. Pas dëshmitarit të agjencisë, mund të merren dëshmi nga dëshmitarë të tjerë, përfshirë ekspertë të jashtëm dhe ata që mund të jenë prekur nga problemet e raportuara në auditim.

ZPLL-ë e SHBA-së nuk ka kompetencë të detyrojë pranimin e gjetjeve dhe të rekomandimeve të auditimit përveçse duke bindur të tjerët për këto rezultate. Pjesëmarrja në seancat dëgjimore të komisioneve të kongresit ka rezultuar të jetë një element shumë i vlefshëm në procesin e bindjes dhe stafi i ZPLL-së SHBA-së bëjnë të pamundurën t'i shërbejnë këtij qëllimi. Ky proces nuk është mekanizmi i vetëm. Në fakt, të gjitha raportet e auditimit janë dokumente publike dhe i vihen në dispozicion edhe medias. Vëmendja e shtypit ndaj një raporti auditimi mund të jetë një nxitës i fuqishëm për veprime korrigjuese, kështu që ZPLL-ë e SHBA-së përpriqet të bashkëpunojë me përfaqësuesit e medie të ndryshme. Ajo nuk organizon konferenca shtypi, por merr pjesë, nëse i kërkohet, në konferencat e shtypit që organizojnë organe të tjera, si për shembull, kërkuesi i raportit të auditimit. Përveç kësaj, stafi i ZPLL-së së SHBA-së iu përgjigjet pyetjeve të gazetarëve që kërkojnë sqarime për çështjet e diskutuara në raportet e publikura të auditimit.

Në përpjekjet për të lehtësuar zbatimin e rekomandimeve të auditimit, stafi i ZPLL-së së SHBA-së mund të këshillojë komisionet e kongresit në procesin e hartimit të masave përkatese legjislativ. Ekspertët ligjorë të ZPLL-së së SHBA-së mund të përgatisin projektligje për t'u shqyrtuar nga komisionet përkatese, nëse kjo gjë u kërkohet. Këto projektligje duhet të jenë në harmoni me rekomandimet e publikuara të auditimeve. Po ashtu, nëse i kërkohet, stafi i ZPLL-së së SHBA-së mund të takohet me zyrtarë të agjencisë për të diskutuar se si t'i zgjidhin sa më mirë problemet e identifikuara në një auditim. Në secilin rast, veprimi përfundimtar është përgjegjësi e Kongresit ose e agjencisë, sipas rastit.

Çështje të tjera: Sipas rastit, një komision i kongresit mund të kërkojë që komisionit t'i caktohen një ose më shumë punonjës të ZPLL-së së SHBA-së për të punuar si pjesë e stafit të atij komisioni. Një veprim i tillë (i quajtur "hollësi" në zhargonin e përdorur nga ZPLL-ë e SHBA-së) zakonisht duhet të miratohet nëse ekzistojnë burimet dhe nëse stafi që e ka formimin e duhur është i disponueshëm. Megjithatë, ata i nënshtrohen disa rregullave shumë të forta:

- Staf i mund t'u caktohet vetëm komisioneve dhe jo personave të veçantë apo drejtuesve të veçantë të Dhomës ose të Senatit.
- Staf i caktuar nuk duhet të përfshihet në aktivitete ose diskutime partiake, por duhet të kufizohet në punën profesionale të komisionit.
- Detyra që caktohet duhet të ketë të bëjë me një projekt të veçantë ose me një qëllim të përcaktuar që më parë.

- Kohëzgjatja e kryerjes së një detyre të tillë nuk duhet ta kalojë një vit.

Përfundim: Siç del edhe nga ky trajtim, ZPLL-ë e SHBA-së punon shumë ngushtë me Kongresin e SHBA-së. Lidhjet e tyre janë të shumta dhe të gjera, veçanërisht në lidhje me shumë komisione të përhershme të Dhomës dhe të Senatit. Në rrethana të tjera, lidhje të tilla të ngushta midis IKLSH-së dhe parlamentit të tij mund të përbëjnë një kërcënim për pavarësinë e IKLSH-së. Megjithatë, në SHBA ky kërcënim nuk është materializuar asnjëherë.

Ekzistojnë disa arsye pse ZPLL-ë e SHBA-së ka qenë në gjendje ta ruajë pavarësinë e vet në këtë mjedis. Njëra prej tyre është se angazhimi institucional për pavarësinë dhe objektivitetin - të përforcuara edhe nga AP-të pasuese që nga krijimi i organizatës në vitin 1921- është themelor për kulturën organizacionale të ZPLL-së së SHBA-së. Stafi i saj ka instinktin e rezistencës ndaj çdo perceptimi për përpjekje për ndikim të papërshtatshëm në drejtimin ose në përmbajtjen e punës së vet, duke marrë parasysh edhe rrezikun e largimit të Senatorëve dhe Përfaqësuesve me ndikim.

Një masë mbrojtëse më e rëndësishme për pavarësinë e ZPLL-së së SHBA-së mund të jetë edhe vetë natyra e Kongresit. Fragmentimi i pushtetit të tij dhe disiplina e dobët e brendshme, që janë karakteristika ndoshta të brendshme të strukturës qeveritare të SHBA-së, duket se e bëjnë shumë të pamundur që Kongresi të ushtrojë një presion të tillë mbi ZPLL-në e SHBA-së sa që të kërcënojë seriozisht pavarësinë e saj. Për më tepër, në Kongres ka një mendim të fortë – të paktën në mes të anëtarëve më me ndikim - se besueshmëria e publikut tek ZPLL-ë e SHBA-së është një aset shumë i vlefshëm për Kongresin, si një institucion, për të lejuar pakësimin e besueshmërisë nga pakënaqësia për pasojat politike ose të politikës së çdo auditimi të veçantë apo të një numri auditimesh.

4. Vëzhgime përmbyllëse

Për të qenë më efektiv, një IKLSH-ë duhet të jetë i lirë të funksionojë në mënyrë të pavarur, pa iu nënshtruar ndikimeve të pajustificuara nga pjesë të tjera të pushtetit, por ai duhet të ketë edhe lidhjet e duhura me këto pjesë të pushtetit.

Pavarësia dhe kompetenca profesionale e stafit auditues janë jetike për të siguruar objektivitetin e punës audituese dhe për të vendosur themelet e besueshmërisë ndaj rezultateve të auditimit. Lidhjet efektive janë jetike për të garantuar që raportet e auditimit të fitojnë vëmendjen e duhur të personave që kanë autoritetin të ndërmarrin veprime korrigjuese ose të sigurojnë që të tjerë t'i ndërmarrin ato.

Asnjëri prej këtyretributeve nuk është i mjaftueshëm në vetvete. Theksimi i tejskajshëm i pavarësisë mund të kërcënojë lidhjet që janë shumë të rëndësishme për përdorimin efektiv të rezultateve të auditimit. Theksimi i tejskajshëm i lidhjeve me pjesët e pushtetit mund të dëmtojë pavarësinë, e cila është një bazë themelore për besueshmërinë e auditimeve. Është përgjegjësi e çdo IKLSH-je dhe e pjesëve të pushtetit me të cilat ato janë lidhur (zakonisht janë parlamentet, por jo gjithmonë) që, të sigurohen se kanë vendosur dhe ruajnë një ekuilibër të përshtatshëm midis këtyretributeve.

Ky dokument ka përshkruar shkurtimisht marrëdhënien midis IKLSH-së dhe parlamentit në dy vende, në Australi dhe në SHBA, vende në të cilat ky ekuilibër është ruajtur për shumë vite. Mënyrat me të cilin është siguruar ky ekuilibër janë krejt të ndryshme në këto dy vende dhe kjo pasqyron ndryshimet e rëndësishme në strukturën qeveritare dhe në kulturat politike të të dy këtyre vendeve. Secili prej këtyre dy rasteve mund të përmbajë elementë që mund të përshtaten në mënyrë të dobishme me nevojat e një vendi tjetër. Por asnjëri prej këtyre rasteve, i parë në tërësi, nuk duhet të shihet si një model për të tjerët.

Të gjitha IKLSH-të përballen me të njëjtën nevojë të formimit dhe të ruajtjes së një ekuilibri të përshtatshëm midis pavarësisë dhe lidhjeve me pjesët e pushtetit. Nuk ka një model të vetëm ose një numër masash të vetme që mund të garantojnë arrijtjen e këtij qëllimi në të gjitha IKLSH-të. Në analizë të fundit, ekuilibri i përshtatshëm për një IKLSH-ë të veçantë mund të arrihet vetëm me njohjen e plotë të mjedisit të papërsëritshëm qeverisës të vendit në të cilin ai IKLSH-ë duhet të funksionojë.